



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Instituti për Planifikim Hapësinor

PLANI HAPËSINOR I PARKUT KOMBËTAR “SHARRI”

Nëntor, 2024

1. HYRJE

Përkujdesja ndaj vlerave natyrore është kërkesë e domosdoshme, përmbushja e të cilës mundëson që ato të përjetohen nga gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Ky është njëri prej kushteve bazë, plotësimi i të cilit mundëson arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës.

Mali Sharr gjërisht njihet për biodiversitetin e tij të pasur dhe për vlerat e larta natyrore. Për shkak të këtyre vlerave, në vitin 1986 me vendim të Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, disa nga hapësirat me vlera të veçanta që përfshinin një sipërfaqe prej 39000 hektarësh u shpallën park nacional me emërtimin: Parku Nacional “Mali Sharr” dhe nga ajo kohë është provuar që sipërfaqja e cila shtrihet në kuadër të parkut, të trajtohet në mënyrën e cila siguron përmbushjen e kriterëve të përcaktuara me rregullativë ligjore dhe plotësimin e kërkesave të caktuara me marrëveshje dhe rregulla ndërkombëtare. Në dhjetor të vitit 2012 me ligjin e ri për parkun, Ligji Nr. 04/L – 087 për Parkun Kombëtar “Sharri”, sipërfaqja e parkut rritet me shtrirjen e tij edhe në territorin e Komunës së Dragashit dhe në disa zona tjera për rreth parkut duke arritur kështu një sipërfaqe prej 53469 hektarësh.

Zhvillimi, rregullimi dhe shfrytëzimi i Parkut Kombëtar “Sharri” kërkon veprim të organizuar dhe të koordinuar të të gjitha strukturave të përfshira, kërkon strategji dhe politika afatgjate të cilat do të bazohen në rezultatet e procesit të hulumtimit dhe planifikimit. Në të kundërtën, zhvillimi dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i këtyre vlerave natyrore, mund të ketë pasoja serioze në pikëpamje të degradimit të mjedisit dhe vlerave të tjera ekonomike.

2. KONTEKSTI

2.1. Parqet Kombëtare në Evropë

Në kontinentin e Evropës, që përfshinë shtetet në mes të Oqeanit Atlantik dhe Maleve Urale, sipas Europe's Parks - National Parks Of Europe janë mbi 400 parqe kombëtare (PK), nga 2000 sosh në gjithë botën. Ndër shtetet e para, që filluan krijimin e PK-ve, ishin: Suedia që nga viti 1909 me “Abisko National Parks”, “Garphyttan”, “Sarek”, “Stora ose Sjofallet”, duke e pasuar Zvicra në vitin 1914 me “Swiss National Park”, pastaj Spanja më 1918 me “Odesa” dhe “Covadonga”, Islanda më 1928, Finlanda etj. Disa prej parqeve kombëtare më të famshme në Evropë janë:

- Plitvice Lake National Park në Kroaci, i cili ka 16 liqene të lidhur me kaskada dhe ujëvara dhe është një nga vendet e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.
- Jotunheimen National Park në Norvegji, i cili ka maja malore të larta, liqene glacialë dhe është vendi i Galdhøpiggen, mali më i lartë në Evropë.
- Vatnajökull National Park në Islandë, i cili përfshin gjysmën e akullnajave Vatnajökull, vulkanin aktiv Bardarbunga dhe shpellën magjepsëse të akullit Skaftafell.
- Parco Nazionale delle Dolomiti Bellunesi në Itali, i cili ka forma të çuditshme shkëmbore, pyje alpine dhe lule të rralla.
- Peneda-Gerês National Park në Portugali, i cili ka kodra granitike, lumenj kristalor dhe fshatra tradicionale.

Në përgjithësi, territoret e parqeve kombëtare kuptohen si tërësi homogjene të pashfrytëzuara nga njeriu, të cilat kanë formacione hidromorfologjike, peizazhe, ekosisteme si dhe specie bimore e shtazore me vlera të çmuara natyrore dhe kulturore. Menaxhimi i këtyre PK-ve, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave të cekura, sigurohet nga autoritetet më të larta shtetërore.

Në Evropë, për ndryshim nga Amerika Veriore, PK-të janë fusha të konservimit të vlerave kontinentale, në të cilat kanë ndodhë evoluime të ndryshme qysh nga periudha e Neolitit, p.sh. zhvillimet (me pakësim apo rritje të vegetacionit) në pyje janë të lidhura më shumë me aktivitetet njerëzore – kulturore se sa me fenomenet dhe ndryshimet klimatike - natyrore.

Ndonëse kanë ndodhur luftëra, migrime, ndryshime drastike në demografi dhe zhvillime socio – ekonomike, transferime të pronave, etj, deri kah fundi i shekullit nëntëmbëdhjetë disa nga zonat kanë ngelur akoma të paprekura. Tërësitë e tilla natyrore janë më të afërta me konceptin Amerikan për parqe kombëtare, siç kemi rastin e Parkut “Yellowstone”, të krijuar që në vitin 1872. Aktualisht, koncepti i ditëve të sotme është se parqet kombëtare janë zona që kanë mbetur si tërësi më të egra natyrore dhe janë sa më larg e më pak miqësore ndaj ndikimit njerëzor. Kështu, formacionet hidro – morfologjike, pyjet, kullosat, kënetat, shpellat, luginat e lumenjve dhe të kanjonit të tyre si dhe liqenet natyrore ose artificiale, sikur që janë edhe tundrat e bregdetit Skandinav edhe pse goditen nga stuhitë e ishujve verior të Skocisë dhe akullnajat e Islandës e po ashtu edhe shkëmbinj të rrëpirë të Alpeve apo të Pirinejeve, janë parqe më të paprekura natyrore se sa që mund të jenë ato të Evropës Lindore.

Më në jug, me lulëzimin e qytetërimit greko-romak, njeriu evropian kishte një marrëdhënie tjetër dhe më të ndryshme me natyrën. Pas luftërave dhe vuajtjeve të shumta, ai përpiqej të pushtonte dhe të konvertonte popujt dhe pasuritë e territoreve që sundonte. Kjo është edhe arsyeja pse zonat më prestigjioze të natyrës së egër, në vendet e Mesdheut, janë në lartësi më të larta mbidetare dhe sa më larg aktiviteteve njerëzore. Megjithatë, në këto parqe natyrore, nuk kemi shkatërrim sistematik të specieve, habitateve dhe të llojllojshmërisë biologjike (biodiversitetit), porse ky ndikim vërehet kryesisht në shpërndarjen dhe rrezikimin e arealit të tyre.

Shumë më vonë, në vitin 1972, përkufizimi i parqeve kombëtare është forcuar dhe zgjeruar edhe me shfrytëzimin e hapësirave të këtyre zonave nën mbrojtje, duke përfshirë me raste edhe peizazhet kulturore dhe lokalitetet arkeologjike. Së fundi, në Kongresin Botëror në Caracas më 1992, ruajtja dhe shfrytëzimi i PK-ve është vendosur në qendër të strategjive për zhvillim të qëndrueshëm. Nga njëra anë, çështja më thelbësore për ruajtjen e larmisë biologjike (ekosistemeve, llojeve dhe variacioneve gjenetike) është mbrojtja e larmisë së specieve të egra dhe të kultivuara si dhe të mundësuarit e dhënies së hapësirës së nevojshme për jetën e tyre dhe nga ana tjetër, përmes mbrojtjes së zonave me vlera dhe bukuri të jashtëzakonshme natyrore si dhe të rëndësisë kulturore, PK-të ofrojnë shërim dhe ngritin cilësinë e jetës njerëzore të 70% të popullsisë urbane në Evropë.

Parqet kombëtare në Evropë, nuk janë sipërfaqe të izoluara dhe nuk zgjidhin vetëm problemin e shfrytëzimit të tokës apo të rritjes së përdorimit të burimeve natyrore, të cilat edhe ashtu nuk mund të kapërcejnë këto pengesa përmes vetëm një mënyre dhe kohe të caktuar. Duke u mbështetur në programet kërkimore si dhe në shpërndarjen teknike të menaxhimit adekuat të ruajtjes së vlerave natyrore e kulturore dhe të peizazheve, PK-të janë duke kontribuar për një përdorim sa më të mirë të hapësirës natyrore.

Kështu, nga krejt kjo që u tha, rezulton se në politikën e parqeve kombëtare të zhvilluar në Evropë, dallohen dy boshte kryesore. Njëri për të ruajtur atë që mbetet natyrore dhe e pa shqetësuar nga njeriu dhe tjetri për të ruajtur llojllojshmërinë e krijuar nga shoqëritë tradicionale rurale. Vetëm përcaktimi i saktë i objektivave të menaxhimit, të bazuara në zhvillimet e zonave përreth, mund të lejojnë që PK-të të ofrojnë zgjidhje të rëndësishme për ruajtjen e larmisë jetësore (biologjike) në pesëdhjetë vitet e ardhshme.

Parqet kombëtare, të cilat, sipas shpërndarjes dhe karakterit dominues, mund të ndahen në mënyrë skematike në 12 biomasa, njësi të mëdha të vegjetacionit të përcaktuara kryesisht nga klima, kushtet e temperaturës dhe reshjeve, janë të renditura në vazhdim:

1. Brigjet Atlantike dhe Baltike: 20 (9%)
2. Brigjet Mesdhetare: 7 (3%)
3. Tundër: 3 (1%)
4. Pyjet Halorë verior: 31 (13%)
5. Pyjet e Përziera: 15 (6%)

6. Pyjet Gjetherënese: 27 (11%)
7. Pyjet Mesdhetare: 8 (3%)
8. Pellgje dhe moçalet: 18 (8%)
9. Stepat dhe moçalet kripore kontinentale: 6 (3%)
10. Malet Skandinave (Evropë veriore): 24 (10%)
11. Malet e Përmbajtura (Evropë qendrore): 31 (13%)
12. Malet e Evropës jugore: 47 (20%)

2.2. Parqet kombëtare në Kosovë

Aktualisht, Republika e Kosovës ka 2 parqe kombëtare: Parkun Kombëtar “Sharri” me shtrirje në jug dhe jugperëndim të vendit, i cili është pjesë e Maleve të Sharrit të cilat shtrihen në tri shtete, në R. Kosovës, R. Shqipërisë dhe Maqedoninë e Veriut dhe Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” që shtrihet në veriperëndim të vendit, i cili është pjesë e bjeshkëve me të njëjtin emër (të njohura edhe si Alpet Shqiptare), të cilat po ashtu shtrihen në tri shtetet fqinje, në R. Kosovës, R. Shqipërisë dhe R. Malit Zi. PK “Sharri” shtrihet në komunat Dragash, Prizren, Suharekë, Shtërpcë dhe Kaçanik dhe mbulon një sipërfaqe prej 53469 hektarësh, kurse PK “Bjeshkët e Nemuna” shtrihet në komunat Istog, Pejë, Deçan, Junik dhe Gjakovë dhe ka një sipërfaqe prej 63028 hektarësh.

Këto dy parqe kombëtare, që së bashku mbulojnë 10.6 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, shtrihen në pjesët më malore duke përfshirë edhe pikat më të larta në Kosovë. Kjo vend-shtrirje e tyre është për faktin se atje ka larmi biologjike (biodiversitet) të pasur, me një numër të madh të llojeve bimore dhe specieve shtazore, të cilat janë në bashkëjetesë të harmonizuar me njerëzit ose qëndrojnë larg ndikimeve të tyre negative të shkaktuara nga aktivitetet zhvillimore.


2.3. Misionet e parqeve

Njohja, mbrojtja, ruajtja dhe menaxhimi aktiv i vlerave të trashëgimisë natyrore duke siguruar ruajtjen e larmisë biologjike (biodiversitetit) dhe të mirëqenies së publikut janë misione të mirëpritura dhe tradicionale të parqeve kombëtare. Përveç kësaj, specifikat e të dy parqeve në Kosovë lejojnë udhëheqjen e zhvillimit të një sërë aktivitetesh që kanë për qëllim ruajtjen e vlerave natyrore, kulturore dhe të peizazhit.

Gjithashtu, edhe përkujdesja për një bashkëpunim të fortë ndërkombëtar, binjakëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm, sjellin partneritete dhe marrëdhënie kontraktuese që promovojnë përfshirjen e popullsisë lokale dhe të palëve të interesit në menaxhimin e ekuilibrit ekologjik dhe të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore brenda dhe për rreth parkut.

Parku Kombëtar	Sipërfaqe totale e parqeve (ha)	Zonë e I-rë (%)	Zonë e II-të (%)	Zonë e III-të (%)	Sipërfaqja e PK në komuna (%)
Sharri	53271				Dragash (45%) Prizren (22%) Suharekë (4.7%) Shtërpcë (24.2%) Kaçanik (4.1%)
Bjeshkët e Nemuna	63028				Istog (8.1%) Pejë (52.1%) Deçan (26.6%) Junik (8.4%) Gjakovë (4.8%)

Tabela x – Parqet kombëtare në Kosovë



Harta nr.x – Parqet kombëtare në Republikën e Kosovës

3. ROLI DHE BAZUESHMËRIA E PLANIT

Hartimi i Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri” ka për bazë legjislacionin në fuqi që përbëhet nga: Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri”, Ligji për Tokën Bujqësore, Ligji për Ndërtim, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Ujëra.

Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri” është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojtjes së resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Plani përcakton parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën të paktën 10 vjeçare, përcakton afatet kohore reale dhe implikimet buxhetore. Plani hapësinor duhet të:

- Udhëzojë sektorët dhe agjencitë e Qeverisë së Kosovës në hartimin dhe implementimin e politikave dhe vendimeve për shfrytëzimin sa më të drejtë të kësaj pasurie natyrore;
- Përcaktojë kategorizimin e hapësirave apo zonave sipas regjimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre në: zona që do të mbeten të tilla si janë, të ruajtura nga çdo zhvillim; zona me një gamë të vogël, të kufizuar të zhvillimeve hapësinore; dhe zona me një gamë më të gjërë të zhvillimeve hapësinore

Plani hapësinor do të shërbejë si udhëzues për:

- Identifikimin e lokacioneve të parkut me potenciale të zhvillimit;
- Aproximin e politikave lidhur me vendosjen e zhvillimeve të mundshme në territorin e parkut që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit, ofrimin e shërbimeve të nevojshme, gjithnjë duke ruajtur në maksimum trashëgiminë dhe vlerat natyrore dhe kulturore;
- Identifikimin e rolit të vendbanimeve (fshatrave) përreth dhe rolin e qyteteve të mëdha që ndodhën në afërsi të parkut;

- Identifikimin e rolit të vendbanimeve (fshatrave) përreth, si dhe
- Identifikimin e rolit të infrastrukturës së rëndësishme dhe të lidhjeve me territorin e parkut

Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri” bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj,
- Vizionin dhe caqet strategjike,
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm,
- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm,
- Elemente tjera të përcaktuara me akt të veçantë

4. PROCESI, PJESËMARRJA PUBLIKE, BURIMI I TË DHËNAVE

Puna rreth hartimit të planit ka filluar me shqyrtimin dhe sistemimin e të dhënave që IPH i ka patur në dispozicion para se ta fillojë punën. Paralelisht me këtë, IPH e ka inicuar themelimin e dy grupeve punuese: grupit punues ndërmintor (GPN) dhe grupit të ekspertëve për rishikimin dhe ripërcaktimin e zonave të parkut, të shpallura rezervate të natyrës. Grupet janë themeluar me vendimet e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Grupi punues ndërmintor kishte në përbërje të tij pjestarë nga sektorë të ndryshëm të Qeverisë së Kosovës, nga qeveritë lokale të komunave, në territoret e të cilave shtrihet parku dhe nga shoqata bjeshkatore. Detyra e tij ka qenë ta mbështesë stafin e IPH për hartimin e këtij plani. Grupi i ekspertëve për ripërcaktimin e rezervateve të natyrës përbëhej nga ekspertë të lëmive të biologjisë dhe gjeografisë, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe nga MMPHI. Ai e ka patur për detyrë që në bazë të vrojtimit në terren t’i rivlerësojë zonat e parkut të shpallura rezervate të natyrës dhe në bazë të këtij vlerësimi, t’i përcaktojë kufinj e ri eventual të këtyre rezervateve.

Procesi i hartimit të planit ka kaluar nëpër 5 faza të punës si rezultat i të cilave përpilohen 5 pjesët (kapitujt) e planit hapësinor që janë:

1. Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes;
2. Vizioni, parimet dhe caqet;
3. Korniza e zhvillimit hapësinor;
4. Strategjitë dhe veprimet për zbatim;
5. Dispozitat për zbatim

Tek pjesa e parë e planit, “Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes” paraqitet gjendja ekzistuese në hapësirën e parkut e vështruar në katër fusha tematike: mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës, demografia dhe zhvillimi social, zhvillimi ekonomik, dhe infrastruktura. Poashtu bëhet analiza SWOT që konsiston në identifikimin e përparësive dhe dobësive të gjendjes ekzistuese, si dhe të mundësive por edhe kanosjeve eventuale për të ardhmen. Në këtë pjesë të planit hapësinor gjithashtu elaborohen sfidat kryesore zhvillimore për hapësirën e parkut kombëtar.

“Vizioni, parimet dhe caqet” është pjesë e dokumentit të planit hapësinor ku jepet një vizion për të ardhmen e parkut dhe tregohen synimet dhe objektivat që dëshirohet të arrihen në park.

Në fazën e tretë të punës është përpiluar “Korniza e zhvillimit hapësinor”. Në të jepen konceptet kryesore të zhvillimeve të ardhshme hapësinore në park, ndërkaq synimeve dhe objektivate u jepet dimensionin hapësinor, tregohet në mënyrë më të përgjithshme se ku dhe çka dëshirohet të arrihet sa i përket fushave tematike të përmendura më lartë.

Ajo se si është menduar të arrihen të gjitha ato që janë paraqitur tek pjesa e kornizës, tregohet në pjesën e katërt të planit “Strategjitë dhe veprimet për zbatim”. Kjo përmban masat, veprimet konkrete dhe projektet që duhet të realizohen në mënyrë që të arrihen synimet dhe objektivat për parkun kombëtar.

Gjatë fazës së pestë është hartuar pjesa e fundit e planit hapësinor “Dispozitat për zbatim”. Në këtë dokument renditen të gjitha kushtet që detyrimisht duhet të plotësohen gjatë zbatimit të planit.




Figura x. Skema e procesit

Gjatë procesit, çdoherë pas përfundimit të pjesës së caktuar të planit, ajo u është shpërndarë anëtarëve të GPN që ta analizojnë dhe komentojnë me qëllim të përmirësimit eventual të dokumentit. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, transparent dhe me pjesëmarrje publike në vendimmarrje. Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e ministrive të Qeverisë së Kosovës, autoriteteve komunale, institucioneve shkencore dhe hulumtuese dhe organizatave të shoqërisë civile. Gjatë procesit të hartimit të planit, është zhvilluar një proces i suksesshëm dhe shumë transparent i diskutimeve, në të cilin janë përfshirë të gjitha grupet e interesit. Qëllim dhe fokus i takimeve ka qenë përfshirja e komunitetit dhe njohja e tyre me procesin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces. Ndikim pozitiv në këtë drejtim kanë treguar autoritetet komunale, të cilat me përkushtim maksimal kanë ofruar të gjitha të dhënat e mundshme dhe përkrahjen shumë të nevojshme në proces.

Procesi i planifikimit është i vazhdueshëm. Ai duhet t’i nënshtrohet monitorimit, vlerësimit dhe në bazë të kërkesave edhe ndryshimeve të nevojshme. Më poshtë është dhënë skema e mobilizimit institucional apo e pjesëmarrjes publike në procesin e hartimit të planit hapësinor.




Figura x. Skema e pjesëmarrjes publike

Materiali i planit hapësinor është i bazuar në të dhëna të marrura drejtpërdrejt nga terreni, nga komunat në territoret e të cilave shtrihet Parku Kombëtar “Sharri”, nga planet zhvillimore të këtyre komunave, nga sektorët relevant të ministrive të Qeverisë së Kosovës, dokumentacioni ekzistues për arësyeshmërinë e shpalljes së Malit Sharr park kombëtar dhe nga dokumentet e agjencive zhvillimore ndërkombëtare që kanë punuar dhe punojnë në çështje të ndryshme lidhur me pyjet, zhvillimin rural, turizmin etj.

5. FUNKSIONET THEMELORE TË PARKUT KOMBËTAR “SHARRI”

Me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri” si dhe në bazë të Ligjit Nr. 03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës duhet të sigurojmë:

- Mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të ripërtëritshme të natyrës;
- Rivitalizimin e territoreve të dëmtuara të natyrës ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- Ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
- Vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e natyrës;
- Realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së natyrës;
- Zvogëlimin e shfrytëzimit tejmase dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre;
- Të drejtën për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;
- Sigurimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë.
- Sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes.

Sipas ligjit për mbrojtjen e natyrës, parku kombëtar është territor natyror me funksione për:

- Mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- Përjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;

- c) Sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit, përderisa ai duhet të menaxhohet me qëllime si:
1. Mbrojtja e territoreve natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe turistike;
 2. Ruajtja e gjendjes burimore, të shembujve reprezentativ të zonave fiziografike, bashkësive biotike, resurseve gjenetike dhe llojeve për sigurimin e biodiversitetit dhe të stabilitetit ekologjik;
 3. Sigurimi i shfrytëzimit në aspektin inspirues, shkencor, arsimor, kulturor dhe rekreativ që ta mbajë zonën në gjendjen natyrore ose afërsisht natyrore;
 4. Përrjashtimi i shfrytëzimeve ose i vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime dhe dëmtime të natyrës;
 5. Mbajtja e veçorive ekologjike, gjeomorfologjike dhe estetike për të cilat territori është shpallur i mbrojtur.

Funksionet e parkut kombëtar përcaktohen në atë mënyrë që ato të sigurojnë në radhë të parë mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave themelore të parkut nacional, e pastaj rregullimin dhe shfrytëzimin e këtyre vlerave:

- Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave dhe rariteteve natyrore prezente burimore dhe pjesërisht të ndryshuara;
- Mbrojtja dhe përparimi i pejzazhit të rajonit në tërësi;
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturo-historike;
- Zhvillimi dhe përparimi i vlerave natyrore dhe të krijuara, si dhe zhvillimi i aktiviteteve prezente dhe të reja;
- Ekonomizimi dhe përparimi i vlerave natyrore dhe ekonomike;
- Shfrytëzimi i vlerave të parkut nacional me qëllim të hulumtimeve shkencore, arsimore, edukative dhe kulturore;
- Shfrytëzimi i vlerave të parkut kombëtar për nevojat e ekonomisë, para së gjithash për nevojat e veprimtarive turistike-rekreative, pastaj për shfrytëzimin e pyjeve, kullosave malore, tokës bujqësore etj;
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për vlerat e natyrës

6. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES

Në këtë kapitull të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri" paraqitet gjendja ekzistuese në park dhe në vendbanimet rreth parkut, të cilat duke qenë në afërsi direkte të kufirit të parkut kanë ndikim në të por edhe janë të ndikuar nga parku. Banorët e këtyre vendbanimeve, diku më shumë e diku më pak janë të ndërlidhur me parkun dhe në varësi reciproke me të. Një pjesë e tyre i ka pronat atje me të cilat i lidhin aktivitetet e ndryshme dhe shumë prej tyre i sigurojnë furnizimet e nevojshme nga parku. Teksti në vazhdim, fillimisht flet për këto vendbanime.

6.1. VENDBANIMET PËR RRETH PARKUT KOMBËTAR "SHARRI"

Rreth Parkut Kombëtar "Sharri" ndodhen 62 vendbanime që kanë ndikim më të drejtpërdrejtë në park dhe që ndikohen nga i njëjti. Ato u takojnë pesë komunave: Dragash (21 vendbanime), Prizren (22 vendbanime), Suharekë (3 vendbanime), Shtërpçë (12 vendbanime), dhe Kaçanik (4 vendbanime). Këto vendbanime kanë një ndikim të rëndësishëm në ruajtjen dhe menaxhimin e parkut, duke kontribuar në mbrojtjen e natyrës së tij.

Nr	Dragash	Banorë	Prizren	Banorë	Suharekë	Banorë	Shtërpcë	Banorë	Kaçanik	Banorë
1	Baçkë	52	Dojnicë	0	Delloç	160	Brezovicë	68	Sllatinë	211
2	Orqushë	60	Kabash	0	Greikoc	2534	Sushicë	74	Strazhë	258
3	Dikancë	124	Vërbiqan	0	Mushtisht	3394	Drekoc	106	Gllloboçicë	1287
4	Pllajnik	405	Zhivinjan	0			Jazhincë	162	Vatë	1675
5	Buçë	645	Struzhë	102			Sevcë	176		
6	Kosavë	905	Sredskë	69			Biti e Epërme	329		
7	Kërstec	420	Drajçiq	151			Beroc	287		
8	Zlipotok	610	Novosellë	309			Vërbeshticë	450		
9	Kuklibeg	852	Gornjasellë	292			Gotovushë	445		
10	Krushevë	857	Llokvicë	339			Firajë	1103		
11	Leshtan	783	Vërmicë	661			Brod	1680		
12	Zaplluzhë	1273	Shkozë	788			Shtërpcë	1265		
13	Blaç	1455	Pouskë	684						
14	Gllloboçicë	960	Nebregoshtë	579						
15	Kuk	1658	Reçan	951						
16	Rapqë	853	Pllanjan	1104						
17	Radesh	1224	Skrobishtë	1128						
18	Brezne	1990	Mushnikovë	1133						
19	Brod	1544	Manastiricë	1107						
20	Brodosanë	2839	Lubinjë e Poshtme	1227						
21	Restelicë	4698	Lubinjë e Epërme	1925						
22			Zhur	5909						
Gjithsej banorë		24207		18458		6088		6145		3431
Totali		58329								

Tabela nr. x Vendbanimet për rreth Parkut Kombëtar "Sharri" dhe popullsia e tyre

Numri i përgjithshëm i popullsisë në këto vendbanime sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 është 58329 banorë.

Vendbanimet më të mëdha janë Zhuri (5909 banorë), Restelica (4698 banorë), Brodosana (2839 banorë), kurse vendbanime më të vogla janë vendbanimet Baçkë (52 banorë), Orqushë (60 banorë), Dikancë (124 banorë), por gjithashtu ekzistojnë edhe katër vendbanime në komunën e Prizrenit, të cilat nuk kanë asnjë banorë.

Funksionet e vendbanimeve përreth parkut janë banimi, bujqësia, blegtoria si dhe tendenca në rritje e zhvillimit të veprimtarisë së turizmit. Ngritja e interesimit për turizmin rural, mund të ndikojë në ndryshimin e qasjes së popullatës së këtyre vendbanimeve. Një numër i këtyre vendbanimeve kanë predispozita që të ofrojnë kushte për zhvillimin e turizmit rural, duke ofruar shërbime tradicionale për vizitorët e parkut.

Ndryshimet demografike në këto vendbanime kanë pasur ndikim të rëndësishëm në Parkun Kombëtar "Sharri". Një nga ndikimet më të rëndësishme është ndryshimi i peizazhit natyror, humbja e bimësisë dhe faunës, ndotja e mjedisit, ndotja e ujërave dhe tokës.

Përveç kësaj, ndryshimet demografike dhe zhvillimi urban kanë ndikuar në rritjen e nevojës për ndërtim të infrastrukturës së re në këtë zonë, si: ndërtim të rrugëve, hoteleve, restoranteve, etj., duke

krijuar presion në zonën e parkut. Nëse këto ndërtime nuk bëhen në mënyrë të përshtatshme dhe duke respektuar kushtet e mjedisit natyror, ato mund të dëmtojnë Parkun Kombëtar "Sharri" dhe të rrezikojnë ekosistemet e veçanta në këtë zonë.

Në anën tjetër, Parku Kombëtar "Sharri" ka ndikim në sektorin e ekonomisë dhe turizmit të këtyre komunave, pasi që parku është një burim i rëndësishëm për industrinë e turizmit në këtë zonë. Në komunat dhe vendbanimet përreth parkut, ka pasur një zhvillim të sektorit turistik, pasi që shumë njerëz që vizitojnë Parkun për të eksploruar peizazhin natyror dhe për aktivitete të tjera si skijim, alpinizëm, etj., vizitojnë edhe këto qytete dhe vendbanimet përreth parkut.


Në këtë mënyrë, ndryshimet demografike dhe zhvillimi urban kanë rritur nevojën për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe për respektim të kushteve dhe nevojave të mjedisit natyror në këtë zonë.

Pyjet dhe kullosat në Parkun Kombëtar "Sharri" janë burime të rëndësishme të biodiversitetit dhe ekosistemeve të veçanta. Ndryshimet demografike dhe urbanizimi në zonën përreth parkut kanë ndikuar në shkatërrimin dhe dëmtimin e pyjeve dhe kullosave. Ndryshimet në nivelin e ujit dhe ndotja e ajrit dhe ujit nga aktivitetet njerëzore si dhe ndotja e tokave nga mbeturinat kanë rritur presionin mbi pyjet dhe kullosat.

Furnizimi me ujë në disa nga vendbanimet në zonën përreth Parkut Kombëtar "Sharri" realizohet përmes puseve dhe kaptazhave ujore që ndodhen brenda parkut. Kjo ka një ndikim direkt në pyje dhe burimet ujore të parkut, duke shkaktuar një presion të madh mbi resurset ujore. Gjithashtu, rritja e kërkesave për ndërtimin e hidrocentraleve në këtë zonë vlerësohet nga ekspertët e natyrës si trend shumë shqetësues për mjedisin natyror në park.

Në të njëjtën kohë, nevoja për furnizim me ujë për banorët e këtyre vendbanimeve është e nevojshme dhe nuk mund të injorohet. Është e rëndësishme që institucionet lokale dhe qendrore të planifikojnë dhe monitorojnë furnizimin me ujë në vendbanimet përreth parkut në mënyrë që ujërat natyrore të mos ndoten dhe të mbeten të pastra për ekosistemet, popullatën dhe për turizmin në zonën e parkut.

Pra, ndryshimet demografike dhe zhvillimi urban në zonën përreth Parkut Kombëtar "Sharri" kanë pasur ndikim të rëndësishëm në pyje, kullosa, turizëm dhe infrastrukturë. Është e rëndësishme që zhvillimi turistik dhe urban të kryhet duke respektuar kushtet e mjedisit natyror me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të kësaj zone unike. Po ashtu është e rëndësishme që të rritet ndërgjegjësimi i popullatës për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve, kullosave dhe burimeve ujore në zonën e parkut.




Harta nr. X Vendbanimet për rreth Parkut Kombëtar "Sharri"

6.2. POZITA, KUFINJT DHE TË DHËNA THEMELORE PËR PARKUN

Parku Kombëtar "Sharri" shtrihet në jug të Republikës së Kosovës apo në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik dhe përfshihet në kryqëzimin e rrugëve në drejtimin lindje – perëndim, ndërmjet Detit të Zi dhe Detit Adriatik si dhe në drejtimin veri – jug, ndërmjet Evropës së Mesme dhe Detit Egje (Mesdheut). Përmes luginës së lumit Lepenc (Siriniq) lidhet me Fushën e Kosovës ndërsa përmes Luginës së Lumëbardhit të Prizrenit (Sredska) lidhet me Rrafshin e Dukagjinit dhe përmes luginës së lumit Pllava lidhet me Republikën e Shqipërisë.

Masivi malor i Sharrit shtrihet deri tek ultësira e Gostivarit dhe Tetovës në verilindje të Maqedonisë së Veriut. Në jug ai kufizohet me liqenin e Mavrovës, në perëndim kufizohet me masivin malor të Korabit dhe në veri dhe veriperëndim shtrihet në Kosovë. Sipërfaqja e përgjithshme e Masivit Malor Sharr është 1600km², e ndarë në tri shtete: Maqedoni e Veriut me sipërfaqe 900km² ose 56.9% të sipërfaqes së përgjithshme, në Kosovë me sipërfaqe 691.2km² ose 43.2% dhe në Shqipëri me sipërfaqe 10.8km² ose 0.63 % të sipërfaqes së përgjithshme.



Harta x. Përfshirja e sipërfaqes së parkut në komuna

Parku përfshinë pjesën e territorit të Maleve të Sharrit që veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me pyje të ruajtura, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera, me numër të konsiderueshëm të llojeve të ruajtura endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike, si dhe me vlera shkencore, kulturore, historike, peizazhore, sportive, rekreative – turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kriterëve mjedisore.

Kufiri i Parkut Kombëtar "Sharr" – Kufiri fillon në pjesën lindore të gryka e Kepit të Kurtës (1050 m.) në kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë dhe vazhdon në drejtim të perëndimit dhe jug-perëndimit përgjatë kufirit shtetëror duke shkuar përtej kuotave, përkatësisht majave më të larta të Sharrit, majës së Lubotinit (2499 m.), Kulla (2314 m.), Livadhi (2491 m.), Çuka e Liqenit (2604 m.), Bistra (2640 m.), Maja e Zezë (2584 m.), Kobilica (2526 m.), Vërtopi (2555 m.), Kara Nikolla (2106 m.), Bardhaleva (2334 m.); Tërpezница (2610 m.); Qelepina (2554 m.); Rudoka (2658 m.); Vraca e Madhe (2582 m.); deri të pika kufitare e tri shteteve (Kësula e Priftit), Kosovës me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Nga këtu kufiri vazhdon në veri-perëndim deri të kота Kallabak (2174 m.), nga ku e merr drejtimin e veriut, gjithnjë duke u përputhur me kufirin shtetëror me Republikën e Shqipërisë, nëpër majën Murga (2025 m.) pret lumin e Restelicës, pastaj lumin e Plavës deri të kuota 1702 m në malin Koritnik. Kufiri pastaj kthehet në veri-lindje, kalon nëpër Lugin e Keq dhe del në rrugën pyjore kuota 1343 m, për të vazhduar përgjatë kësaj rruge duke futur brenda Kodrën e Erës, duke kaluar nëpër Rrasa pranë Arës së Bajraktarit nëpër kuotën 1273 m, kështu duke mbërthyer kodrën Gollina deri te kuota 1246 m tashmë në brendi të territorit të komunës së Dragashit. Nga këtu kufiri merr drejtimin e jug-lindjes deri pranë kodrës Kopriva (1493m) duke lënë jashtë kufirit pyjet e Rronzës. Prej këtu shkon deri te Bunari i Hamitagës më astaj merr drejtimin e lindjes duke rënë shpatit të Ahishte rreth 1 kilometër në lindje të fshatit Buçe. Pastaj kufiri merr drejtimin e jugut për në Brinja duke i lënë jashtë kufirit Brinjën dhe Arën e Rexhës duke shkuar në drejtim të pyjeve të Çestakut e duke rënë deri tek rruga për në fshatin Kërsteci i Madh duke kaluar kuotën 1407 m gjithnjë duke shkuar në drejtimin jug-perëndim thuajse duke mbërthyer të tërin malin e Koritnikut, deri te përroi i Pjetrit për të marr më

pastaj drejtimin e lindjes nëpër kuotën Çula (1201m) e për të rënë deri në rrjedhën e lumit të Plavës në përroin tjetër pa emër. Nga këtu vija kufitare shkon duke ndjek rrjedhën e lumit Plava deri 250 afër kufirit me Shqipërinë. Pastaj nga këtu kufiri merr drejtimin e jugut duke shkuar thajse paralelisht me kufirin shtetëror në lindje të fshatit Orçushë. Kufiri shkon gjithnjë në drejtim të jug-jug-lindjes nëpër pyjet duke ndjekur rrugën malore që i ndan pyjet e Gosit me Majën e Zezë (1581 m), e duke ju ofruar fshatit Glloboçicë në lindje rreth 700 metra larg. Vija pastaj ndjek përroin që kalon nëpër Rudce për të rënë poshtë deri te rrjedha e lumit të Restelicës. Nga këtu vija ndjek gjithnjë rrjedhën e lumit në drejtim tashmë të jugut duke kaluar kuotën 1107 m. Pastaj viaj kufitare merr drejtimin e lindjes për të dal në rrugën që shpie për në fshatin Krushevë. Kjo vijë e ndjek rrugën deri pranë varreve të fshatit të Krushevës, për të këputur sërish rrjedhën lumore të Restelicës e duke u ngjitur përpjetë shpatit duke kaluar nëpër kuotat 1390 m. pastaj kuotën Kolenica (1489 m.). Nga këtu vija kufitare merr drejtimin e veriut duke mbërthyer pyjet e Jellakut. Më pas vija del në rrugën për në Restelicë duke ju afruar në perëndim të fshatit Restelica te kuota 1426 m., prej nga vija merr drejtimin e shtrirjes në perëndim gjithnjë duke i kufizuar në vete pyjet në lindje të Restelicës duke kaluar nëpër urën e Kadiut pastaj kuotën 1644 metra. Më pastaj kufiri fillon të merr drejtimin e jugut me zigzake deri te përroi Çopur. Më pastaj vija kthehet kah jug-perëndimi nëpër rrjedhën e lumit për t'u lidhur me rrugicën tjetër të anës së djathtë të lumit. Nga këtu vija e kufirit shkon përgjatë vijës që ndanë pronën private nga ajo publike në drejtim jug-lindjes deri te rruga kryesore Restelicë - kufi me Maqedoninë. Vija kryesisht e ndjek rrugën deri afër fshatit Restelicë gjithnjë duke ndjekur kufirin në mes të tokave private dhe publike. Nga rruga që vija e tangon në jug të fshatit, vija kufitare merr drejtimin e lindjes përgjatë lumit të Restelicës duke u ngjitur përpjetë deri tek kuota 1581 metra prej nga pastaj kufiri merr drejtimin e veriut përkatësisht veri-perëndimit deri te kuota 1818 si dhe kuotën tjetër 1887 duke bërë një gjysmë rreth për ta lënë jashtë kufirit majën Kërstilla prej 1907 metra. Nga këtu vija kufitare tashmë arrin të mbërthen në vete majën e lartë malore Ovçinac (2177 m) pastaj duke shkuar përkaj majës tjetër Maja e Zezë (2063 m). Prej këtu vija merr drejtimin e perëndimit kah fshati Zlipotok duke ju afruar rrëzë shtëpive të fshatit. Gjithnjë duke ndjekur perëndimin vija kufitare tangohet me rrugën kryesore për në fshatin Zlipotok tek kuota 1414 metra përkatësisht tek varrezat e fshatit. Prej kësaj pike vija merr drejtimin e veri-lindjes përkaj varrezave duke mbërthyer në vete majën malore Popovica (1567 m), pastaj majën tjetër Bigor duke shkuar në drejtim të pyjeve Leska përmbi hidrocentralin e Dikancës deri tek lumi i Brodit. Nga këtu vija kufitare ndjek lumin e Brodit në drejtim të burimit të tij deri afër fshatit Brod kur fillon dhe i shmanget fshatit duke u ngjitur vija përpjetë shpatit të Rudinës deri tek kuota 1483 metra, pastaj kufiri merr drejtimin e lindjes duke kapërcyer lumin tek Ura e Shollës përkatësisht tek bashkimi i rrjedhave të lumenjve Lleva dhe Dushkaja. Më pastaj vija kufitare ndjek kufirin e tokave të "Sharr-Prodimit" duke kaluar nëpër kuotat 1790 m. më pastaj te kuota 1432 m. në degën e djathtë të lumit Brod pranë varrezave të fshatit Brod. Kufiri vazhdon të bëjë rrethin e çrregulltë nëpër kuotat 2081 m përkatësisht 1680m duke mbështjellë thajse të tërë fshatin Brod dhe duke lënë fshatin jashtë kufirit. Më pastaj vija kufitare del deri tek rruga kryesore Dikancë - Brod duke ndjekur deri afër fshatit Dikancë. Më pastaj kufiri vazhdon të marr drejtimin e veriut përkatësisht veri-lindjes duke kaluar pranë kuotave Virje 1602 metra, përkatësishti 1598 duke ju afruar fshatit Lleshtan nëpër Baçillishtë, Shillovicë deri tek lumi i Radeshës tek kuota 1436 metra. Nga kjo kuotë vija merr drejtimin e jug-lindjes nëpër përroin e Zagrejcit duke mbërthyer shpatiet e rrëpijta të Zagrejcit pas 1500 metrash vija merr drejtimin e veri-lindjes duke u ngjitur bjeshkës së Livaxhës pranë kuotës 1900 metra, përfundi Gurit të Shqiponjës pastaj nga këtu merr drejtimin teposhtë drejtë përroit të Srednicës përfundi kuotës 1722 metra. Nga këtu vija kufitare ndjek rreth 500 metra shtratin e përroit për t'u kthyer pastaj sërish në drejtim të veriut nëpër malet e Bogdanicës deri te kuota Guri Marushan në shtratin e përroit të Pllajnikut. Vija kufitare vazhdon të ndjekë drejtimin e veriut deri tek Kroi Obçinovë, pastaj kuota 1572 pranë kodrës Sumllar prej nga merr drejtim veri-lindje deri tek përroi Ropuha në veri-perëndim të fshatit Kuk. Vija kalon përroin duke marrë drejtimin thajse krejtësisht të lindjes duke kaluar përkaj kodrës së Shullanit e për të rënë deri tek lumi Reka e Shehit të Madh tek kuota 1628 metra. Prej këtu vija sërish merr drejtimin e veri-lindjes duke kaluar Gurin e Torishtes e duke zbritur tek lumi Reka e Shehit të Vogël. Më pastaj kufiri merr drejtimin e veriut duke bërë zigzage duke përfshirë në vete vendet Guri i Korbit, Gurin

e Grihes e pastaj Brezhdën deri tek shpatiet e Drizdës, një kilometër në jug - lindje të fshatit Zaplluzhë. Nga këto shpatie vija takon kuotën 1367 metra, pastaj kuotën 1680 metra në Ugar, kuotën tjetër 1609 për të mbërritur tek Qafa e Dhelnës pranë kuotës 1625 metra. Nga kjo kuotë kufiri kthehet në lindje dhe zbret deri te rruga për të vazhduar përrockës pa emër deri të lumi i Manastircës nga ku e merr drejtimin e jugut përgjatë lumit deri të përrocka tjetër pa emër. Kufiri pastaj ngjitet përrockës në drejtim të jug - lindjes dhe duke kaluar kuotën Guri i Pishës (1192 m.) del të kuota Guri i Qelit (1669 m.). Nga këtu kufiri zbret luginës në drejtim të lindjes deri të lumi Pubenica të cilin e ndjek në drejtim të veri-lindjes deri të izohipsja 1050 m. te Kosa e Gjerë (vend derdhja e përrockave në lumin Pubenica) nga ku kthehet në lindje nëpër kuotën 1093 m deri të kuota Brod (1048 m.). Nga kjo kuotë kufiri merr drejtimin e veri-lindjes, ngjitet deri te kurrizi i Stërgës së Kumancit dhe vazhdon përgjatë rrugës së livadheve të Lubinjës së Epërme (nën vendin Smig) deri të kuota 1401 m. Mëtej kufiri shtrihet në veri-lindje nëpër kuotën Livadhet e Epërme (1430 m.) dhe zbret luginës deri te kuota 1107 m. (lumi Petreshnica) për të vazhduar në drejtim të veri-lindjes duke u ngjitur kurrizit deri të përrocka e Marës (izohipsa 1230 m.). Nga kjo pikë kufiri kthehet në veri - perëndim dhe e ndjek izohipsën 1230 m. deri të kuota 1227 m. nga ku vazhdon në veri-lindje deri te shpatiet e Gropës (1192 m.). Kufiri pastaj shtrihet në lindje nëpër kuotën (1195 m.) përgjatë shpatieve Çuka deri të përrocka e Mahallës së Epërme (lagje e fshatit Katundi i Epërm.) (izohipsa 1300 m.) nga ku në drejtim të veri-lindjes ngjitet deri të Llanishta (izohipsja 1400 m.) për të vazhduar në veri-perëndim mbi fshatin Katundi i Epërm dhe del në rrugën rajonale Prizren - Shtërpçë mbi shpatiet e Stërnjgarit (500 m në lindje nga kuota Prisoj 1330 m.). Nga kjo pikë kufiri e ndjek rrugën në drejtim të perëndimit deri të „Kthesa e Gjashtë“, pastaj vazhdon nëpër kuotat Gabar (1195 m.), (1257 m.) (1056 m.) deri te përrocka e fshatit Pllanjan nga ku zbret në drejtim të jug - perëndimit duke kaluar nëpër kuotat 1084 m, 928 m. 803 m. për të zbritur në Lumbardhë (550 m.) të cilin e ndjekë deri te kuota 532 m. Pastaj e merr drejtimin e perëndimit, e pret rrugën rajonale (Prizren-Shtërpçë) dhe kalon nëpër kuotat 867 m. dhe 974 m. nga ku zbret kurrizit në veri - perëndim deri tek përrocka e Katërdhjetë Bunarëve të cilin e përfshinë. Nga këtu kufiri e merr drejtimin e veri - lindjes, e kalon Lumbardhin, rrugën rajonale, dhe ngjitet kurrizit të shkëmbinjve të Vërtopit, duke e përfshirë pjesën lindore të shkëmbinjve, e merr drejtimin e jug - lindjes, kalon nëpër kurrizin malor të Dullos, dhe pasi që e mbërthen grykën e përrockës së Vërbiçanit, lidhet me kurrizin Tociv në izohipsen 900 metra. Nga këtu vazhdon kurrizit në drejtim të lindjes deri tek kuota Maja (1567 m.), nga ku kthehet në verilindje dhe përgjatë vegetacionit pyjor del te rruga pyjore për në fshatin Novosellë duke futur brenda kufirit livadhet e kodrinës së Bullecit. Kufiri pastaj zbret nën rrugë deri te izohipsa 1500 m. të cilin e ndjekë deri te Kroni i Aliut (që gjendet në rrugën pyjore), duke i futur brenda kufirit Ujërat e Gropuara. Pastaj kufiri vazhdon përgjatë rrugës në drejtim të veriut deri te kuota 1500 m. (Ravenj), nga ku zbret kurrizit deri tek Guri i Mullinit. Nga kjo pikë kufiri kthehet në veri-lindje dhe ngjitet përgjatë kurrizit malor, kuotat 1052 m dhe 1569 m deri të Livadhet e Sulës nga ku zbret kurrizit në veri-perëndim deri të përrocka (në lindje të kuotës Tepe 1271 m.) për tu ngjitur pastaj kurrizit në drejtim të veri-lindjes deri tek Shkrepi duke mbërthyer brenda kufirit Ashtën. Kufiri pastaj e përcjell izohipsën 1700 m nëpër Shpatin Padhe deri të qafa Bubrrec (1709 m.) që gjendet mbi Grykën e Rusenicës. Kufiri mëtej zbret kurrizit malor në drejtim të veri-perëndimit deri të kuota Guri i Livadhit (1448 m.) dhe vazhdon kurrizit në veri - lindje deri të hyrja në Grykën e Rusenicës (750 m.), nga ku kthehet në jug-lindje për të vazhduar pastaj në veri-lindje përgjatë vegetacionit pyjor (kufirit të malit me livadhet) deri të kuota 830 m (pjesa e poshtme e Lleshçicës). Nga kjo kuotë kufiri përcjell me izohipsen 850 metra dhe e ndjekë atë deri te kuota 768 metra (Kulla) duke përfshirë Llokmën dhe Arën e Selimit. Pastaj kufiri kalon përgjatë përrockës dhe Grykës së Matozit deri te qafa e Përslap (kuota 1089 m.) nga ku e merr drejtimin e jug-lindjes dhe kalon përreth pjesëve të poshtme të Grykës (Klisurës) dhe Gurit të Përgjakur deri të kuota 1212 m. Nga këtu kufiri kthehet në veri-lindje dhe duke përcjellur izohipsen 1200 m. del të çesma e Imerit dhe vazhdon nëpër kuotën 1335 deri të Kroni i Mbretit. Kufiri pastaj zbret kurrizit malor të Malit të Mbretit deri të kuota 1068 m., nga ku kthehet në jug-lindje dhe përtej kuotave Tëbanat e Bukoshit (1546 m.) dhe 1655 m. del të kuota Rrafshina e Epërme (1443 m.) gjithnjë duke ndjekur kufirin natyror (përrockat, luginat dhe kurrizet malore). Nga kjo kuotë kufiri vazhdon në drejtim të jugut dhe jug-lindjes nëpër kuotën 1084 m deri tek kuota Çuka (1216 m.), nga ku kthehet në perëndim dhe nëpër majën e

Vishevicës (1230 m.) dhe Kryqit del në kuotën Presllap (1291 m.). Kufiri pastaj zbret në jug -perëndim deri të përrocka Zashtica (1000 m.) dhe vazhdon përgjatë përrockës në drejtim të jug - lindjes deri të derdhja e përrockës Vasil (pjesa e poshtme e Gurit të Vardishit) nga ku kthehet në jug - perëndim dhe ngjitet kurrizit malor të Llaçishtës deri të kuota Pisha e Vogël (1495 m.) për të vazhduar në drejtim të perëndimit deri tek kuota Rudina (1536 m.). Nga kjo kuotë kufiri vazhdon në drejtim të jugut përgjatë kurrizit malor dhe kuotës Tumba (1382 m.) deri tek derdhja e lumit Tisi në Lepenc (1119 m.) nga ku kthehet në jug-lindje mbi fshatin Sevcë nëpër kuotat Gobelinc (1297 m.); Kuk (1251 m.); Çuka e Poshtme (1260 m.) deri të kuota Guri i Prushit (1375 m.) nga ku zbret kurrizit deri te ura e Lumit të rrugën rajonale PrizrenShtërpçë. Pastaj kufiri vazhdon në veri-lindje përgjatë kësaj rruge dhe nëpër kuotat Borja e Poshtme (1232 m.); lumi Muzhnica (1036 m.); kuota (1086 m.); Penjarupa (1169 m.); Shkëmbi i Boçkës (1228 m.); Llazovi (Vlak) (1100 m.); Barojca, Glava (1228 m.); Uji i Bardhë (1100 m.); Lumi Klisura (1031 m.); Zmijaica mbi Drajkovc (1126 m.); Krividell mbi Firajë (1080 m.); Krena (904 m.); Përrocka e Madhe mbi Mallahën e Elezëve (780 m.) (lagje e fshatit Brod) deri të pjesët e poshtme të Jasikës mbi Mahallën e Ceklarëve (850 m.). Nga kjo pikë kufiri kthehet në jug-lindje deri të izohipsa 900 mbi Mahallën e Elezëve të cilën e ndjek në jug deri të kuota 900 m. për të vazhduar kurrizit malor deri te kuota mali Shulan (1154 m.) nëpër Përronin e Shpatit. Pastaj kufiri kthehet në jug-lindje deri të kuota 941 m. në rrugën pyjore të cilën e ndjek deri të rruga rajonale Shtërpçë – Doganaj - Gllaboçicë. Kufiri mëtej vazhdon në jug përgjatë rrugës rajonale deri te kthesa e Kepit të Kurtës nga ku në drejtim të jug-perëndimit ngjitet grykës së Kepit të Kurtës për tu përmbyllur në pikën fillestare izohipsa 1050 në kufirin shtetëror Kosovë - Maqedoni¹

6.3. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS


6.3.1. Relievi

Territori malor i Sharrit, i cili ndodhet brenda parkut kombëtar, karakterizohet nga malet e larta në pjesën e tij jugore, të cilat përfaqësojnë edhe majat më të larta të Sharrit. Morfologjia e Malit Sharr është rezultat i lëvizjeve tektonike që kanë krijuar karakteristikat kryesore gjeomorfologjike dhe i ndikimit të forcave të jashtme, siç janë akullnajat dhe rrjedhjet ujore. Kështu, për shkak të veprimit të akullnajave me të cilat kanë qenë të mbuluara pjesët e larta të Sharrit, janë krijuar një numër i madh i të ashtuquajturave thellime akullnajore ose cirqe, valëve si dhe sasive të mëdha të morenave (materialit akullnajor). Në disa raste këto thellime (cirqe) më vonë janë shndërruar në liqene të akullnajave, ndër të cilët më të njohurit janë liqenet tejet atraktiv të Livadicës dhe Jazhincës.

Numri më i madh i thellimeve akullnajore ndodhet në rrëzën e majave më të larta, në pjesën më jugore të territorit të parkut kombëtar, siç janë Bistra, Livadica, Çuka e Liqeve, ndërsa grupi më i madh ndodhet nën majën e Piribregut (2522m¹), e njohur me emrin Vrima e Brevcit. Theksohen thellimet cirkore te Çuka e Liqeve dhe Livadica. Nga këto cirqe nisen ultësirat e dikurshme të akullnajave. Posaçërisht duhet të theksohet vala Demir Kapija e cila fillon nga cirku i dikurshëm ku sot është Liqeni i Livadicës. Vala e Demir Kapisë që është me fund të gjerë dhe me anë plotësisht të pjerrët, përfaqëson formën më të njohur fosile të ultësirës akullnajore në Sharr, i gjatë është rreth 1,5 km. Në formën morfologjike të Sharrit në një përmasë më të madhe ndikojnë rrjedhjet lumore. Territori i Sharrit është i ndërprerë me luginat e panumërta të lumenjve dhe përroskave, të cilat kryesisht derdhen në Bistricën e Prizrenit, në Lepenc dhe luginën e Pllavës.

Në pjesën jugore të parkut kombëtar, përkatësisht në rrjedhat e sipërme të lumenjve: Muzhicë, Bollonjskë, Bllateshticë, Suva etj, luginat janë të prera thellë (250m deri 400 m), të ngushta dhe me anë të pjerrta, duke krijuar pamje të grykave ose kanjoneve. Kjo karakteristikë është e pranishme kryesisht në luginat që ndodhen mbi 1200m e deri 1400m. të l.m., ndërkaq në pjesët më të ultë luginat kanë pamje normale.

¹ Ligji Nr.04/L-087, Për Parkun Kombëtar "Sharri"



Harta x. Relievi

6.3.2. Gjeologjia e terrenit

Në ndërtimin gjeologjik të Sharrit marrin pjesë shkëmbinjët e përbërjes dhe vjetërsisë së ndryshme. Përhapje më të madhe kanë rasat paleozike, pastaj shkëmbinjët karbonat të mermerit dhe serpentinit si dhe formacionet diabaz, sedimentet e liqejve neogjenë dhe aluvionet lumore në pjesët më të ulëta si formacion më i ri gjeologjik. Formacionet e paleozoikut kanë një shtrirje më të madhe dhe pikërisht kjo e bënë diferencimin themelor prej pjesëve të tjera malore të Kosovës. Formacionet e paleozoikut të përfaqësuara me filitet dhe rreshtet sercite, në formë të brezit të ngushtë, shtrihen prej majës Bistra (2.640 m), duke vazhduar përgjatë kufirit të Kosovës me Maqedoninë e Veriut. Krahas tyre, në mënyrë fragmentare janë paraqitur formacionet e mesozoikut, përkatësisht kretakut dhe dolomitit në Shtërpçë dhe në lindje të majës Luboten². Në afërsi të Brezovicës është grumbulluar materiali morenik i procesit akullnajor.

Në zonën JP gjysma e territorit të Dragashit është formuar nga lloje të ndryshme të shkëmbinjve metamorfike. Dy zona janë të dominuara nga lloje të ndryshme të cilat kanë pësuar proceset metamorfike. Këto zona janë Koritniku dhe pjesët e maleve rreth Brodit dhe Restelicës. Ndërhyrje të Magmatites janë gjetur kryesisht në pjesën qendrore të Dragashit në mes të Kërstecit, Dragashit, Pllajnikut, Brodit, Zlipotokut dhe Krushevës. Sipërfaqet më të mëdha me ranor mund të gjenden më shumë në jugperëndim të maleve (Kesula e Priftit), sipërfaqe më të vogla janë të shpërndara në të gjithë zonën. Afërsisht 20% e tokës në komunë është formuar nga sedimentet kuaternare të origjinës fluviale ose akullnajore.

² Dr. Riza I. Çavolli, Gjeografia regjionale e Kosovës, Prishtinë 1997, Fq.14.

tepër gjatë dimrit, sidomos në pjesët e ekspozuara kah dielli. Ky rajon rrallë herë goditet nga breshëri. Numri i pa mjaftueshëm i vend-matjeve sipas lartësisë mbidetare mbi 1000 metra tregon se sasia e reshjeve nuk është reale për reshjet që bien në zonat malore me klimë lindore kontinentale. Niveli i borës në këtë rajon ka arrit lartësinë deri në 3 metra në vitin 1956. Numri i ditëve me reshje bore dhe lartësitë më të mëdha të bores, pas asaj të vitit 1956, janë realizuar në vitin 1981, në Jazhincë kemi 117 ditë me lartësi 89cm dhe në Shtërpçë 108 ditë me lartësi 90 cm.

Është karakteristikë e përgjithshme së klima e këtij territori ofron mundësi të jashtëzakonshme për valorizimin turistik si gjatë dimrit ashtu edhe për stinët e tjera vjetore. Vlerat e temperaturës së malit Sharr për dallim prej territorit që e rrethon, janë shumë të ulëta, nga kjo edhe gjatësia e periudhës me temperatura të ulëta, gjegjësisht periudhës dimërore është me e madhe, përkatësisht zgjatë deri në 4 muaj, e që kushtëzon krijimin e mbulesës së trashë të borës dhe mundësinë e valorizimit turistik për sportet dimërore. Po ashtu, duhet cekur dukurin meteorologjike - inverzionin e temperaturës, i cili krijohet për shkak të nxehjes jo të barabartë të shpateve malore dhe ultësirave, e që përfaqëson përshtatshmërinë për valorizim turistik. Gjatë kësaj kohe në viset më të larta (territori shtëpisë së Stojkut, Piri bregu, Jelovaniku), temperaturat e ajrit mund të jene për disa gradë me te larta se në rrafshin e Kosovës gjatë sezonës së dimrit. Kjo situatë klimatike është e përshtatshme për qëndrimin e skiatorëve. Gjatë verës vlerat e lëkundjes së temperaturës në Malin Sharr nuk janë të larta që po ashtu shkon në favor të zhvillimit të turizmit rekreativ veror.

6.3.4. Veçoritë hidrologjike


Parku Kombëtar "Sharri" ka veçoritë hidrologjike të shquara, të cilat i japin një atraktivitet të veçantë këtij territori. Një karakteristikë e rëndësishme është se rrjedhjet e ujërave në sipërfaqe, nga burimi deri në grykëderdhje, janë të shpeshta. Përveç rrjedhjeve të shpeshta dhe të pasura, me ujë të përrenjve dhe lumenjve malorë, ka një numër të konsiderueshëm ujëvarash dhe rrjedhjesh rrëke në të gjitha drejtimet. Gjithashtu, në rajonin e Malit Sharr gjenden disa liqe akullnajorë (glacial) që e pasurojnë këtë territor.

Lumenjt – Pothuajse i tërë territori i parkut kombëtar i takon dy pellgjeve të lumenjve më të mëdhenj – Lepencit dhe Lumëbardhit të Prizrenit. Për nga atraksioni dallohet Lepenci përkatësisht degët e djathta të tij të cilat njëkohësisht kalojnë edhe nëpër pjesët më të bukura dhe shtigjet kryesore të skijimit të Malit Sharr. Lepenci buron dhe krijohet me bashkimin e rrjedhjeve të cilat burojnë nga malet e Cerevës dhe Jezercit. Në rrjedhjen e vetë nëpër territorin e parkut atij i bashkangjiten disa degë nga ana e majtë dhe e djathtë. Posaqërisht janë të rëndësishme degët e djathta të përrenjëve dhe lumenjëve siq janë Lumi i Thatë, Murzhica me degët e veta tejet atraktive Proska e Dulës, Bllateshtica, lumi i Bollonjskës dhe Kallugjerica. Këta lumenj, degët burimore të të cilëve vijnë nga malet më të larta në pjesët më jugore të parkut nacional, janë të shpejta me një numër të ujvareve dhe rrjedhjeve të rrëkeve me prurje mesatare vjetore $8.4\text{m}^3/\text{s}$.

Derisa rrjedhja e Lepencit zë pjesën më të madhe verilindore të parkut kombëtar, derdhja e Lumëbardhit të Prizrenit mbulon pjesët jugperëndimore të tij. Pjesën më të madhe të këtij pellgu lumor e përbëjnë degët e majta, të cilat burojnë nga malet e larta të Majës së Zezë, Kobilicës, Kara Nikollës etj, dhe si të tilla rrjedhjet e sipërme të tyre janë shumë të shpejta dhe atraktive. Posaqërisht dallohet dega e proskës së Lubinit me degët e veta. Prurjet mesatare të pellgut të Lumëbardhit të Prizrenit janë $6.49\text{m}^3/\text{s}$.

Lumenjt në Regjionin e Dragashit, përkatësisht zona ku shtrihet Parku Kombëtar "Sharri" është e pasur me burime ujore dhe rrjedhje ujore të përrockave, përrenjve dhe lumenjve të vegjël. Zona i takon dy pellgjeve detare: Adriatikut që derdhet përmes lumit kryesor Drini i Bardhë dhe Egjeut që derdhet përmes Vardarit (Maqedoni e Veriut). Lumenjt e ujëmbledhësit të Detit Adriatik që i kanë burimet në këtë zonë janë:

Lumi i Zaplluzhës, lumi i Shehut të Vogël, lumi i Shehut të Madh, lumi i Kukut, lumi i Pllajnikut, lumi i Srednicës, lumi i Brodit, lumi i Dushkajes, lumi i Restelicës dhe lumi i Plavës. Sipas matjeve lumi Pllava ka prurje $5.25\text{m}^3/\text{s}$.³



Harta x. Hidrografia

Liqenet – Liqenet glacialë paraqesin një rëndësi të madhe të Malit Sharr. Në lartësinë mbidetare mbi 1900 metra ka disa liqe të cilët posaçërisht dallohen sipas bukurisë dhe madhësisë që janë: Liqeni i Livadicës, Liqeni i Jazhincës, e Gornjasellës, Karanikollës, Miskovës, Bezdankës etj. Liqeni më i madh është ai i Livadicës, i cili shtrihet nën majën malore me po të njëjtin emër në l.m. prej 2,173 m. Ka formë të zgjatur, me gjatësi prej 230 m, gjerësi 120 m, dhe thellësinë më të madhe prej 7.3 m. Në kohën e verës temperatura e ujit ndonjëherë arrijnë edhe deri në 20°C.

Liqeni i Jazhincës shtrihet në pjesën shkëmbore të Sharrit, nën majën e Bistrës. Është më i vogël se Liqeni i Livadicës, ka gjatësinë prej rreth 120m, gjerësinë 80m dhe thellësi deri në 11m. Liqenet e Gornjësellës (i Epërm dhe i Poshtëm) shtrihen mbi burimin e Bisticës së Prizrenit me gjatësi 100 m, gjerësi 53 m dhe thellësi 1.5 m. Ngjyra e ujit liqenor shkon prej të kaltrës deri në të gjelbër. Liqeni i madh i Shutmanit ka shtrirje në mes të fshatrave Brod dhe Restelicë. Liqenet tjera janë liqeni i vogël i Shutmanit, liqeni në malin Çemeriq, tri liqene në malin Gorni Def dhe liqeni i Kautovës.

6.3.5. Veçoritë peizazhore

Hapësira e parkut kombëtar përmban një gamë të gjërë të peizazheve të bukura të cilët shtrihen më shumë në viset e larta dhe të mesme malore. Këto peizazhe paraqiten përmes elementeve të bukura të natyrës, si malet e larta, kodrat, luginat, lumenjtë, ujëvarat, shkëmbinj të shkrepur dhe thellimet e akullnajave. Në zonat më të ulëta të parkut kombëtar, siç janë regjioni i Sredskës dhe Siriniqit, peizazhi kombinohet harmonikisht me kulturat bujqësore dhe kopshtet.

³ AMMK, Raporti I gjendjes së ujërave në Republikën e Kosovës, 2015 Prishtinë

Tërësi më tërheqëse peizazhore janë sipërfaqet e mbuluara me pyje, barë, livadhet, kullosat dhe formacionet e tjera barishtore, të cilat gjenden në lartësitë mbidetare 1000m deri në 1500m. Këtu formacionet e pyjeve të ahut, arnenit, molikës, bredhit, hormoqit, etj ndërrohen me formacionet e barishtoreve duke u paraqitur në të gjitha nuancat e ngjyrës së gjelbër që shkaktojnë një përjetim jashtëzakonisht të mirë vizual të bukurisë natyrore. Në këtë zonë, ndarja e madhe e relievit që është krijuar me prerjen e një sërë luginash të lumenjve dhe përroskash, në formë të kanioneve dhe grykave, me ujëvarat dhe liqenet e shumtë e plotëson përjetimin e kësaj natyre autentike, të bukur dhe të paprekur. Në pjesët e ulëta të Sharrit, gjatë verës në livadhe lulëzojnë lulet malore me ngjyra të ndryshme duke i dhënë peizazhit atraksion dhe bukuri të jashtëzakonshme, aromë dhe freski të posaçme të natyrës së pastër.

Përjetim të jashtëzakonshëm vizuel të bukurisë natyrore, Mali Sharr ofron në stinën e vjeshtës, në kohën e krijimit të peizazhit kalues malor kur i tërë territori mbulohet me të gjitha ngjyrat e spektrit, si dhe në pranverën e vonshme kur në viset e ulta harliset vegetacioni bimor duke e mbuluar tërë territorin në gjelbërim, ndërsa majat e larta të Lubotnit, Bistrës dhe maleve tjera edhe më tutje janë nën mbulesën e bardhë të borës.

Pejzazhi “Plaku i Sharrit” – është njëri nga peizazhet unike në territorin e PK “Sharri” dhe njëri nga të vetmit që për specifikë ka profilin shumë të dallueshëm të kokës dhe trupit të njeriut në gjendje të shtrirë. Pika më e mirë nga e cila shihet “Plaku i Sharrit”, është shpati jugor i “Arnenit” dhe terasat e restoranteve të ndërtuara në këtë zonë. Koha më e përshtatshme për vrojtimin e peizazhit “Plaku i Sharrit” është stina e verës, kur ndriçimi është maksimal dhe karshi pejzazhit (gjatë orëve të paradites deri në mesditë) dhe në kohën kur vegetacioni është në kulmin e ngjyrave të tij.

“Plaku i Sharrit” shtrihet në pjesën jugore të parkut, në vargmalet të cilat nga cepi verior i peizazhit fillojnë me Majen e Koritnikut, për të vazhduar më tutje në drejtim të jugut me rezervatet e natyrës: “Kobilica”, “Maja e Zezë”, “Lumbardhi i Prizrenit”, dhe për të përfunduar me fshatin “Gornja Sellë” dhe Prevallën si qendër turistike, në cepin më jugor të tij.



Foto x Pejzazhi “Plaku i Sharrit”

Pejzazhi nga Liqeni i Jazhincës ofron një pamje spektakulare dhe të shumëllojshme që ndryshon gjatë gjithë vitit, duke pasqyruar bukurinë e natyrës së paprekur të Maleve të Sharrit.

Peizazhi nga Liqeni i Jazhincës drejt burimit të lumit Lepenc, Arnenit, Oshlakut, Koxhaballkanit dhe më gjerë është një përzierje harmonike e elementeve natyrore që krijojnë një pamje të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme. Ky peizazh ofron një përvojë unike për çdo vizitor dhe është një thesar natyror që duhet të vizitohet dhe të shijohet në çdo stinë të vitit.

Në njërin anë të liqenit, maja e Arnenit ngrihet lart dhe dominon peizazhin. Kjo majë e lartë është e mbuluar me pyje dhe barishte, dhe shpeshherë gjatë muajve të verës, bari i gjelbër dhe lulet e egra krijojnë një mozaik ngjyrash që kontraston bukur me qiellin e kaltër dhe ujin e liqenit.

Në drejtim të jugut, maja e Oshlakut ofron një pamje spektakolare, i njohur për formacionet e tij shkëmbore dhe shpatet e pjerrëta, që i japin peizazhit një karakter të ashpër dhe dramatik.

Nga një tjetër perspektivë, Maja e Koxhaballkanit me siluetën e saj të veçantë, është një pikë orientuese për shumë udhëtarë dhe alpinistë. Pamja nga liqeni drejt Koxhaballkanit është veçanërisht e bukur në muzg, kur dielli perëndon pas malit, duke krijuar një lojë dritash dhe hijesh mbi liqe dhe malet përreth. Në ditët me shikueshmëri të lartë, peizazhi nga Liqeni i Jazhincës ofron një pamje të gjerë dhe të larmishme me karakteristika tjera mbresëlënëse natyrore.



Foto x Peizazhi nga Liqeni i Jazhincës

6.3.6. Vegjetacioni

Territori i Parkut Kombëtar “Sharri” dallohet me begati të florës dhe me shumë breza vegjetativ, të cilët janë në pajtim me ndërrimin e lartësive mbidetare, me begati në bashkësi të rralla endemike të pyjeve dhe livadheve. Këtu hasen lloje të ndryshme si dushku *Quercus*, ahut *Fagus moesiaca*, bredhi, hormoqi, pisha e bardhë, pishat endemike dhe relikte të maleve të larta: rrobulli (*Pinus heldreichii*) dhe arneni i bardh (*Pinus peuce*) si dhe pisha e maleve të larta kërkëleka (*Pinus mugo*). Në kuadër të këtyre përbërjeve pyjore përveç numrit të madh të llojeve drunore të cekura haset edhe panja malore endemike (*Acer heldreichii*), si dhe lloji drunor, tejet i rrallë dhe gati i zhdukur nga këto male, bresheu i rëndomtë (*Taxus baccata*) dhe shumë lloje tjera të rëndësishme drunore dhe barishtore.

Vegjetacioni i PK “Sharri” në përhapjen vertikale përputhet me llojshmërinë e përgjithshme të verifikuar dmth. se përbërja e saj ndërron me ndërrimin e lartësive mbidetare me ç’rast diferencohen brezat vegjetativë:

- Territori kodrinor termofil i pyjeve të dushkut - *Quercus troyana* (Bulgri), *Q. Conferta* (Shpardhi), *Q. Cerris* (Qarri), *Q. Pubescens* (Bungbuta), *Carpinus orientalis* (Shkoza e zezë), etj. ka mbetur jashtë kufinjve të parkut.
- Territori kalues termofil i bungut - *Quercus petraea* (Bungu) dhe *Carpinus betulus* etj. pjesërisht është përfshirë në kuadër të parkut kombëtar. Në kuadër të këtij territori dominojnë pyjet e bungut qarrit dhe shkozëbardhës, një numër i madh i llojeve të tjera drunore si: murrizi, dardha e egër, shikakuqi, etj.
- Territori mezofil i pyjeve të ahut (*Fagus moesiaca*) – Në kuadër të territorit të vet të përhapjes paraqitet në dy grupe asociacionesh dhe atë: bashkësia kodrinore e ahut (*Fagetum montanum*) dhe bashkësia e bredhit dhe ahut (*Abieto-fagetum*), ndërkaq në viset më të larta paraqitet hormoqi. Bashkësitë e ahut janë të zhvilluara gati në tërë territorin e parkut duke përfshirë lartësitë mbidetare ndërmjet 900 – 1500 m, kurse në disa vende nuk është sa duhet i përfaqësuar siq është rasti në ekspozicionin jugperëndimor të masivit të Oshlakut.
- Vegjetacioni halor pyjor frigorifil i lartë malor – Ky territor vegjetativ i kësaj lartësie në PK “Sharri” përbëhet prej bashkësive endemike të pishave malore endemo-relikte të molikës (*Pinus peuce*) dhe rrobullit (*Pinus heldreichii*), të cilat nga shumë aspekte janë të rëndësishme. Këto bashkësi më mirë janë ruajtur në Shtëpia e Stojkut dhe në Koxha Ballkan (ose Pisha e

Madhe), Ujrat e Humbura (Gine Vode), Maja e Arnenit (Popovo Prase), Oshlak, dhe Pashallarët (Ostrovicë).

- Vegjetacioni kalues shkurre i klekës së maleve të larta – Përbërjet e kërkës (Pinus mugo) janë të ruajtura vetëm në Koxha Ballkan, Oshlak dhe Ostrovicë, ku kjo pishë malore tejet interesante paraqitet në formë të bashkësisë, ndërsa në pjesët tjera ku nuk është kërkës, janë prezente llojet e tjera shkurre, e në mes tyre dëllinja e Siberisë (Juniperus nana) dhe një lloj i rëndësishëm Rhododendron ferrugineum (Rododendroni ngjyrë ndryshku), Bruckhenthalia spiculifolia, Erica carnea etj. Kësisoj kjo zonë është tejet e pasur me bashkësi të rëndësishme në mes të cilave cekim bashkësinë endemike Bruckhenthalion etj.
- Vegjetacioni barishtor dhe shkurre i maleve të larta – Ky territor vegjetativ i livadheve dhe kullosave malore dhe kullosave të larta me sipërfaqe prej 16170 ha, është tejet i pasur me bashkësi të rëndësishme bimore. Në kullosat e larta malore, duke marrë parasysh mënyrën ekstenzive të shfrytëzimit, dominojnë bashkësitë e xhufkës (Nardus stricta), si pasojë e suksesionit negativ. Posaqërisht janë të rëndësishme bashkësitë e bimëve të cilat janë zhvilluar në lartësi më të mëdha, ku më tepër dominojnë elementet e florës sarkto-alprike. Për nga aspekti fitocenologjik, në kuadër të kullosave të PN “Mali Sharr”, duhet të diferencohet territori i livadheve dhe kullosave malore sepse, pikërisht në këtë zonë faktori antropogjen historikisht me prerjen e pyjeve e ka ndërruar përbërjen e mëparshme të bashkësisë, në esencë është ndërruar përbërja fitocenologjike.

6.3.7. Flora

Për nga aspekti floristik, PK “Sharri” bën pjesë në malet më të begatshme të Gadishullit Ballkanik. Këtu vërehet prezenca e një numri të llojeve drunore endemike dhe relikte, siç janë pisha e bardhë (Pinus peuce) pisha e Bosnjës (Pinus heldreichii), artari malor (Acer heldreichii), tisja (Taxus baccata), kërkës apo pisha e vogël (Pinus mugo), lloj i rëndësishëm për pyllëzimin e sipërfaqeve të eroduara si dhe Rododendroni ngjyrëndryshku (Rhododendron ferrugineum).

Në zonat e larta malore të parkut ka lloje të rëndësishme të cilat gjenden kryesisht në malet e larta të Europës jugore dhe qendrore (Alpe, Apenine, Karpate, Pirinej, Tatra). Këto përfshijnë: Trollius europaeus (Trolli evropian), Ranunculus montanus (Zhabinorja malore), R. Thora (Zhabinorja tora), R. Crenatus (Zhabinorja ura-ura), R. Oreophylus (Zhabinorja maledashëse), Dianthus sylvestris (Karafil i pyjor), Daphnea alpine (Xërxelja alpine), Rhododendron ferrugineum (Rododendroni ngjyrëndryshku), Draba retush (Draba e cunguar), Salix retush (Shelgu i fletëtopitur), S. Reticulate (Shelgu i rrjetëzuar), Empetrum hermafroditum (Empetri), Dryas octopetala (Driada tetëpetalëshe), Geum reptans (Mlaka zvarranike), G. Montanum (Mlaka malore), Saxifraga oppositifolia (Iriqëza gjethekundrejtë), S. Marginata (Iriqëza arëtores), S. Aizoon (Iriqëza si thonjë), S. bryoides, S. tymosa, Gentiana verna (Genciana pranverore), G. Nivalis (Genciana), Junkus trifidis (Kulmaku i çarë tresh), Elyna myosuroides, Carex rupestris (Presja), Carex curvula, Craex foetida, carex tigra (Presja e zezë), Poa minor (Flokëza e vogël), Avena versicolor (Tërshëra) dhe shumë lloje tjera.


Llojet bimore mjekësore janë: Achillea millefolium (barpezmi mijëfletësh), Arctostaphilos uva – ursi (rrush arushë), Atropa beladonna (helmarina), Hypericum perforatum (lulebalsami), Thymus serpyllum (zhumbrica), Veratrum album (shtara e bardhë), Gentiana punctata (lloji i sarëzës) etj. Ndryshe nga llojet bimore që ndodhen në zonat e larta me borë, në pjesën e poshtme të malit, për shkak të ndikimit të Mesdheut përgjatë Lumit të Prizrenit dhe Grykës së Kaçanikut, jetojnë lloje të tjera si: Salvia officinalis (Salvia officinalis), Ruta divaricata (Ruta), Teucrium podium (Arrësi barëmajasëlli), Asparagus acutifolius (Ferrëmiu), Pistacia terebinthus (Bafra), Koeleria splendens (Këleria e shëndritshme), Asineuma limonifolium, Stipa mediteranea (Pendëkaposhi mesdhetar), Parentucella latifolia

(Parenticella gjethegjërë), Linaria pelliseriana (Linaria e peliserit), Thesium divaricatum (Armiza e stërhapur), convolvulus elegantissimus (Derdhja), Centaurea deusta (Kokoçelli), Linaria annua (Linaria) e tjera.

Disa lloje karakteristike të bimëve në Parkun Kombëtar “Sharri” përfshijnë:

- Llojet e karafilëve: Dianthus scardicus, D. integer, D. gracilis
- Llojet e zhabinoreve: Ranunculus incomparabilis
- Llojet e minuartes: Minuarta graminifolia, M. bosniaca, M. verna
- Llojet e sileneve: Silena saxifraga, S.schuckerii, S.asterias
- Llojet e groshlave: Cardamine carnosa, C.barabaroides
- Lloji Arabis alpina
- Lloji i kripshtit: Alysum corymbosum, Alysum scadicum
- Llojet e drabave: Drbakorabensis, Draba scardica
- Llojet e vjollcave: Viola grisebachiana, V.gracilis, V.orphanidis
- Llojet e krimbsit: Sedum macelense, S.flexuosum, S.grisebachii gurshpueset: Saxifraga scardica, S.porophylla, S.glabella tërfilët: Trifolium pseudomedium, T.pingnathii, T.velenovsky
- Lloji: Panicica serbica
- Llojet e kromave: Knautia drymeia, K.dinarica
- Llojet e rrillpeshkut Verbascum scardicollum, Verbascum longifolium ramonda: Ramondia serbica;
- Trumëzat: Thymus albanus, Th.rohlenae, Th.jankae; Lule zambaku: Lilium albanicum etj.

Kjo pasuri dhe diversitet i florës në Parkun Kombëtar “Sharri” thekson rëndësinë e jashtëzakonshme të tij në aspektin e florës. Besohet se regjistri i llojeve të bimëve do të bëhet shumë më i pasur dhe më i plotë me përparimin e hulumtimeve të ardhshme botanike në park.



Harta nr.x - Llojet e veçanta të florës në Parkun Kombëtar “Sharri”

6.3.8. Fauna

Territori i PK "Sharri" me biotopet e ndryshme është shumë i pasur në pikëpamje faunistike. Në të janë prezentë lloje të veçanta të shtazëve, të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike, që do të thotë se përhapja e tyre është e ngushtë dhe i përkasin llojeve endemike. Llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e parkut dhe në përgjithësi fauna e Kosovës nuk është hulumtuar sa duhet. Deri më tani janë evidentuar: 7 lloje peshqish, 9 lloje amphibie, 10 lloje reptil, 154 lloje shpend dhe 30 lloje gjitarësh.

Peshqit (Pisces) - Territorin e PK "Sharri" e karakterizojnë rrjedhjet e përroskave dhe lumenjve malor që i takojnë lumenjve të pellgut të Adriatikut. Në bazë të njohurive të deritanishme në këto rrjedhje jetojnë këto lloje të peshqve: trofta e përroskave (*Salmo trutta* m.faro L.), mustaku i proskave (*Barbus fluviatilis* Ag.), ngjala (*Anguilla vulgaris*), mlyshi (*Esox lucius*), krapuliqi, krap (Cyprinus carpio), perka (*Perca fluviatilis*).

Ujëtokësorët (Amphibia) - Në PK "Sharri", ujëtokësorët prezantohen me llojet: Picrraku (*Salamandra maculosa*), picrraku i zi (*Salamandra atra*), tritoni i zakonshëm (*Triturus vulgaris*), thithëlopa (*Bufo bufo*), thithëlopa e gjelbër (*Bufo viridis*), gargaliqi (*Hyla arborea*), bretkoca e pyllit e kuqërremët (*Rana temporaria*), bretkoca kërcimtare (*Rana dalmatina*) dhe bretkoca e përrenjëve (*Rana graeca*).


Zvarranikët (Reptilia) – Në park jetojnë: Breshkujza (*Emys orbicularis*), breshka tokësore (*Testudo graeca*), hardhuca e gjelbër (*Lacerta viridis*), hardhuca e mureve (*Lacerta muralis*), hardhuca e përhimë (*Lacerta agilis*), gjarpri i madh i ujit (*Natrix natrix*), gjarpri i vogël i shiut (*Natrix tessellata*), nepërka (*Vipera ammodytes*), neperka e malit (*Vipera berus*) dhe kokëzogëza (*Anguis fragilis*).

Gjitarët (Mammalia) - Fauna e gjitarëve që jetojnë në park është e përfaqësuar gati me të gjitha llojet të cilat jetojnë në Kosovë, si dhe ca lloje të cilat me ekologjinë e tyre janë të lidhura ekskluzivisht me biotopet e viseve të larta malore, ndërsa llojet tjera janë të përhapjes së gjerë. Kështu mund të konstatohet se PK "Sharri" e karakterizojnë edhe lloje endemike të gjitarëve.

Insektngrënësit (Insectivora) janë: iriqi (*Erinaceus europeus*), urithi (*Talpa europae*), rrëmihësi i randomët (*Sorex araneus*), kurse brejtësit (Rodentia): lepuri i fushes (*Lepus europaeus*), miu bizam (*Ondatra zibethica*), miu i fushes (*Arvicola terrestris*), miu i shtepisë (*Mus musculus*), miu me vija (*Apodemus agrarius*), miu i pyllit (*Apodemus silvaticus*), gjeri i madh (*Glis glis*), gjeri i lajthive (*Muscardinus avellanarius*), ketri (*Scirius vullgaris*), qeni i verbër (*Spalax monticola*), *Cricetus vulgaris*, *Cricetus cricetus* dhe *Castor fiber*.

Mishngrënësit (carnivora) - Rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Canis vulpes*), macja e egër (*Felis silvestris*), baldosa (*Meles meles*), zardafi (*Martes martes*), fishnjari (*Martes foina*), lundërza (*Lutra lutra*), bukla e vogël (*Mustela nivalis*), qelbesi (*Putorius putorius*). Jopërtypësit: derri i egër (*Sus scrofa*), Ripërtypësit: kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*). Duhet thënë se lakuriqët (Chiroptera) të cilat jetojnë në këtë territor deri tani askush nuk i ka studiuar, prandaj nuk dihet numri i llojeve të cilat aty jetojnë.

Shpendët (Aves) - Shpendët e parkut paraqiten në të gjitha biotopet, ndërsa numri i llojeve dhe populacioneve të tyre i tejkalon të gjitha klasat e tjera të faunës me përjashtim të insekteve.



Harta xx Llojet e veçanta të faunës në Parkun Kombëtar “Sharri”

6.3.9. Ndotja dhe degradimi

Në territorin e parkut nuk ka monitorim të mjedisit dhe për këtë arsye kemi mungesë të informatave sa i përket shkalles së ndotjes të elementeve mjedisore ajrit, ujit dhe tokës.

Degradimi i pyjeve është më e shprehura si dukuri negative, ku si shkak kryesor janë prerja ilegale dhe djegjet. Mesatarisht 200-300 ha livadhe dhe shkurre digjen në secilin vit. Këto ndodhin në 10 -15 lokacione të ndryshme. Rrezik shumë i madh është se nga zjarri në livadhe mund të kaplohen edhe pyjet siq ka ndodhur me zjarret që kanë dëmtuar zonën e Prevalles dhe Oshlakut. Zonat pyjore të rrobullit që shtrihen në pjesën e Oshllakut, Koxhaballkan dhe Pashallare me sipërfaqe prej 10 %, janë të dëmtuara si pasojë e zjarrit pyjor të vitit 2000 dhe zhvillimit intensiv të insekteve dëmtuese që janë shfaqur në mënyrë masive pas djegëjes. Në kuadër të saj tërësisht të dëmtuara janë 4.5 %, ndërsa sipërfaqet me pyje të ulta dhe shkurre janë të dëmtuar për rreth 45 % si pasojë e prerjes së pakontrolluar. Nga kjo dukuri, në komunën e Suharekës, në rajonin e Dellocit dhe Mushtishtit, janë degraduar pyjet e ahut me rreth 20 ha.

Degradimi i tokës është i shprehur në disa pika në kuadër dhe përreth parkut, në formën e gërryerjes së sipërfaqes së tokës dhe përpunimit të mëtutjeshëm të këtij materiali. Kjo formë e intervenimit është shumë e dëmshme për shkak se: dëmtton konfiguracionin e terrenit, e shkatërron peizazhin dhe çka është më e rëndësishmja për shkak të zhurmës së krijuar, ndikon në largimin dhe zhdukjen e florës dhe faunës. Në bazë të hulumtimit u vërtetua se në kuadër ose në afërsi të parkut (sipas shënimeve të mbledhura të vitit 2002, 2004 dhe 2007) ekzistojnë trembëdhjetë gurëthyes që dallojnë për nga madhësia dhe teknika e shfrytëzuar. Momentalisht pjesa më e madhe e tyre e kanë shuar aktivitetin duke i përjashtuar dy prej tyre që ende funksionojnë. Fjala është për gurëthyesin që ndodhet në pjesën veriore të Rezervatit të Rusenicës (fillimi Grykës së Rusenicës), në largësi prej 1.5 km në JP të fshatit Mushtisht që si territor i takon komunës së Suharekës. Dhe, gurëthyesi tjetër që gjendet rrëzë malit

Tërmetet - Në përgjithësi Kosova konsiderohet zonë aktive sizmike që shtrihet në mes të dy zonave sizmike, atë të bregdetit të Adriatikut dhe atë të luginës së Vardarit me shkallë merkali VII-VIII. Në zonën e Dragashit nuk janë regjistruar tërmete të fuqishme por ka patuar dridhje të tokës edhe në këtë zonë me ç' rast epiqendra ka qenë larg zonës. Këto tërmete kanë qenë me shkallë nga 2.7 - 4.8.


Ortiqet - Janë fenomene që paraqiten në këtë zonë dhe shkatërrojnë të mirat materiale e fatkeqësisht ata kanë marrë edhe jetë njerëzish. Zona e malit Sharr afër vendbanimeve njihet si zonë e zhveshur nga bimësia ku ortiqet janë dukuri e shpeshtë dhe karakteristike e zonës. Një ortek bore me thellësi 10 m dhe me gjërësi 500m, në shkurt të vitit 2012 ka goditur 15 shtëpi në fshatin Restelicë me ç' rast e kanë humbur jetën 9 persona.

Ndërtimet - Presion shumë i madh në brendi të parkut dhe për rreth saj janë ndërtimet e shtëpive pushimi, restoranteve, moteleve, hoteleve, stazat e skijimit si dhe përhapja e fshatrave në brendi të parkut. Janë ndërtuar rreth 500 objekte pa një infrastrukturë urbane .

Mbikullësja - Qasja në brendi të parkut nga sektori i blegtorisë nuk kanë një përcaktim zonal të shfrytëzimit të kullosave. Lëvizja e bagëtisë edhe në drejtim të zonave të para ndikon negativisht në humbjen e biodiversitetit të specieve endemike. Kjo veprimtari zhvillohet nga fermerë në zonën e Dragashit, Prevallës, Brezovicës dhe Lubotenit.

Gjuetia ilegale - Në bazë të të dhënave, nga gjuetia ilegale pësojnë kafshët e egra të cilat janë nën mbrojtje. Deri 300 copë dhi të egra, 1-2 arinj, derra të egër, kaproj dhe numër i madh i shpezëve vriten brenda vitit. Kanë qenë edhe 2-6 raste që edhe rrëqebullin e kanë vrarë gjatë aktivitetit ilegal të gjuetisë.

Mbledhja e bimëve dhe produkteve tjera të egra - Dëmtimet dhe rrezikimi me zhdukje të bimëve të rralla, si dhe prishja e harmonisë në mes të faunës së egër dhe bimësinë janë vërejtur gjatë mbledhjes ilegale të bimëve dhe produkteve të egra. Në park, kryesisht mblidhet me mjete mekanike dhe primitive boronica, bimët medicinale, kërpudhat dhe të tjera. Ndikimi i dëmshëm nga kjo veprimtari është dëmtimi dhe rrezikimi i florës por edhe faunës.



Harta nr. X Zonat sizmike në PK “Sharri”

6.3.11. Rezervatet strikte të natyrës në Parkun Kombëtar “Sharri”⁴

Parku Kombëtar “Sharri” shquhet për mjedisin e tij natyror me vlera të jashtëzakonshme. Në kuadër të një llojllojshmërie biologjike të pasur, pasuritë më të rëndësishme që i ka parku janë 15 rezervatet strikt të natyrës dhe monumenti i natyrës “Gryka e Lumbardhit”. Kjo e fundit është një zonë me karakter hidrologjik dhe gjeomorfologjik që është shpallur nën mbrojtje të shtetit në vitin 1976.

Rezervatet strikt të natyrës janë hapësira me vlera të veçanta natyrore të cilat karakterizohen me biodiversitet të pasur të florës, faunës, habitateve dhe të ekosistemeve. Ato në përbërjen e tyre karakterizohen me ekosistemet me potenciale autentike të pandryshuara ose pak të ndryshuara si rezultat i praktikave tradicionale të menaxhimit. Poashtu karakterizohen me dendësi të lartë të llojeve tipike, të rralla dhe endemike të bimësisë, me dendësi të lartë të bimëve që janë vënë nën mbrojtje dhe me shkëmbinj të veçantë. Rezervatet strikt të natyrës janë shumë të rëndësishëm edhe për linjat e migrimit të dhive të egra, arinjve dhe rrëqebujve. Këtu, jeta e lirshme e habitateve të botës bimore (flora me speciet pyjore, barishtore, etj) dhe shtazore (fauna me speciet e sisorëve, rrëshqitësve, shpezëve, etj), duhet të zhvillohet në kushte krejtësisht natyrore. Për shkak të fakteve të lartpërmendur këto rezervate sot gëzojnë shkallën më të lartë të mbrojtjes nga shteti, atë të mbrojtjes strikte, kështu që ato mund të shfrytëzohen vetëm për ta shijuar peizazhin dhe për nevojat shkencore dhe arsimore. Teksti në vazhdim e paraqet gjendjen sa i përket numrit dhe sipërfaqes së rezervateve të natyrës, ashtu siq ka qenë ajo para se të hyjë në fuqi ky plan hapësinor. Ndryshimet që janë bërë, janë dhënë tek pjesa e konceptit të zhvillimit hapësinor ku flitet për zonat.

⁴ Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në Kosovë për park nacional, Enti për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë, 1982

Maja e Arnenit

Ky rezervat strikt natyror është shpallur nën mbrojtje me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/74, datë 10.02.2016. Sipërfaqja e përgjithshme e rezervatit është 145.568 ha. Një pjesë prej 30 ha ka qenë e shpallur si rezervat strikt natyror që në vitin 1960. Maja e Arnenit është një zonë me pyjet më të ruajtura endemorelikte të rrobullit (*Pinetum heldreichii*). Këto pyje me vlera të jashtëzakonshme natyrore shtrihen në shpatijet jugore të malit Oshlak. Në kuadër të këtij rezervati strikt natyror gjenden të ekosistemeve endemorelikte pyjore të rrobullit dhe të ahut ku është verifikuar biodiversiteti i theksuar i llojeve drunore: endemoreliktet *Pinus heldreichii* dhe *Pinus peuce* si dhe llojet tjera si *Fagus moesaicae*, *Fraxinus ornus*, *Acer pseudoplatanus*, *Pinus nigra*, *Picea excelsa*, *Lonicera xilostemum*, *Juniperus communis*, *J. nana*, *Daphne mezereum*, *Rosa canina*, *Rhamnus cathartica*, *Salix caprea*, *Salix arenaria*, *Sobus aucuparia*, *S. austriaca*, *Betulla pubescens*, *Alnus glutinosa*, si dhe dhjetëra lloje barishtore.

Hulumtimet në këtë rajon kanë treguar se kjo zonë e parkut ka vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe shkencore. Në kuadër të biodiversitetit të pasur veçohen llojet e shumta endemike bimore: stenoendemiti *Vrbascum scardicum* (gjendet vetëm në rajonin e Prevallës dhe askund tjetër në botë!), *Pinus heldreichii* (lloj endemorelikt), *Pinus peuce* (lloj endemik i Ballkanit), *Gentiana bulgarica* var. *albanica*, *Dianthus cartusianus*, *Dianthus integer*, *Lazerpitium siler*, *Campanula albanica*, *Thymus albanus*, *Campanula foliosa*, *Vrbascum nikolai*, *Stachys scardica*, *Viola zoisii*, *Viola grisebachii*, *Ephilobium anagallidifolium*, *Buplenium subthorpiatum*, *Phytenua pseudoverbicularis*, *Trifolium velenovskii* (lloj endemik i Ballkanit), *Carex leavis*, *Anthemis carpatica*, *Onobrychis scardica*, *Anthyllis aurea*, *Doronicum orphanidis*, *Campanula spatulata*, *Campanula epigea*, *Scabioza dubia*, *Potentilla speciosa*, *Cynanchum huteri* etj. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktua zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Pisha e Madhe

Ky është një rezervat strikt i natyrës me pyjet e pastra të arnenit të kuq (*Pinetum heldreichii*). Shtrihet në shpatijet juglindore të masivit malor të Koxha Ballkanit ku gjenden pyjet e vjetra të rrobullit të cilat formojnë bashkësinë bimore *Seslerio autumnalis* – *Pinetum heldreichii*, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të arnenit në Gadishullin Ballkanik. Pisha e Madhe është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 01/74, datë 10.02.2016 me sipërfaqe të përgjithshme prej 44.9072ha, por një pjesë e madhe e tij, me një sipërfaqe prej rreth 35 ha, është e shpallur për rezervat strikt të natyrës që në vitin 1960. Në rezervat dhe afërsinë e drejtperdrejt gjenden edhe dukuri e objekte interesante hidrografike. Në anën lindore shtrihet ujëndarësi detar, në mes Detit Egje dhe Adriatik, perkatësisht pellgut të lumit Lepenc dhe atij të Bisticës së Prizrenit. Potezi i ujëndarësit njihet me emrin lokal Virovi dhe cilësohet me pejzazhe të bukura të kullotave alpine dhe me shumë burime të ujit që edhe në periudhen më të thatë të vitit kanë ujë. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktua zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Oshlaku

Ky rezervat strikt i natyrës është shpallur me vendim të Qeverisë Nr. 03/74, datë 10.02.2016 me sipërfaqe të përgjithshme prej 550.797ha. Me pozitën e tij qendrore në park, Mali i Oshlakut shtrihet prej pjesës perëndimore kah ajo qendrore dhe ka vlera të rralla bimore dhe shtazore. Pjesa e tij me rreth 20 ha, me pyje të pastra të Rrobullit (*Seslerio* – *Pinetum heldreichii*) që gjendet në pjesën perëndimore të këtij mali, është shpallur rezervat strikt i natyrës në vitin 1960. Krahas pyjeve të rrobullit, në rezervatin e Oshlakut ndodhen edhe disa lloje të rëndësishme të florës endemike dhe relikte. Këtu ndodhet lloji endemorelikt i periudhës glaciale *Driada tetepetalis* (*Dryas octopetala*). Ky lloj zakonisht shoqërohet nga lloji *Alchemilla alpigena*, që së bashku me llojin *Pinus mugho*, përbëjnë fitocenozën *Dryado-Alchemilla pinetum mughi*. Pastaj llojet me karakter endemik, endemorelikt dhe llojet mjekësore sikur janë: *Manaferra e gurit* (*Rubus sacsatilis*), *Heliantema e thinjur* (*Helianthemum canum*), *karafili* (*Dianthus integer*), *karafil pyjor* (*Dianthus sylvestris*), *karafil me balluke* (*Dianthus superbus*), *sanëza* (*Gentiana lutea*), *gentianët* (*Gentiana utriculosa*, *Gentiana asclepiadae*, *Gentiana*)

bullgarica), lisa shqiptare (*Thymus albanus*), zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*), edraiant gjethebari (*Edreianthus graminifolia*), iriqëza veshëve e gjelbër (*Saxifraga sempervivum*), nejcë e përdredhur (*Polygonum bistorta*), rrushë arushe (*Archostaphylos uva ursi*), esparatë mali (*Onobrychis scardica*), aguliqe e vërtetë (*Primula officinalis*), brinjëkau në trajtë kose (*Bupleurum falcatum*), brinjëkau i Karglit (*Bupleurum karglii*), Alkana e Sharrit (*Alcanas scardica*), Zorrëca malazeze (*Potentilla montenegrina*), Vingjëra e livadhut (*Lathyrus pratensis*), Iriqëza tregishtore (*Saxifraga trydactylides*), Pratishi i Dimonieit (*Soldanella dimonieii*) etj.

Nga llojet drunore halore përveç rrobullit (*Pinus heldreichii*) dhe kërlekës (*Pinus mugho*), janë të pranishme edhe llojet: hormoqi (*Picea exelca*), bredhi (*Abies alba*) dhe arneni i bardhë (*Pinus peuce*) ndërsa nga llojet drunore gjetherënëse janë: shelgu i egër (*Salix caprea*), vojsa e egër (*Sorbus aocuparia*), lajthia (*Coryllus avellana*) etj.

Rezervati i Oshlakut, ka rëndësi të madhe edhe në aspektin ornitofaunistik sepse është habitat i disa llojeve të rëndësishme të zogjve që gjenden në Aneksin I të Direktivës së Zogjve. Të dhënat flasin se në pjesën gurore të rezervatit sidomos gjatë stinës së pranverës këtu e haset Pulegra e madhe (*Tetrao urogallus*) dhe thëllëza e gurit (*Alectoris graeca*), që gjenden në Aneksin I të Direktivës së zogjve, dhe Pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*) që gjenden në Listën e Kuqe të IUCN-së. Poashtu nga kjo listë, nga zogjtë grabitqarë, në këtë rezervat është e pranishme Shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*).

Ky rezervat që shtrihet kryesisht në pjesët më të larta të malit Oshlak, përmban këto bashkësi bimore: pyje të pastra të rrobullit në ekspozicionin jugor (mbi fshatin Mushnikovë), të cilët janë të ruajtura dhe paraqesin habitat për shumë lloje të kafshëve të egra, në veçanti të dhijes së egër, kaprojve, ariut të murrmë dhe shqiponjës së përhimtë; pyje të hormoqit që paraqesin vegetacionin më të lartë pyjor në ekspozicionin verior të Oshlakut; bashkësitë e kërlekës që gjenden në ekspozicionin verior të cilët, përveç vlerave natyrore e kanë rolin e mbrojtjes së tokës nga erozioni; bashkësitë e llojeve barishtore të pasura me bimë endemike (veçohet bashkësia *Achileo-Onobrychis scardica*) që i mbulojnë pjesët më të larta të Oshlakut mbi vegetacionin pyjor.

E veçantë e rezervatit është prania e llojit stenoendemik barpezmi i mbretit Aleksandër (*Achillea alexandri* – regis) që gjendet kryesisht në pjesët e larta malore ku formon dy bashkësitë të rëndësishme bimore: *Achilleo* – *Pinetum mughi* (*Pinetum mugho calcicolum*) dhe *Achilleo-Onobrychis scardica*. Rezervati i është i pasur edhe me lloje të tjera të rëndësishme bimore, siç janë: *Senecio wagneri*, shmanga shqiptare (*Crepis albanica*), antilidë e verdhë (*Anthyllis vitelina*), antilidë e pruar (*Anthyllis aurea*), syviç i Kretës (*Anthemis montana*), barpezmi gjethe karajpel (*Achillea tanacetifolia*), eufrazi i Roskovit (*Euphrazia roskoviana*), kokoqel i pyllit (*Centaurea montana*), këmashua (*Hieracium aurantiacum*), karafil ngjurë gjaku (*Dianthus cruentus*), lisa shqiptare (*Thymus albanus*), këmashnat (*Hieracium villosum*, *Hieracium alpicolum*), asteri shqiptar (*Aster alpinus*), esparceta e Sharrit (*Onobrychis scardica*), sanëz (*Gentiana lutea*), knautie gjethe gjatë (*Cnautia longifolia*), panja e Heldraihut (*Acer heldreichii*), sarusha e sharrit (*Stachys scardica*) etj.

Në aspektin faunistik, rëndësia e kësaj zone qëndron në atë se në kullosat e majave të rajonit të Oshlakut haset dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), sipas vëzhgimeve në këtë zonë janë të pranishme rreth 60 kërretë të dhive të egra, tri qifteve të shqiponjës minjngrënëse dhe shumë individëve të thëllëzës së gurëve. Në propozimin e ri të zgjeruar të rezervatit të Oshlakut, përveç këtyre llojeve të lartë cekura, janë të pranishme edhe shumë lloje të tjera të rëndësishme të ornitofaunës dhe kafshëve të egra, siç janë: skifteri malor (*Falco biarmicus*), shqiponja e përhimtë (*Aquila chrysaetos*), huti pyjor, ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhelpra (*Canis vulpes*), derri i egër (*Sus scrofa*), macja e egër (*Felis sylvestris*), vjedulla (*Meles meles*), shqarshi i artë (*Martes martes*), fishnjari (*Martes foina*), lepuri i fushës (*Lepus europeus*), etj.

Shumë prej këtyre llojeve të faunës janë të rrezikuara si pasojë e mungesës së mbrojtjes adekuate të zonës nga prania njerëzve, në veçanti gjahtarëve ilegal. Me shpalljen e rezervatit strikt natyror të "Oshlakut" janë krijuar kushtet e volitshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e mirëfilltë të faunës, sidomos stenoendemitin *Achillea alexandri* Regis që gjendet vetëm në këtë pjesë të parkut dhe askund tjetër në

botë. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktua zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Rusenica

Rusenica është vendbanim natyror i Rrëqebullit Ballkanik (*Lynx lynx ballkcanicus*) i cili është lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Në vitet 90 ka numëruar rreth 13 krerë. Me qëllim të mbrojtjes së vendbanimit të rrëqebullit, në vitin 1955 Rusenica është shpallur rezervat strikt i natyrës dhe poashtu edhe me vendim të Qeveris Nr. 00/74, datë 10.02.2016 me sipërfaqe prej 270.329ha. Përveç rrëqebullit, kjo zonë është vendbanim edhe i kafshëve të tjera të egra si: ariu i murrmë, kaprolli, dhija e egër etj dhe i shumë bimëve endemike si: *Bornmullera dieckii*, *Potentilla argentea*, *Pilygala doerfleri*, *Ramonda serbica*, *Acer heldreichii*, *Achillea holysolica*, *Hieraceum weldsteini*, *Galium rupestre*, *Daphne oloeides*, *Pinus heldreichii*, *Scrophularia bosniaca*, *Minuartia baldaci*, *Achillea ageratifolia*, *Erysimum silvestre*, *Aetionema saxatile*, *Eryngium palmatum*, *Sylibum marianum*, *Camapnula secundiflora*, *Onosma echioides*, *Alyssum repens*, *Lamium garganicum*, *Coridalis oreoluca*, etj. Në këtë zonë paraqiten shumë fitocenoza (bashkësi bimore), ndërsa më të përhapura janë: pyjet e ahut dhe bredhit (*Abieti-fagetum*), pyjet e ulëta të mëllezës dhe frashnit të zi (*Qrno-carpinetum*) dhe dy bashkësi të rralla dhe specifike: bashkësia e bornmulleres me rrobullin (*Bornmullero-Pinetum heldreichii*) dhe *Daphnojuniperetum oxicedri*, (bashkësia në gelqeror-dolomit e cila deri më tani është e paverifikuar në shkencën e botanikës). Në brendësinë e kësaj zone është Shpella e Matosit dhe monumenti kulturo-historik "Dhomat e Rusenicës". Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktua zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Bistra

Me vendim të Qeverisë Nr. 08/74, datë 10.02.2016, Bistra është shpallur rezervat strikt i natyrës me sipërfaqe të përgjithshme prej 642.961ha. Kjo zonë shtrihet në pjesën juglindore të Prevallës. Kufiri jugor i zonës përputhet me kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, me lartësi mbidetare 1500 - 2640m. Kjo zonë karakterizohet me vlera të veçanta floristike, faunistike, fitocenologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe hidrologjike. Emri i rezervatit natyror është dhënë në bazë të majes malore Bistra (2640 m) e cila paraqet majen më të lartë në Parkun Kombëtar "Sharri" dhe të dytën (pas Gjeravicës me 2656 m) në Republikën e Kosovës. Specifikat më të rëndësishme të zones janë bashkësitë pyjore të rrobullit, arnenit, pishës së bardhë, hormoqit, panjës malore dhe rododendrës, ekosistemet shkurre dhe barishtore të maleve të larta në silikate, liqeni akullnor i Jazhincës etj.

Në pjesët më të ulëta të zonës, në lokalitetet Livadhi i Mbretit dhe Ujrat e Humbur (Gine vode), duke filluar prej 1500 m të lartësisë mbidetare, gjendet bashkësia *Fagetum moesiacum*, ndërsa në lartësinë mbidetare prej afro 1700 m në ekspozicionet jugore gjendet bashkësia *Seslerio-Pinetum heldreichii*.

Në ekspozicionet veriperendimore është bashkësia *Ajugo - Pinetum peuces*, ku përveç molikës në katin dominant të bimëve barishtore është lloji alpik *Ajugo pyramidalis*, pastaj bashkësia e arnenit, rrobullit dhe pishës së bardhë (*Pineto- Pinetum peucis mixtum*), që lokalitetit të Ujrave të Humbur i jep vlerë të veçantë.

Pastaj, bashkësia e arnenit dhe drandafilit alpik (*Rhododendro - Pinetum peucis*) deri në 2000 m, bashkësia shkurre e maleve të larta (*Juniperus nana-Bruckenthalia spiculifolia*) mbi vegjetacionin pyjor, si dhe bashkësitë barishtore të maleve të larta në pjesët të ashpra shkëmbore të lokaliteteve Quka e Liqenit dhe

Bistra: *Ranunculetum crenati*, *Potentilla doerfleri-Juncetum trifidi*, *Carex laevis-Sesleria comoza* etj. të cilët karakterizohen me florën e pasur endemike Alpiko-Karpate dhe arktike.

Zona e Bistrës veçohet me shumëllojshmërinë e bimëve endemike, nga të cilët veçohen: Rrobulli (*Pinetum heldreichii*), Arneni (*Pinus peuce*), Dredhaku (*Pinus mugo*), Panja malore (*Acer heldreichii*), Drandafili alpik (*Rhododendron ferugenum*), *Vaccinium uliginosum*, *Draba korabensis* (stenoendemit),

Potentilla doerfleri (stenoendemit), Dianthus scardicus (stenoendemit), Dinathus superbus, Phyteuma confusium, Narthecium scardicum, Lilium albanicum, Carex foetida, Diphysium alpinum, Empetrum hermaphroditum, Salix herbacea, Salix reticulata, Rumex nivalis, Silene waldsteini, Silene rupestris, Silene asterias, Hesperis dinarica, Rhodiola rosea, Saxifraga bryoides, Saxifraga cymosa, Saxifraga androsacea, Geum reptans, Epilobium anagallidifolium, Veronica alpine, Cryptogramma crispa, Veronica aphylla, Potentilla montonegrina, Pancicia serbica, Plantago gentianoides, Sanëza (Gentiana punctata) -bimë mjekuese e rrezikuar etj.

Zona është e pasur me lloje të shumta të kafshëve të egra (mamalia), më të rëndësishme janë: dhia e egër (Rupicapra rupicapra), ariu i murrmë (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), kaprolli (Capreolus capreolus), dhelpra (Canis vulpes), derri i egër (Sus scrofa), macja e egër (Felis sylvestris), vjedulla (Meles meles), shqarthe i artë (Martes martes), fishnjari (Martes foina), lepuri (Lepus europeus).

Shpendët (ornitofauna) më të rëndësishme janë: pulegrës së madhe (Tetrao urogallus), thëllëzës së gurit

(Alectoris graeca), pula e pyjeve (Tetrastes bonasia), skifteri malor (Falco biarmicus), shqiponja e përhimtë (Aquila chrysaetos), shqiponjës minjngrënëse (Buteo buteo), huti pyjor etj. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Dupnica

Kjo zonë me sipërfaqe të përgjithshme prej 484.612ha është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 09/74, datë 10.02.2016. Dupnica gjendet në pjesën jugore të parkut dhe është zonë e maleve të larta të Sharrit në kufi me Maqedoninë. Shquhet me dy liqene të vogla - cirqe akullnajore dhe me ekosistem të veçantë natyror. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Kobilica

Kjo zonë me vlera të larta të natyrës, me vendim të Qeverisë Nr. 10/74, datë 10.02.2016 është shpallur rezervat strikt i natyrës. Ka sipërfaqe të përgjithshme prej 199.626ha. Kobilica me rreth 199 ha shtrihet në kufirin jugor- të PK "Sharri", në kufi me Maqedoninë, mbi fshatin Lubinja e Epërme. Sipërfaqe e rezervatit të propozuar natyror gjendet në ekspozicionin verior në lartësinë mbidetare prej 2000 - 2528 m. Kobilica paraqet zonën me bimë të rrallë kalcifite dhe hezmofite që janë të përshtatur habitatit me kushte të vështira klimatike dhe pedologjike (tokat e varfura dhe të pa zhvilluara), ndër të cilët veçohet lloji stenoendemik me rëndësi ndërkombëtare Hieracium kobilicanum. Zona është e mbuluar me vegjetacion barishtor i pasur me bimë të shumta endemike siç janë: Hieracium kobilicanum, Silene schmuchi, Rumex nivalis, Salix herbacea, Dinathus superbus, Viola grisebachiana, Erigeron uniflorus, Saussurea alpine, Lilium albanicum. Kurse nga llojet e faunës që gjenden në këtë zonë veçohet dhia e egër. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Luboteni

Luboteni paraqet majën fillestare malore të Malit Sharr në pjesën lindore të tij. Kjo zonë, në një sipërfaqe prej 202.284ha, me vendim të Qeverisë Nr. 11/74, datë 10.02.2016 është shpallur rezervat strikt i natyrës. Rezervati shtrihet në kufirin me Republikën e Maqedonisë. Përfshinë pjesët më të larta malore të mbuluara me ekosistemet barishtore dhe shkëmbij gëlqeror me lartësi mbidetare 1800-2499 m. Zona është e pasur me bimë endemike të cilët formojnë bashkësi (fitocenoza) të rralla bimore në kuadër të cilëve veçohen ato të karakterit subalpin dhe alpin.

Fitocenozat më të rëndësishme janë: Carex laevis-Helianthemum me reliktet glaciale Dryas octopetala, Linaria alpina (lloji tejet i rrallë), Sideritis scardica, Hieracium naegelianum supsp. Lubotenicum, e cila ka rëndësi ndërkombëtare. Këtu janë prezente edhe tjera si: Drypetum linnaeanae, Salicetum retusae reticulata, Trifolieto norici-Caricetum, Coccineo-Deschampsietum scardici, Ranunculetum crenati

scardicum, Seslerietum comosae, Junipero-Bruchenthalietum, Cynosureto-Caricetum hirtae, Potentilio-Fumarietum bonapartei, Centaureo-Trifolietum velenovsyi, Senecieto-Rumicetum alpine, Telekietum speciosae, Orphanideo-Cirsietum apoendiculati, Onobrychidi-Festucetum, Geranieto-Poetum violaceae etj.

Nga bimët e shumta endemike, të cilët ndikojnë në vlerat e jashtëzakonshme floristike të Lubotenit, veçohen: *Achillea ageratifolia* var *aizooni*, *Scabiosa portae*, *Centaurea kosanini*, *Euphorbia glabriflora*, *Cirsium appendiculatum*, *Astrogalus vesicarius*, *Draba scardica*, *Genista hassertiana*, *Thlaspi bellidifolium*, *Salvia reinertii*, *Alysum cuneifolium*, *Salvia scardica*, *Alysum markgrafii*, *Thymus albanus*, *Dianthus microlepis*, *Thymus lycae*, *Dianthus scardicus*, *Plantago reniformis*, *Minuartia baldacii*, *Armeria canescens*, *Silene roemeri*, *Ranunculus millefoliatus*, *Silene sendtneri*, *Asperula dorfleri*, *Fumana bonapartei*, *Saxifraga sempervivum*, *Helianthemum balcanicum*, *Linaria peloponnesiaca*, *Convolvulus cochlearis*, *Melampyrum scardicum*, *Sedum flexuosum*, *Veronica satureioides*, *Sedum serpentine*, *Viola aetolica*, *Knautia midzorensis*, *Carex laevis*, *Lilium albanicum*, *Carex nigra*, *Crocus kosanini*.

Për shkak të kushteve të vështira (lartësia e madhe mbidetare dhe klima e ashpër arkto alpike) zona është e varfur me lloje të faunës. Kjo zonë kryesisht shfrytëzohet për kullotje të dhive të egra dhe nga shpendet grabiçar si shqiponja e përhimtë (*Aquila crysaetos*), skifteri i përhimtë (*Falco peregrinus*), shqiponja minjëgrënëse (*Buteo Buteo*) që këtë zonë e shfrytëzojnë për kërkim të ushqimit. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Zona e burimit dhe ujërrjedha e epërme e Lumëbardhit të Prizrenit

Zona në një sipërfaqe prej 304.408ha, me vendim të Qeverisë Nr. 12/74, datë 10.02.2016 është shpallur rezervat strikt i natyrës. Ky rezervat shtrihet në pjesën jugore të parkut, në kufi me Maqedoninë, kah ajo qendrore. Hapësira e saj është e pasur me florë endemike dhe forma relievore glaciale. Burimi i lumit Lumbardh i Prizrenit dhe të dy liqenjtë Liqeni i Epërm dhe ai i Poshtëm që janë cirqe akullnajore përbëjnë pjesën qendrore të këtij rezervati. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Gryka

Zona me sipërfaqe prej 104.041 ha e cila i përfshinë lokacionet Gryka dhe Pulan (Kokoshinje) është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 013/74, datë 10.02.2016. Kjo zonë shtrihet në pjesën perëndimore të parkut kombëtar, në afërsi të fshatit Gotovushë. Karakterizohet me bashkësinë FAGETO-TAXETIUM BACCATA (*Taxusbaccata*) me Ahun (*Fagus mosaicae*) dhe ka veçori gjeomorfologjike dhe peisazhore. Ekspozicioni i terrenit është verior dhe jugperëndimor, ndërsa lartësia mbidetare e zonës është prej 1100 deri 1500 m. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Koritniku

Zona e Koritnikut, në një sipërfaqe prej 818.53 hektarësh është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 14/74, datë 10.02.2016. Zona gjendet në pjesën veriperëndimore të territorit të komunës së Sharrit (Dragashit), në kufi me territorin e komunës së Prizrenit dhe me Republikën e Shqipërisë. Shquhet me pyjet endemorelikte të Rrobullit (*Pinetum heldreichii*) dhe vegjetacionin barishtor të pasur me bimë të rralla dhe endemike. Në malet e larta me gur gëlqeror të Koritnikut ka habitate me një llojllojshmëri të madhe biologjike ku përfshihen sipërfaqja pyjore endemike me Pishën Boshnjake, një lloj vegjetacioni shumë i rrallë në Ballkan dhe tri lloje të vegjetacionit që janë të klasifikuar në Shtojcën 1 të Direktivës Europiane për Habitatet 92/43/EEC. (Së paku 44 bimë endemike ose shumë të rralla të Ballkanit janë të regjistruara në këtë moment.) Në këtë zonë gjenden edhe një habitat me një llojllojshmëri të madhe të fluturave (5 nën statusin e IUCN) dhe një habitat i dhive të egra, pastaj një pjesë e linjës (rrugës) së migrimit të arinjve dhe të rrëqebujve si dhe 15 specie të zogjve

nga Shtojca 1 dhe Shtojca 2 të Direktivës Evropiane për Habitatet. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Pashallarë

Zona Pashallarë, për shkak të vlera të larta të natyrës që i ka, është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 15/74, datë 10.02.2016. Sipërfaqja e këtij rezervati është 399.874ha. Pashallarë shquhet për vlerat e jashtëzakonshme natyrore siç janë: biodiversiteti i theksuar i florës dhe faunës i karakterit endemo-relikt, pejsazhet e bukura dhe përbërja e rrallë gjeologjike nga serpentini. Bashkësitë më të rëndësishme të pyjeve që janë verifikuar në këtë zonë janë: Roso-Pinetum heldreichi serpentinum dhe Lilio-Pinethum mugho serpentinum të cilët deri me tani janë të pakonstatuar në shkencën e botanikës. Nga bashkësitë e tjera veçohen: pyjet e ahut (Fagetum montanum serpeniticum), vegetacioni shkurror i hartinës (Pinethum mughi serpentinum) dhe pyjet e përziera të rrobullit, arnenit, bredhit, hormoqit dhe hartinës. Kjo zonë është e pasur me mbi 100 lloje të bimëve endemike, ndër të cilët veçohen: Bornmuellera dieckii, Cerastium neoscardicum, Lazerpitium siler, Lilium albanicum, Pinus heldreichii, Pinus peuce, Pinus mugho, Taxus bacata, Campanula albanica, Campanula foliosa, Stachys scardica, Cnautia dinarica, Ranunculus incomparabilis, Cicerbita pancici, Salix herbace, Rumex scutatus, Silene pusila var. albanica, Barbarea longolostri, Cardamine carnosa, Alysum scardicum, Sedum flexiosum, Pancicia serbica, Bupleurum karglii, Carum rupestre var. albanicum, Centaurea kosanini, Campanula moesiaca, Dianthus gracilis, Dianthus integeri, Sedum serpenicum, Antylis vitelina, Onobrychis pindicola, Lamium pictum, Thymus rohlena, Pinguicula balcanica, Pinguicula lanceolata, Asperula doerfleri, Saxifraga serpervivum, Saxifraga taygetea, Linaria peleponisiaca, Melanpyrum scardicum, Pedicularis grisebachii, Scrophularia aestivalis, Lunaria teleciana etj. Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Bredhiku

Bredhiku është një vendbanim natyror i cili, për shkak se ka vlera të larta të natyrës, është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 16/74, datë 10.02.2016. Ka një sipërfaqe prej 123.23 hektarësh. Ky rezervat shquhet për llojin e veçantë të Bredhit Maqedonas (*Abies borisi-regis*) dhe ariun e murrmë (*Ursus arctos*). Me qëllim të parandalimit dhe ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Shutman


Shutman është një zonë me male të larta në silikat që karakterizohet me vlera të veçanta biologjike, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peisazhore. Kjo zonë shtrihet në lindje dhe jug të fshatit Brod dhe përfshinë trevat e Zhuticës, Defit, Pesh/Mramorit, Shutmanit, Vracës, Rudokës dhe Cules. Në një sipërfaqe prej 5064.1 hektarësh zona është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 17/74 datë 10.02.2016. Këtu kemi një kombinim të sistemeve të tokave nën ujë të ruajtura mirë duke përfshirë liqenet malore, rrjedhat e brendshme oligotrofike, moçalet, shkurret e ulta (*Caricetum rostratae-vesicariae*), kullotat e gjera, kaçubat apo/dhe vegetacionin (bimësinë) barishtor dhe vegetacionin madhështor të sipërfaqeve shkëmbore (të gjitha të klasifikuara në shtojcën 1 të Direktivës Evropiane për Habitatet 92/43/EEC). Momentalisht janë të regjistruara së paku 43 lloje bimore shumë të rralla ose endemike në Ballkan (një prej tyre është i klasifikuar në shtojcën 1 të Direktivës Evropiane për Habitatet 92/43/EEC). Këtu ka habitate të rëndësishme të insekteve ujore duke përfshirë mizën endemike të Gadishullit Ballkanik *Limnephilus petri* që është prezente vetëm në rrjedhën e epërme të lumit Brod dhe në Bullgari, pastaj llojlojshmëri të pasur të fluturave (22 nën status të IUCN ose të rralla). Kjo zonë është habitat i dhive të egra dhe pjesë e linjave apo rrugëve të migrimit të arinjve për dhe nga Maqedonia. Në të gjenden 23 specie të zogjve nga Shtojcat 1 dhe 2 të Direktivës Evropiane për Habitatet 92/43/EEC dhe formacione shkëmbore me habitate ku rritet Shqiponja e Artë. Me qëllim të parandalimit të ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Lëndina e Shenjtë

Lëndina e Shenjtë është një zonë malore në serpentin, e cila në një sipërfaqe prej 17.9878 hektarësh është shpallur rezervat strikt i natyrës me vendim të Qeverisë Nr. 18/74, datë 10.02.2016. Kjo zonë është e pasur me llojin stenoendemik *Bornmuellera dieckii* e cila formon dy bashkësi endemike me dëllinjën (*Bornmuello-juniperetum interemedie*) dhe me *polygallën* (*Bornmuellero-Polygonetum amarae*). Nga llojet e tjera endemike që janë të pranishme në këtë zonë veçohen: *Pinus heldreichii*, *Stachys scardica*, *Erisimum pectenatum*, *Polygala doerfleri*, *Pinus mugho*, *Gencianella bulgarica*, *Petrorhagia ilirica*. Me qëllim të parandalimit të ndikimeve të dëmshme në rezervat është përcaktuar zona mbrojtëse 100m nga kufiri i rezervatit.

Nr.	Rezervatet Natyrore	Ha	Komuna	Të shpallur me vendim
1	Koritniku	818.53	Dragash	2016
2	Bredhiku	123.23	Dragash	2016
3	Shutmani	5064.1	Dragash	2016
4	Kobilica	199.626	Prizren	2016
5	Dupnica	484.612	Prizren	2016
6	Lumbardhi	304.408	Prizren	2016
7	Bistra	642.961	Prizren/Shtërpce	2016
8	Maja e Arnenit	145.568	Prizren/Shtërpce	2016
9	Oshlaku	550.797	Prizren/Shtërpce	2016
10	Pisha e Madhe (Koxhaballkan)	44.9072	Prizren	2016
11	Rusenica	270.329	Prizren/Suharekë	2016
12	Lëndina e Shenjtë	17.9878	Suharekë	2016
13	Pashallare	399.874	Suharekë/Shtërpce	2016
14	Gryka	104.041	Shtërpce	2016
15	Luboteni	202.284	Shtërpce/Kaçanik	2016

Tab.x. Rezervatet strikte natyrore në PK Sharri, të shpallur me vendim në vitin 2016



Harta nr.x Trashëgimia natyrore – Rezervatet strikt të natyrës

6.3.12. Shfrytëzimi dhe pronësia e tokës

Toka është padyshim burimi natyror më i rëndësishëm në botë. Ajo siguron një mori të mirash publike dhe private dhe njerëzimi ka luajtur një rol të madh në formësimin e evolucionit të saj gjatë mijëvjeçarëve. Toka është vendi ku shtrihen të gjitha aktivitetet njerëzore dhe vendi ku gjenden të gjitha resurset materiale në funksion të zhvillimeve të gjithmbarshëm. Toka është hapësira e cila mundëson shtrirjen e zhvillimeve humane duke filluar nga kërkesat elementare për banim, prodhimin e ushqimit, e deri te kërkesat për zhvillime të mëdha komerciale-industriale dhe për qëllime tjera të rëndësishme për infrastrukturë-transport. Si e tillë, toka është resursi bazë natyrorë si për mbijetesën ashtu edhe për përparimin e njerëzimit, si dhe për mirëmbajtjen e të gjitha ekosistemeve tokësore. Gjatë mijëvjeçarëve, njerëzit janë bërë gjithnjë e më shumë ekspertë në shfrytëzimin e burimeve të tokës për qëllimet e tyre. Kufijtë për këto burime janë afër limitit të tyre, ndërsa kërkesat njerëzore për to nuk janë. Rritja e kërkesës, ose presioni mbi burimet e tokës, shfaqet si rënia e prodhimit të bimëve, degradimi i cilësisë dhe sasisë së tokës dhe konkurrenca për tokë.


Shfrytëzimi i tokës është problem dhe sfidë e mëdha në nivel global dhe lokal. Këto sfida atakojnë edhe vendin tonë, Kosovën, të cilat jo që nuk e përjashtojnë por zaten për shkak të dendësisë relativisht të lartë të popullsisë janë edhe më të theksuara. Andaj, vëmendja tani duhet të përqendrohet në rolin e njeriut si kujdestarë dhe jo vetëm si shfrytëzues, të ngarkuar me përgjegjësinë e mbrojtjes së të drejtave të brezave të ardhshëm dhe të ruajtjes së tokës si bazë e ekosistemit global. Në frymën e kësaj përpjekje, liderët botërorë janë pajtuar në hartimin dhe arritjen e 17 qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të njohura si SDGs, ku disa nga këto qëllime, respektivisht qëllimi 11 i dedikohet “qyteteve dhe komuniteteve të qëndrueshme” dhe qëllimi 15 i dedikohet “jetës në tokë” – përkatësisht janë dy qëllime mileniale të ndërlydhura ngushtë me mënyrën e shfrytëzimit të tokës. Ndërsa në BE prioritet është qasja e integruar lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e shfrytëzimit të tokës, ku disa nga aktivitetet kryesore të Agjencisë së Mjedisit të Evropës janë të fokusuar në monitorimin, dokumentimin dhe vlerësimin e modelit hapësinor, shtrirjes dhe dinamikës së

shfrytëzimit dhe mbulueshmërisë së tokës. Kjo dinamik e monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes së shfrytëzimit dhe përdorimit të tokës duhet të aplikohet edhe në Kosovë. (AMMK, Raporti i mjedisit 2020). Në shumë raporte zyrtare që trajtojnë gjendjen e natyrës dhe mjedisit në Kosovë, rezulton që degradimi i mjedisit është ende problem serioz. Aktualisht nuk kemi indikator i cili me një metodologji serioze monitoron mënyrën e shfrytëzimit të tokës, kjo edhe për shkak të kompleksitetit të çështjes. Në këtë drejtim, jo vetëm në Kosovë por edhe në rrafsh global, për arsyeje praktike monitorimi i ndryshimeve në tokë bëhet përmes hartave të mbulueshmërisë së tokës, duke i kombinuar edhe me informata të tjera me shfrytëzimin e njohur të tokës.

Sipas hartave të mbulueshmërinë së tokës në Parkun Kombëtar “Sharri” (AMMK, 2012-2018), sipërfaqet pyjore (55.07%), duke përfshi edhe livadhet natyrore (39.27%) përbëjnë 94.34% të gjithë territorit të Parkut, 1.38% janë tokë bujqësore, më pak se 5% tokë ndërtimore, sipërfaqe ujore dhe kategori tjera. Sipas analizës së këtyre hartave, në periudhën kohore 2012-2018 nuk ka ndryshime të theksuara.

Kodi	Klasa	ha	%
112	Strukturë jo e vazhdueshme urbane	0.99	0.00
231	Kullotë	189.37	0.36
242	Strukturë komplekse për kultivim	3.07	0.01
243	Tokë e nxënë kryesisht nga kultura bujqësore	543.17	1.02
311	Pyje gjetherënëse	13,656.76	25.64
312	Pyje halore	2,498.63	4.69
313	Pyje të përziara	1,550.10	2.91
321	Livadhe natyrore	20,917.69	39.27
322	Shkurre dhe stepe	4,987.18	9.36
323	Shkëmbinj të zhveshur	0.14	0.00
324	Zonë kalimtare në mes pyjeve dhe shkurreve	6,640.67	12.47
333	Zona me vegetacion të dobët	1,836.84	3.45
334	Zona të djegura	448.02	0.84
Shuma		53,272.60	100.00

Tabela. x Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas hartës së mbulueshmërisë së tokës në Parkun Kombëtar “Sharri”, AMMK 2018




Harta nr.X Mbulueshmëria e tokës në Parkun Kombëtar "Sharri" në vitin 2018 (CLC18)

Megjithatë, në disa zona specifike ku plani ka lejuar konvertimin tokës natyrore në tokë ndërtimore, veprimet degraduese humane janë mjaft shqetësuese edhe pse për nga shkalla numerike e prezantimit të vlera është në shikim të parë duken shpërfillëse. Indikacionet nga terreni tregojnë qartë për presionin që ushtron toka ndërtimore ndaj grupeve të tjera kryesore të tokës, e të cilat janë vitale për Parkun, si për nga prodhimi në funksionin primar, po ashtu edhe për nga vlera e tyre në strehimin, funksionimin dhe mbrojtjen e ekosistemeve.


Sipas hartës globale të mbulueshmërisë së tokës (ESRI, 2020), e cila ka rezolucion të lartë dhe dallon në metodologjia nga harta clc 2018, pjesëmarrja e sipërfaqeve të ndërtuara në Park është 0.18% apo 98.40ha, ndërsa sipërfaqet tjera të përmbajtjes natyrore, si p.sh. pyjet së bashku me shkurret marrin pjesë me 68% apo 36,671ha, ndërsa kullotat me 31% apo 16,451ha dhe të tjerat më pak se 1%.

Klasat	ha	%
1 Sipërfaqe me ujë	4.03	0.01%
2 Sipërfaqe me pyje	23,055.282	43.28%
3 Sipërfaqe me kullota	16,451.532	30.88%
4 Sipërfaqe me bimësi të përmbytur	0.00	0.00%
5 Sipërfaqe me tokë të kultivuar bujq.	1.32	0.00%
6 Sipërfaqe me shkurre	13,616.962	25.56%
7 Sipërfaqe me ndërtim	98.40	0.18%
8 Sipërfaqe me shkëmbinj të zhveshur	40.69	0.08%
9 Sipërfaqe me borë dhe akullnaja	5.05	0.01%
Shuma	53,272.60	100.00%

Tabela. x Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas hartës së mbulueshmërisë së tokës në Parkun Kombëtar "Sharri", ESRI 2020



Harta nr.X Mbulueshmëria e tokës në Parkun Kombëtar "Sharri" në vitin 2020 (ESRI)



Grafikoni nr. X Mbulueshmëria e tokës në Parkun Kombëtar "Sharri" në vitin 2020 (ESRI)

Sipas raporteve të hartës së pronësisë të hartuara nga IPH-AKK, në Parkun Kombëtar "Sharri" shfrytëzimin e tokës sipas pronësisë e dominon prona shoqërore me 73%, prona private me 11%, ndërsa prona shtetërore ka pjesëmarrje nën 0.1%. Për shkak të disa problemeve teknike në sistemin kadastral, rreth 16% e territorit të Parkut Kombëtar "Sharri" nuk mund ti përcaktohet pronësia në hartë (mospërputhje mes tekstuale dhe grafikes dhe mungon informacioni për pronësinë). Ky problem ndërlihet ngushtë edhe me konfiskimin e librave kadastral nga Serbia në vitin 1999.

6.4. ZHVILLIMI SOCIAL E KULTUROR

Në kuadër të shtjellimit të fushave tematike të zhvillimit social e kulturor, në vazhdim është paraqitur gjendja aktuale e sektorëve të arsimit, shëndetësisë, banimit dhe trashëgimisë kulturore brenda parkut dhe në disa vendbanime rreth parkut të cilat, sa i përket këtyre sektorëve, janë të ndërlidhur me parkun kombëtar.


6.4.1. Arsimi

Arsimimi është një proces i përvetësimit të njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve nëpërmjet metodave të ndryshme si: mësimdhënies, trajnimit apo hulumtimit. Është një aspekt themelor i zhvillimit njerëzor dhe luan një rol vendimtar në formësimin e individëve dhe shoqërive.

Sistemi arsimor në vendbanimet rreth Parkut Kombëtar “Sharri” është i organizuar në tre nivele: arsimi parashkollor, arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët. Numri i objekteve shkollore është gjithësej 36. Në procesin arsimor në këto vendbanime janë të përfshirë rreth 7300 nxënës. Në shumicën e këtyre shkollave procesi mësimor zhvillohet në 2 turne. Një numër i vendbanimeve nuk kanë objekte shkollore dhe nxënësit e ndjekin mësimin në objektet shkollore të fshatrave më të afërt.

Çerdhe dhe kopshte për fëmijët e moshës nën 5 vjet brenda vendbanimeve të trajtuara nuk ka asnjë. Arsimi parashkollor zhvillohet në një numër të shkollave fillore që ofrojnë edukim njëvjeçar për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç. Këto janë fshatrat në kufi me parkun në të cilat ekzistojnë objekte të arsimit:


- Komuna e Dragashit: Blaç, Kuk, Kosavë, Pllajnik, Radesh, Leshtan, Dikancë, Brod, Restelicë, Krushevë, Glloboçicë, Orqushë, Rapçë, Kërstec, Buçë dhe Brezne.
- Komuna e Prizrenit: Zhur, Lubinje e Poshtme, Lubinjë e Epërme, Drajçiq, Mushnikovë, Gornjasellë, Pllanjan, Reçan dhe Manastiricë.
- Komuna e Suharekës: Greikoc, Mushtisht dhe Delloc.
- Komuna e Shtërpcës: Shtërpcë, Brod, Firajë dhe Biti e Epërme.
- Komuna e Kaçanikut: Glloboçicë, Strazhë, Slatinë dhe Vatë.



Harta nr.x Objektet arsimore në vendbanimet përreth Parkut Kombëtar “Sharri”

Në vitin 2019, Drejtoria për Administrimin e PK "Sharri" (DAPKSH) ka realizuar një analizë të ndërtimeve në kuadër të territorit të parkut, në bazë të së cilës janë evidentuar 1232⁵ ndërtime të kategorive të ndryshme. Më pas, Instituti për Planifikim Hapësinor në maj të vitit 2023, bazuar në imazhet e fundit satelitore (Google Earth 2022), ka përgatitur një analizë tjetër të ndërtimeve dhe ka konstatuar se numri i përgjithshëm i ndërtimeve brenda parkut është gjithsej 1352 ndërtime.

Rezultat i kësaj analize është harta e mëposhtme në të cilën mund të shihet shtrirja hapësinore dhe dendësia e ndërtimeve në territorin e parkut.



Harta nr.x – Shtrirja e ndërtimeve në kuadër të PK "Sharri"

Në vitin 2024, nga DAPKSH/AMMK është bërë inventarizimi i ndërtimeve sipas të cilit, numri i ndërtimeve ka arritur në 1497⁶, gjë që rezulton me një rritje të konsiderueshme prej 265 ndërtimeve të kategorive të ndryshme, të cilat shtrihen në komunat: Prizren, Dragash, Shtërpcë, Suharekë dhe Kaçanik, me gjithsej 39 vendbanime kadastrale.

Sipas funksionit, kategoritë e ndërtimeve në park janë të ndryshme: vikend shtëpi, restaurante dhe hotele, shtëpi, stane për blegtori, hurdhë të peshqve, mini hidrocentrale, anekse të objekteve, kroje, depo dhe të tjera (kiosqe, garazha, pllaka betoni, staza të skijimit si dhe objekte të hidroregjionit, shoqërore, ushtarake, të pa identifikuar/të pa kategorizuara etj.)

⁵ Raporti i Grupit Punues për evidentimin e ndërtimeve dhe ndërhyrjeve të tjera në Parqet Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"/AMMK, Qershor 2020

⁶ Raporti i Grupit Punues për inventarizimin e ndërtimeve në territorin e Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" /AMMK, korrik 2024




Fig x. Kategoritë e ndërtimeve në kuadër të PK" Sharri"

Sa i përket pronës, këto objekte kryesisht janë të ndërtuara në pronë private por ka raste që ndërtimet janë të shprehura edhe në pronë publike, ndërsa në aspektin hapësinor sipas zonimit në PH të PK "Sharri" (2013), shumica e ndërtimeve shtrihen në zonën e tretë (1070) dhe të dytë (399), mirëpo në disa raste ndërtimet paraqiten edhe në zonën e parë (28).⁷



Foto x. Ndërtimet në PK "Sharri"

Trendi i ndërtimeve në PK „Sharri“ ka ndikim negativ në mjedisin natyror dhe në biodiversitetin e zonës. Dukuria e ndërtimeve të paplanifikuara dhe të pakontrolluara në park ka ndodhur në vazhdimësi dhe është në kundërshtim me Ligjin për PK "Sharri" nr.04/L-087 si dhe me Planin Hapësinor për PK "Sharri" (2013), që rezulton me probleme të ndryshme infrastrukturore: furnizimi me ujë të pijshëm, shkarkimi i ujërave të zeza, grumbullimi i mbeturinave dhe shërbimeve tjera. Në territorin e parkut janë evidente një numër i ndërtimeve (vikend shtëpive) që nuk kanë leje ndërtimore për shkak të mungesës së planeve rregulluese për zonat e treta⁸ (sidomos në komunat Suharekë, Kaçanik dhe Dragash) dhe mungesës së zbatimit të legjislacionit adekuat.

⁷ Raporti i Grupit Punues për hartimin e raportit për inventarizimin e Ndërtimeve në territorin e Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"/AMMK (korrik 2024)


⁸ Sipas zonimit në PH të PK "Sharri" (2013)

Sipas legjilacionit dhe rregulloreve në fuqi për parqe kombëtare ndërtimet lejohen vetëm në zonat e planifikuara për zhvillim. Organet kompetente për lëshimin e lejes ndërtimore në kuadër të parkut nuk janë të përcakturara sipas bazës ligjore, pasi që për ndërtimet në Brezovicë, kompetente është komuna e Shtërpçës ndërsa për ndërtimet në Prevallë, kompetente është MMPHI e cila i trajton si objekte të kategorisë së tretë.

Kostoja e ndërtimeve në kuadër të parkut është shumë e lartë për shkak të lëvizjes së çmimeve dhe vështrirësë së transportit të materialit ndërtimor në punishte.

6.4.3.2. Banimi në park

Banimi në parkun kombëtar është një mundësi e mirë për të qëndruar jashtë qendrave urbane, për të qenë më afër natyrës dhe për të shijuar bukuritë e peizazhit natyror. Gjithashtu, banimi në park ofron një jetë të qetë dhe më të shëndetshme. Numri i përgjithshëm i ndërtimeve në territorin PK “Sharri” sipas analizës së DAPKSH/AMMK-së të përgatitur në Korrik 2024, është 1497 ndërtime, prej të cilave 1165 janë objekte të banimit.



Grafikoni nr.x. Ndërtimet në Parkun Kombëtar “Sharri” sipas komunave kadastrale, maj 2023

Numri i përgjithshëm i ndërtimeve në raport me numrin e njësive të banimit⁹ sipas komunave kadastrale është:

1. Në territorin e komunës së Prizrenit, numri i përgjithshëm i ndërtimeve është 401, prej të cilave 304 janë njësi të banimit (249 vikend shtëpi, 13 shtëpi banimi, 23 stane dhe 9 kampshtëpiza lëvizëse).
2. Në territorin e komunës së Suharekës, numri i përgjithshëm i ndërtimeve është 190, të cilat janë njësi banimi (162 vikend shtëpi, 8 stane dhe 20 kampshtëpiza lëvizëse).
3. Në territorin e komunës së Kaçanikut, numri i përgjithshëm i ndërtimeve është 89, prej të cilave 57 janë njësi banimi (17 vikend shtëpi dhe 40 stane).
4. Në territorin e komunës së Dragashit, numri i përgjithshëm i ndërtimeve është 96 prej të cilave 58 ndërtime janë njësi të banimit (7 vikend shtëpi dhe 51 stane).
5. Në territorin e komunës së Shtërpçës, numri i përgjithshëm i ndërtimeve është 721, prej të cilave 556 janë njësi banimi (529 vikend shtëpi, 21 stane dhe 6 kampshtëpiza lëvizëse).

6.4.3.2.1. Banimi në qendrat turistike

Banimi në qendrat turistike luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit dhe në krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për pritjen e vizitorëve. Qendrat turistike, siç është rasti i Brezovicës dhe Prevallës, ofrojnë mundësi të shkëlqyera për pushime dhe argëtim jashtë rutinës së përditshme. Një ndër avantazhet kryesore të banimit në këto zona është afërsia me atraksionet natyrore, peisazhet e mahnitshme dhe aktivitetet e ndryshme të ofruara për turistët. Banimi në qendrat turistike siguron një eksperiencë të veçantë, duke i lejuar njerëzit të jetojnë për një kohë të caktuar në një ambient të

⁹ Raporti i Grupit Punues për hartimin e Raportit për Inventarizimin e Ndërtimeve në territorin e Parqeve Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”/AMMK (korrik 2024)

bukur natyror dhe të përfitojnë nga të gjitha avantazhet që ofron ky destinacion. Në të njëjtën kohë, kjo ndërthurje mes banimit dhe turizmit krijon një dinamikë ekonomike të favorshme, duke stimuluar sektorë të ndryshëm si ndërtimtarinë, shërbimet e akomodimit, restorantet dhe tregtinë vendore. Ndërtimet e planifikuara të njësive të banimit, veçanërisht vikend shtëpive, në PK "Sharri" në Brezovicë, kanë filluar në vitet e 80-ta në përputhje me Planin Rregullues Urban të Qendrës Turistike në Brezovicë. Megjithatë, pas vitit 2000, ka pasur një rritje të shumtë në kërkesat për ndërtimin e vikend shtëpive në qendrat turistike të Brezovicës dhe Prevallës.



Foto x. Banimi në Qendrën Turistike - Brezovicë



Foto x. Banimi në Qendrën Turistike - Prevallë

Qendra turistike "Brezovica" është pjesë e lokacionit së komunës së Shtërpçës dhe është destinacioni më i frekuentuar turistik në kuadër të Parkut Kombëtar, që njëherit nxit kërkesën për të pushuar në një ambient më të qetë dhe më të pastër në krahasim me qytetin.

Në Brezovicë, kërkesat për ndërtimin e vikend shtëpive janë shumë të mëdha. Sipas të dhënave në PH PK "Sharri" (2013) numri i ndërtimit të objekteve të banimit ka qenë 270, i cili sipas të dhënave të fundit është në rritje të vazhdueshme.

Numri i ndërtimeve në Brezovicë në vitin 2019, ka qenë 375 vikend shtëpi ndërsa në Verbeshticë (pjesë e lokacionit Brezovicë) ka qenë 195 vikend shtëpi¹⁰. Mirëpo, sipas analizës së IPH-së (maj, 2023), numri i ndërtimit të objekteve të banimit në Brezovicë ka arritur në 605 vikend shtëpiza (544 në zonën e tretë dhe 61 në zonën e dytë). Ndërtimet në qendrën turistike "Brezovicë" kanë vazhduar në mënyrë kaotike në mungesë të Planit Rregullues të Hollësishëm.

Qendra turistike "Prevalle" është pjesë e lokacionit së luginës së Zhupës, zonës kadastrale - Gornja Sellë e cila ka numrin më të madh të ndërtimeve prej të cilave rreth 200¹¹ janë objekte të banimit (182 në zonën e tretë dhe 18 në zonën e dytë). Në kuadër të qendrës turistike ndërtimet e vikend shtëpive janë në pronën private dhe kanë leje ndërtimore të pajisur nga komuna e Prizrenit dhe MMPHI (rreth 85 leje ndërtimore për kategorinë e III-të të ndërtimeve)¹². Mirëpo, ekziston edhe një numër i vogël i vikend shtëpive që nuk kanë leje ndërtimore dhe një numër tjetër që kanë leje ndërtimore, por nuk janë në përputhje me Planin Rregullues Urban për fshatin Turistik – Prevallë, i cili është hartuar nga KK i Prizrenit në vitin 2006. Megjithatë, në Prevallë nuk ka infrastrukturë adekuate turistike dhe zhvillimi deri më tani është improvizuar dhe krijuar vetëm për përdorime "të përkohshme".¹³

Stanet - Në disa lokacione të parkut gjenden disa objekte banimi (stane) të vjetra të cilat shfrytëzohen nga familjet që merren me blegtori dhe gjatë verës vijnë nga vendbanimet për-rreth parkut. Stanet

¹⁰ Raporti i Grupit Punues për evidentimin e ndërtimeve dhe ndërhyrjeve të tjera në Parqet Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"/AMMK, Qershor 2020

¹¹ Analiza e ndërtimeve e përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor (maj 2023)

¹² Sipas Listës së Aplikacioneve për leje Ndërtimore në zonën turistike "Prevalle" 2017-2021/Divizioni i Ndërtimit/DPHNB/MMPHI

¹³ Draft Raporti Plani Rregullues për Prevallën Zona III

janë të ndërtuara në mënyrë tradicionale prej materialeve autentike të zonës nga druri dhe guri, kurse kulmet janë të mbuluara me tjegulla dhe kashtë. Këto struktura janë të lidhura me torishtën dhe janë të rrethuara me lloje të ndryshme gardhesh. Në PK “Sharri” numri më i madh i staneve ndodhet në pjesën: e Dragashit (48 stane), Prizrenit (23 stane), Shtërpces (18 stane), Kaçanikut (16 stane) dhe Suharekës (2 stane).¹⁴

Arkitektura e objekteve të banimit është plotësisht e paintegruar me struktura dhe materiale ndërtimore jo adekuata për parkun dhe viset malore, ndërsa ndërtimi i gardheve (rrethojave) nuk është në harmoni me peisazhin natyror. Vlerësohet veçanërisht ruajtja e një pjese të rrugës së vjetër të makadamit me tamponë guri.¹⁵

6.4.4. Trashëgimia kulturore


Trashëgimia kulturore¹⁶ është gjithkund rreth nesh duke e formësuar historinë dhe themelet e jetës bashkëkohore. Përveç monumenteve dhe artefakteve të dukshme, trashëgiminë kulturore e përbëjnë edhe mënyra e jetesës, traditat, peizazhet, karakteristikat natyrore, speciet, këngët, vallet, legjendat, artizanatet, lojërat, ritet dhe mënyrat e argëtimit. Kjo trashëgimi është ngushtë e lidhur me njerëzit dhe vendin, të cilët ndikojnë në mënyrën dhe imagjinatën se si shfrytëzohet, respektivisht perceptohet trashëgimia kulturore.

Në territorin e parkut nuk ka asete me trashëgimi kulturore të cilat janë nën mbrojtje, përveç një pjese të sipërfaqes së Zonës së Veçantë të Mbrojtur (ZVM) të Manastirit të Treshit të Shenjtë, i cili gjendet në afërsi të fshatit Mushtisht të komunës së Suharekës. Manastiri i Treshit të Shenjtë ka sipërfaqe prej 29ha, ndërkaq sipërfaqja totale me zonë mbrojtëse është 55.3ha. Në bazë të Ligjit për ZVM, manastiri në fjalë i takon grupit të dytë me bufer zonë prej 100m'. Të gjitha aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në këtë zonë do t'i referohen Ligjit për ZVM dhe Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”.


¹⁴ Analiza e ndërtimeve e përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor (maj 2023)

¹⁵ Evidentimi i ndërtimeve dhe ndërhyrjeve të tjera në PK “Sharri” dhe PK “Bjeshkët e Nemuna është realizuar nga Grupi Punues sipas Vendimit të AMMK/MMPH me Nr. Prot. 5549/18, të dt. 25.09.2018

¹⁶ Nga dokumenti Plani Regjional i Trashëgimisë 2012-2015



Harta x – Trashëgimia kulturore në park dhe në vendbanimet për rreth tij



Harta nr.x – ZVM Manastiri i Treshit të Shenjtë

Disa prej vendbanimeve që e rrethojnë parkun kombëtar kanë asete të trashëgimisë kulturore. Këto asete mundësojnë që vendbanimet në fjalë dhe parku të kenë një ndikim pozitiv të ndërsjellë, në aspektin e zhvillimit ekonomik. Trashëgimia kulturore josh turistët të cilët kanë shkuar ta vizitojnë parkun kombëtar që t'i vizitojnë edhe asetet në këto vendbanime, e në të njëjtën kohë, poashtu t'i shfrytëzojnë shërbimet që ua ofron komuniteti atje në formë të bujtinave dhe ushqimit tradicional. Kështu ata kontribuojnë në rritjen e financimit për zhvillim dhe rrjedhimisht në rritjen e mirëqenjes së komunitetit. Në anë tjetër, ekzistenca e aseteve të trashëgimisë kulturore në vendbanimet afër parkut, paraqet një arsye më shumë për turistët që ta vizitojnë parkun. Në vazhdim është dhënë tabela me vendbanimet në fjalë dhe me asetet e trashëgimisë kulturore që ato i posedojnë.

VENDBANIMET NË AFËRSI TË PARKUT, TË CILAT KANË ASETË TË TRASHËGIMISË KULTURORE		
Vendbanimi	Aseti	Statusi
Komuna e Dragashit		
Krushevë	Lokalitet arkeologjik Hisarishtë	Lista e përkohshme
Restelicë	Tyrbja e Selim Dedës	
Zlipotok	Berat xhamia	
Brod	Kalaja në Hisarë të Brutit	
Bresanë	Xhamia e Kuklibegut	
Komuna e Prizrenit		
Drajqiq	Kisha e Nikollës së Shenjtë	Zonë e veçantë e mbrojtur
Mushnikovë	Kisha e Nikollës së Shenjtë	
	Kisha e Apostujve të Shenjtë	Lista e përkohshme
	Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë	
Gornjasellë	Kisha e Shën Gjergjit	Zonë e veçantë e mbrojtur
Sredskë	Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë	
	Kisha e Nikollës së Shenjtë	
	Kisha e Shën Gjergjit	
	Kisha e Nikollës së Shenjtë – Bogoshevc, ZK Sredskë	

Pllanjan	Kisha e Shën Mërisë me koleksionin e 7 ikonave	Lista e përkohshme
Reçan	Kisha e Shën Gjergjit	
Gërçar	Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë	Zonë e veçantë e mbrojtur
Kabash	Manastiri i Markut të Shenjtë	
	Vetmia e Petrit të Shenjtë	
	Gërmadhat e Murgores dhe Manastirit të Shën Pjetrit	Lista e përkohshme
	Mbetjet e Pargut Mesjetar	
	Rrënojat e kishës varrezore në Quvik	
Rrënojat e Manastirit dhe kisha e Shën Pjetrit dhe Pavlit		
Komuna e Suharekës		
Mushtisht	Manastiri i Treshit të Shenjtë, një pjesë brenda parkut	Zonë e veçantë e mbrojtur
	Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë Hodegetri	Lista e përkohshme
	Gërmadhat e Murgores në kodrën Matos	
	Gërmadhat e Murgores Rusenica	
	Rrënojat e kishës mesjetare në Mushtisht	
Komuna e Shtërpçës		
Biti e Epërme	Kisha e Shën Gjergjit	Zonë e veçantë e mbrojtur
	Lokalitet arkeologjik në Biti të Epërme	Lista e përkohshme
Shtërpçe	Kisha e Nikollës së Shenjtë	Zonë e veçantë e mbrojtur
Gotovushë	Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë	
	Kisha e Nikollës së Shenjtë	Lista e përkohshme
	Lokalitet arkeologjik në Gotovushë	
	Kalaja e Gotovushës	
Brezovicë	Gërmadhat e kalasë antike "Gradishta"	
Firajë	Xhamia e Firajës	
Komuna e Kaçanikut		
Gllloboçicë	Xhamia në Gllloboçicës	Lista e përkohshme
	Shtëpia e Enver Lumës	
	Shtëpia e Minah Lumës	
Strazhë	Xhamia në Strazhë	
Biçec	Mulliri i fshatit Biçec	

Trashëgimia shpirtërore si pjesë e trashëgimisë kulturore është e shprehur në shkallë më të lartë në trevën e Opojës dhe të Gorës. Etnografia e kësaj ane karakterizohet me një kolorit dhe origjinalitet që kultivohet edhe sot e kësaj dite (Me rastin e festave të motmotit, fejesave, martesave etj.). Këto veshje përdoren më shpesh dhe janë unike për të gjitha trevat e rajonit dhe më gjerë, p.sh. veshjet e burrave (tirqit, këmishat, brezi, xhamadani etj.), veshjet e grave (këmisha, dimi, xhamadan, përparëse, çorape, shami të verdhë me theke etj.)



Foto x. - Vallja dhe sporti i pelivanëve në trevat e Opojës

Identitetin shpirtëror të Opojës e kompletojnë traditat shumë të ruajtura muzikore, folklorike, këngët e djepit, lindjes, dasmës, këngët dyshe, vallet në rreth, lojërat nëpër ndeje pas darke, hudhja e gurit nga krahu, kërcimi trehapësh, vrapimi i kuajve, sporti i pelivanëve etj.

6.4.4.1. Ritet

Ritet si dukuri kulturore e shprehur në këto anë përmban praktika të një pjese të shoqërisë, me karakteristika të veçanta të një veprimi me qëllim të caktuar, të cilat kanë një histori dhe përcillen gjeneratë pas gjenerate. Riti i Martesës, Ritet e motmotit në të kaluarën tonë, paraqesin një thesar vlerash të cilat ruajnë besimet dhe bestytnitë të lidhura ngushtë me natyrën, gjithnjë në mbarëvajtje




Foto x. Pikturimi i fytyrës së nuses

të një grupi apo rrethi më të gjërë të shoqërisë. Këto vlera kulturore të organizuara me ceremoni të riteve të motmotit në këto anë mund t'i veçojmë: Riti i Verzës, Shëngjergjit, Thirrjes së shiut etj.

Pikturimi i fytyrës së nuses – Me rastin e festimit të martesave në trevat dhe fshatrat në afërsi të parkut (fshati Lubinje e Poshtme), përgatitja e nuses për martesë bëhet me ritin e pikturimit të fytyrës së saj, rit ky që është trashëguar gjeneratë pas gjenerate dhe mënyra e realizimit është shumë e veçantë dhe unike.



Foto x. Riti i verzës

Riti i Verzës (ardhja e stinës së verës) – Në Opojë është njëri ndër ritet e motmotit që bëhet me një përkushtim të veçantë. Riti është i përmbushur me shumë elemente të karakterit magjik me synim spastrimi, plleshmërie, shëndeti, që i kushtohet individit, familjes, farefisit dhe fshatit. Organizimi bëhet në kodrinat e Bresanës, ku secila lagje ndez zjarr (me degë të mbledhura nga të rinjtë), gjithnjë në garë me lagjet tjera për zjarrin më të madh, e cila simbolizon rritjen e mbarësisë së familjes, lagjes dhe fshatit. Gjatë natës së rritit vajzat e fshatit i dekorojnë vezët të cilat i marrin në shporta të veta dhe me veprime magjike i kushtojnë shëndetit dhe mbarëvajtjes gjatë vitit. Spastrimi nga mëkatet bëhet përmes kapërcimit të zjarrit tri herë (në shuarje e sipër), të cilat përcillen me veshje ceremoniale, muzikë, valle, me larje të fytyrës dhe flokëve në lum në orët e mëngjesit, dhe ceremonia përfundon me një drekë rituale të përgatitur nga zonja e shtëpisë.



Foto x. - Qeni i Sharrit

6.4.4.2. Qeni i Sharrit (Deltari Ilir)

Qeni i Sharrit është qen autokton i trojeve shqiptare, i territorit të Kosovës e sidomos i bjeshkëve të Sharrit. Ky qen njihet prej shumë kohësh, dhe përmendet në historinë e Ilirisë njihet me emrin Qeni Dardan. Qeni i Sharrit është plot fuqi, i madh, këndrejt, qimegjatë, deltar i pazëvendësueshëm, me pamje të vendosur, me kokë masive ndërtim të thukët, me këmbë të fuqishme dhe muskulore. Ka shikim të zjarrtë inteligjent dhe është i guximshëm. Ka karakter të pa djallëzuar është i



Foto x. Ushqimi tradicional

ashpër kur e kërkon nevoja por jo agresiv. Në përgjithësi qeni i Sharrit është i qetë por kur dikush paraqet rrezik për kopenë apo për objektin atëherë shëndrrohet në një armik të frikshëm. Për dallim nga racat tjera, është qen besnik ndaj pronarit dhe familjes, por i lidhur ngushtë me pronarin gjatë gjithë jetës së tij.

6.4.4.3. Ushqimi tradicional

Ushqimi tradicional shihet si pjesë e kulturës dhe traditës që përfaqëson trashëgiminë kulturore, burimet natyrore dhe historinë e trevave në afërsi të parkut. Ushqimi njihet për shije shumë të mirë dhe vlera të larta ushqyese. Pothuajse çdo trevë ofron specialitete të ndryshme sa i përket përbajtjes dhe mënyrës së gatimit. Në listën me mbrojtje të përkohshme, në kategorinë e trashëgimisë shpirtërore kemi: flinë, bukën nore, bukën e mrume dhe bukën e misrit.

Djathi i Sharrit – Djathi i Sharrit është djath i fortë i cili prodhohet në rajonin e maleve të Sharrit, në trevat e Dragashit, Opojës, Gorës dhe Shtërpçës. Djathi i Sharrit prodhohet nga përpunimi i qumështit të deles dhe lopës dhe zakonisht i shtohet sallatave, shërbehet si paragjellë, shoqërohet me bukë të llojeve të ndryshme, me fli, pite etj.

6.5. ZHVILLIMI EKONOMIK

Në Parkun Kombëtar “Sharri” dhe në vendbanimet rreth parkut që janë në afërsi të kufirit të parkut zhvillohen një numër i veprimtarive në të mirë të zhvillimit ekonomik. Aktivitetet të cilat zhvillohen në kuadër të parkut janë të lidhura me turizmin dhe blegtorinë. Me shpalljen e Malit Sharr park kombëtar është kontribuar në mbrojtjen e organizuar dhe gjithashtu shfrytëzimin e vlerave të parkut, para së gjithash për zhvillim të turizmit. Disa nga aktivitetet të cilat kanë ndikim më të madh në shfrytëzimin, rregullimin dhe planifikimin e territorit të parkut kombëtar do të trajtohen si në vijim.

6.5.1. Turizmi dhe potencialet turistike në park

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara ai ka marrë formën e një industrie të plotë me të cilën ndër-veprojnë dhe janë të lidhura ekonomia, politika, hapësira, kultura dhe të gjitha veprimtaritë njerëzore. Ky sektor, mes tjerash, krijon të ardhura, prodhon vende të punës, ndikon në krijim të infrastrukturës, si dhe nxitë shkëmbime kulturore në mes të vendeve nikoqire dhe vizitorëve.

Zona turistike e Maleve të Sharrit është policentrike, ku përfshihen disa komuna si: Prizreni, Shtërpca, Kaçaniku, Dragashi dhe Suhareka, e të cilat kanë pozitë të përshtatshme komunikimi në qendrat e rëndësishme turistike brenda parkut. Vargu malor i Maleve të Sharrit është një lokacion ideal për aventura të panumërta në natyrë, ekskursione, hulumtime shkencore dhe shijim të natyrës, ku çdo stinë ofron një cilësi të veçantë.

Territori i hapësirës së Parkut Kombëtar “Sharri” ka potencial për zhvillimin e aktiviteteve të llojllojshme në favor të zhvillimit të turizmit, por kërkon kompletimin e infrastrukturës, shërbime cilësore, stafit të kualifikuar, e të tjera. Në kuadër të masivit të Sharrit qendrat më të vizituara janë si: Brezovicë, Prevallë, Brod, Restelicë, Guri i Zi, Gradec dhe Delloc. MMPHI në bashkëpunim me Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar (DAPK) “Sharri” janë duke implemtuar projektin për instalimin e pikave kontrolluese në hyrje të zonës së PK, në drejtim të qendrave turistike. Deri me tani janë ngritur pika kontrolluese në rrugën Prizren – Prevallë, Shtërpçë – Prevallë dhe Shtërpçë në drejtim të qendrës turistike Brezovicë. Prej këtyre vetëm pika kontrolluese Shtërpçë në drejtim të qendrës Brezovicë është funksionale dhe menaxhohet DAPK “Sharri”. Pavarësisht gjendjes jo të kënaqshme të

infrastrukturës, turizmi dimëror në Kosovë identifikohet me qendrën e skijimit në Brezovicë, edhe pse viteve të fundit ka pasur një hov të zhvillimit edhe në qendrat tjera si në Prevallë dhe Brod.



Shtigjet e skijimit në Brezovicë

Qendra turistike Brezovicë i takon komunës Shtërpce, në një lartësi mbidetare 900m' - 2500m'. Para vitit 1999, autoritetet e ish Krahinës Autonome të Kosovës kanë krijuar infrastrukturën e ekonomisë turistike në Brezovicë, duke orientuar rreth 1/5 e investimeve në ngritjen e kapaciteteve hoteliere, si dhe infrastrukturën tjetër përkatëse turistike. Sot si pasojë e zgjatjes së procesit të privatizimit dhe në pamundësi për ti aktivizuar, këto asete nuk mund të shfrytëzohen me kapacitet të plotë për t'i përmbushur kërkesat e turistëve.

Sa i përket kapaciteteve akomoduese para vitit 1999, Brezovica dispononte kapacitet me 1112 shtretër, prej të cilëve 690 shtretër ishin në hotele të kategorisë A dhe B, kishte infrastrukturë që mundëson aktivitetet e sporteve dimërorë si: katër teleferik, tre ski ashensor (me kapacitet deri në 850 skitarë/orë) dhe përmbajtje të tjera përcjellëse.



Foto nr.x Teleferiku në Brezovicë

Gjatësia e shtigjeve për skijim në Brezovicë është 40 km, të cilat janë të lidhura ndërmjet vete dhe kanë gjatësi mesatare rreth 3000 metra, ndërsaq në të njëjtën kohë mund të skijojnë deri në 850 skitarë/orë¹⁷. Shtigjet skijimit në Brezovicë janë ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare, por nuk funksionojnë me kapacitet të plotë si pasojë e procesit të privatizimit.

Kapacitetet hoteliere dhe të infrastrukturës së sportit të skijimit të Brezovicës janë: 9 Hotele dhe 16 restorante, 4 teleferikë, 3 ski ashensorë dhe përmbajtje të tjera përcjellëse¹⁸. Kapacitetet hoteliere me të cilat disponon qendra nuk mund t'i përgjigjen kërkesave të turistëve, prandaj trendi i viteve të fundit është akomodimi në vikend shtëpitë private. Numri i vikend shtëpive është rreth 570 sosh. Nuk kemi të dhëna zyrtare për numrin e vikend shtëpive të cilat merren në shfrytëzim.

¹⁷ Informatë e shkurtër mbi resurset turistike të Kosovës, gjendja aktuale të ekonomisë turistike të Kosovës-MTI-Prishtinë, 2001

¹⁸ Sipas imazheve të fundit të gogle earth 2023/burimi: IPH



Foto nr.x Prevallë

Qendra Turistike Prevallë është një lokalitet i rëndësishëm në kuadër të PK „Sharri“, i cili i takon komunës së Prizrenit e që shtrihet në një lartësi mbidetare prej 1500m’-1800m’. Ky lokalitet është specifik pasi që gërshetohen dy rryma të ajrit mesdhetar dhe të bjeshkëve të Sharrit, prandaj rekomandohet edhe për rehabilitimin shëndetësor si: shtimin e rruazave të kuqe të gjakut, përmirësimin e frymëmarrjes dhe zgjidhjen e problemeve tjera. Llojet e turizmit dhe aktivitetet të cilat zhvillohen në zonën e Prevallës janë: turizmi malor, ai dimëror/skijimi, turizmi shëndetësor, aktivitetet në natyrë, ekskursionet, etj.

Qendra turistike Prevallë është ngritur në bazë të planit rregullues urban të hartuar nga Komuna e Prizrenit dhe momentalisht disponon me 8 hotele, 10 restorante, një ski lift dhe rreth 230 vikend shtëpi.¹⁹ Kjo qendër ka një ofertë solide për turizëm malor, me disa shtigje për skijim, e që për të ardhmen paraqet një potencial për zhvillim. Krahasuar me vitin 2007 kemi rritje të vizitorëve si dhe kapaciteteve akomoduese. Numri më i madh i turistëve vërehet gjatë sezonit veror kur turistët vijnë këtu kryesisht për shkaqe shëndetësore. Lokalitetet që rekomandohen për tu vizituar janë: Burimi i Lumëbardhit të Prizrenit, Burimi i Lepencit, Qafa Prevallë, si dhe Pishat e Oshlakut.



Foto nr. x Zyra turistike në Prevallë

Në kuadër të zonës Prevallës ekziston një zyrë turistike por ajo nuk është aktive. Në mungesë të informatave lidhur me numrin e turistëve, kemi shfrytëzuar disa të dhëna të përafërta, ku llogaritet që mesatarisht numri i vizitorëve gjatë vikendeve në sezonin verë/dimër të jetë rreth 500, ndërsa gjatë verës turizmi rezidencial sillet mesatarisht rreth 150 vizitorë në sezonin qershor – gusht²⁰. Në dy vitet e fundit ka një rritje të numrit të turistëve, sidomos nga Shqipëria. Me rritjen e numrit të turistëve rriten edhe kërkesat për akomodim, prandaj turistët vendosen edhe në hotelet të cilat gjenden në afërsi të parkut. Qendra turistike Prevallë ka nevojë për investim në infrastrukturën shërbyese dhe përcjellëse për një zhvillim të turizmit të cilësor.

Zonat me vlera të posaçme në kuadër të masivit të Sharrit që i përkasin Komunës së Suharekës shtrihen në pjesën verilindore dhe juglindore të Mushtishtit, si dhe në zonën e bjeshkëve të Caracëve. Këto anë vizitohen nga turistët e vendit, kryesisht vikendeve në formë të piknikut dhe shëtitjeve në natyrë e poashtu ka grupe të cilët për shkaqe shëndetësore qëndrojnë më gjatë dhe vendosen në stane apo shtëpiza. Bukuritë natyrore, vegjetacioni i pasur bimor, ujqor, lartësia mbidetare 1500m’ – 2400m’, krijojnë mundësi për rehabilitim të persove me sëmundje kronike të frymëmarrjes. Infrastruktura në këtë zonë është e nivelit të dobët, kështu që e pamundëson qëndrimin komod për një numër më të madh të vizitorëve. Turistët janë kryesisht turistë rezidencial që vijnë gjatë sezonit veror, në muajt qershor - gusht.

¹⁹ Rapori i evidentimit të ndërtimeve në dy PK, 2020’

²⁰ Vlerësimi i përafërt me pronarët vikend shtëpive

Komuna e Dragashit – Territori i Komunës së Dragashit që gjendet brenda kufirit të PK "Sharri", karakterizohet me ndërlidhjen mes bukurive natyrore si dhe me llojlojshmërinë e trashëgimisë kulturore, gjë që e bën të veçante këtë zonë. Malet e Brodit, Restelicës, Radeshës e Zaplluxhës janë shumë të përshtatshme për skijim, të cilave iu nevojitet një shtresë e hollë e borës dhe mundësia e shfrytëzimit për skijim mund të zgjasë deri 6 muaj. Karakteristikë e këtyre shtigjeve është edhe mundësia për rrëshqitje në bar, sidomos në pjesën e Zaplluxhës. Vlen të veçohen terrenet me pjerrtësi të lehtë të cilat paraqesin mundësi reale për alpinizëm, ecje, shëtitje malore me biçikleta, etj.


Sipas vlerësimeve të ekspertëve, kapacitetet e terreneve për ski të këtyre qendrave mund të përballojnë deri në 30000 skitarë. Falë terreneve të përshtatshme për ski, në pjesën mbi fshatin Brod është ngritur Qendra Skitare "Arxhena", si njëra ndër qendrat më të reja skitare në Kosovë, e cila disponon me infrastrukturë modeste me 2 teleferik. Në këtë të qendër Federata e Skitarëve të Kosovës organizon edhe gara të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Territori i Komunës së Dragashit është ndër vendet më të pasura me biodiversitetin në Ballkan. Ai karakterizohet me specie endemike, relikte të rralla të bimëve dhe kafshëve e që paraqesin burim potencial për zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese dhe një bazë për zhvillimin e turizmit shkencor. Sa i përket infrastrukturës së akomodimit, pjesa e Dragashit në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri", ka një kapacitet të vogël për përmbushjen e kërkesave të turistëve. Zona disponon me një objekt hotelier me kapacitet prej 45 dhomave, por ekziston mundësia që turistët të akomodohen në hotelet e vendbanimeve për rreth parkut si Brod dhe Dragash. Numri i turistëve të cilët e vizitojnë këtë qendër sillet mesatarisht rreth 300 vizitorë gjatë sezonit dimëror dhe kryesisht janë turistë vendor dhe nga Shqipëria.



Foto nr.x (huazuar) Qendra e skijimit Brod/Dragash

Komuna e Kaçanikut – Pjesa e Komunës së Kaçanikut në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri" karakterizohet me Majën e Lubotenit dhe lokalitetin Nënahishtë. Ky lokalitet i ka disa vikend shtëpi dhe është një vend i përshtatshëm për piknik në natyrë. Maja e Lubotenit, me lartësi 2553m' mbi nivelin e detit është maja më e lartë në kuadër të masivit të Sharrit. Luboteni konsiderohet si maja më e bukur e maleve të Sharrit dhe ofron peizazhe mahnitëse. Në muajin qershor, për çdo vit organizohet ecje në drejtim të Majës së Lubotenit.



Harta nr.x - Turizmi në Parkun Kombëtar "Sharri"



Foto nr.x Luboteni

Numri i turistëve në parqet kombëtare²¹

Parqet kombëtare paraqesin një ndër destinacionet me të rëndësishme turistike të një vendi. Në mungesë të zyrave të informimit në parqet kombëtare, ende nuk ka të dhëna të plota për numrin e përgjithshëm të turistëve që kanë vizituar parqet kombëtare gjatë një viti apo gjatë një sezoni. Megjithatë mund të bëhet një vlerësim i përafërt nëse i marrim në konsideratë të dhënat për numrin e përgjithshëm të vizitorëve të jashtëm dhe vendorë që kanë vizituar regionin e Pejës dhe atë të Prizrenit, duke konsideruar që të njëjtit turistë kanë vizituar edhe parqet kombëtare që shtrihen në këto rajone, si PK "Bjeshkët e Nemuna" dhe PK "Sharri". Bazuar në këtë vlerësim, numri vjetor i turistëve që kanë vizituar Parkun Kombëtar "Sharri", ishte rreth 16 mijë në vitin 2019. Nga ky vlerësim mund të vërehet që kishte një rënie të numrit të turistëve që kanë vizituar parqet kombëtare në vitin 2019 krahasuar me vitin paraprak. Numri i vizitorëve për km² në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" për vitin 2019 ishte rreth 36 vizitorë/1 km², ndërsa numri i vizitorëve për km² në Parkun Kombëtar "Sharri" në vitin 2019 ishte rreth 31 vizitorë/1 km².

²¹ Mjedisitë e Kosovës 2020/Raporti i treguesve Mjedisor

Numri më i përafërt i vizitorëve në tërë hapësirën e parkut mund të konsiderohet numri i vizitorëve që hyjnë në hapësirën e Qendrës së Skijimit në Brezovicë përmes pikës hyrëse, kontrolluese. Kjo pikë kontrolluese është në funksion vetëm gjatë sezonit dimëror. Numri i vizitorëve gjatë vitit sillet mesatarisht nga 50000 deri në 60000 vizitorë. Vetëm gjatë sezonit të dimrit për muajt: janar, shkurt dhe mars, numëri i vizitorëve mesatarisht sillet mbi 30000 persona²², të cilët kalojnë përmes pikës hyrëse drejt QS Brezovica. Ky numër është në rritje të vazhdueshme sipas viteve. Me rritjen e numrit të turistëve rriten dhe kërkesat si: shërbime, transport, parkingje, menaxhim, etj. Sa i përket vendeve se prej nga vijnë, numri më i madh i turistëve të jashtëm vjen nga vendet e regjionit si: Shqipëria 26%, Maqedonia e Veriut 22% dhe Serbia 26%, kurse nga vendet tjera jashtë regjionit numri më i madh i vizitorëve janë nga Gjermania 5% dhe Zvicra 4%.




Fig. nr.x. - Numri i turistëve në PK "Sharri"

6.5.2. Veprimtaria bujqësore dhe blegtorale

Veprimtarië bujqësore dhe blegtorale janë aktivitetet dominuese në PK "Sharri". Këto veprimtari kultivohen në masë më të madhe për konsum familjar, kurse për disa mbeten një nga burimet më të rëndësishme të jetesës. Djathi dhe qengji i Malit Sharr njihen si karakteristika të këtij territori, por sa u përket prodhimit të djathit dhe rritjes së bagëtisë, raportohet se ka rënie të nivelit të këtij aktiviteti si



Fig.nr.x. - Torishta në kuadër të PK "Sharri".

pasojë e vjetërsimit të popullatës. Kullosat në kuadër të PK "Sharri" menaxhohen nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" (DAPKSH) e cila lëshon kontrata për shfrytëzimin e kullosave. Kullotja tradicionalisht zhvillohet prej muajit maj deri në shtator. Në vitin 2021, në DAPKSH janë adresuar 41 kërkesa për shfrytëzimin e kullosave. Prej tyre me së shumti kërkesa apo 23 ka patur për kullosat në pjesën e Dragashit, për pjesën e Prizrenit dhe për atë të Kaçanikut kanë qenë nga 6 kërkesa, kurse për Suharekën dhe Shtërpçen nga 3 kërkesa. Në vitin 2022 shfrytëzimin e kullosave e kanë kërkuar 29 blegtorë dhe numri më i madh ka qenë për pjesën e Dragashit²³. Siq shihet, në vitin 2022 kemi ulje të numrit të kërkesave për shfrytëzimin e kullosave krahasuar me numrin e kërkesave në vitin 2021, gjë që nuk paraqet zhvillim pozitiv në sektorin e blegtorisë. Sa i përket numrit të krerëve, mesatarja e numrit të bagëtive për një blegtor sillet rreth 280 krerë (dele, qengja, lope, vica e kuaj)²⁴.

²² DAPK "Sharri"/ informatë 2023

²³ Raport final për shfrytëzimin e kullosave 2022/DAPKSH

²⁴ Drejtoria e Parkut "Sharri"/ informatë 2021

Për produktet e prodhuara nuk kemi shifra konkrete, por mund ta bëjmë një llogaritje të përafërt në bazë të numrit të blegtorëve dhe mesatares së kopesë. Djathi i Sharrit është produkti kryesor dhe unik i këtyre blegtorëve, i punuar sipas traditës së vjetër, produkt i cili njihet edhe jashtë kufijve të Kosovës. Produktet kryesisht plasohen në tregun vendor dhe një sasi destinohet për vendet tjera si Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe më gjërë. Brenda territorit të parkut nuk ka pika grumbulluese për prodhimet blegtorale, por ato gjenden jashtë territorit, në afërsi të parkut

PK "Sharri" karakterizohet edhe me kultivimin e Qenit të Sharrit dhe të bletëve. Kultivuesit e bletëve, kryesisht kosheret i kanë të vendosura jashtë territorit të PK "Sharri". Mjalti i prodhuar këtu njihet si produkt i kualitetit të lartë. Sipas informatave zyrtare nga DAPKSH²⁵ ka pasur vetëm një kërkesë për vendosjen e koshereve të bletëve në Grykën e Lumëbardhit të Prizreni, ku numri i koshereve do të arrinte në 60 sosh.



Foto nr.x – Bimët mjekësore aromatike në park


PK "Sharri" është shumë i pasur me bimë mjekësore, aromatike dhe bimë të tjera të rëndësishme për industrinë farmaceutike, ushqimore dhe kozmetike. Në bazë të të dhënave nga hulumtimet, në park janë prezente 22 specie të bimëve, të cilat mund të konsiderohen si potencial i burimit ekonomik.

Ekziston plani për menaxhimin e burimeve të PPJ (Produkteve Pyjore Jo drusore) në PK "Sharri", i cili është pjesë e planifikimit të përgjithshëm për menaxhimin e burimeve të pyjeve dhe parqeve kombëtare 2015/2016. Në kuadër të këtij dokumenti është i llogaritur potenciali i mundshëm ekonomik sipas grupeve të bimëve për tërë zonën e parkut. Konsiderohet se rreth 3000 tonelata të materialit të freskët të 22 specieve bimore janë të

pranueshme dhe janë në dispozicion për leje për shfrytëzim në Parkun Kombëtar "Sharri".²⁶ Përkundër këtij dokumenti, organizimi i vjeljes së bimëve mjekuese dhe frutave të imta bëhet pa pëlqimin e autoriteteve të parkut. Ato mblidhen nga banorët lokal, ndërsa kompanitë organizohen për grumbullimin e tyre për ti dërguar në drejtimet përkatëse. Duke u bërë pa pëlqimin e autoriteteve të parkut, ky aktivitet i grumbullimit të frutave dhe bimëve mjekuese konsiderohet si biznes joformal.

²⁵ Drejtoria e Parkut "Sharri"/informatë 2022

²⁶ Plan i vjetor i veprimit për produktet pyjore jodrusore në Parkun Nacional të Sharrit në Kosovë / Në kontekst të Planit menaxhues për PNSharri dhe Planit operativ 2015-2019



Harta nr.x – Aktivitetet blegtorale brenda parkut kombëtar

6.5.3. Veprimtaria pyjore

Në strukturën e vegjetacionit dominojnë kullosat, pyjet mbulojnë sipërfaqe më të vogla, ndërsa livadhet shtrihen në afërsi të vendbanimeve, pa marrë parasysh lartësinë mbidetare. Pyjet private, në të shumtën, janë pyje të ulëta, të llojeve të bungut, të mbetura në terrene të pjerrëta. Një pjesë e pyjeve të pronarëve privat përdoret për dru zjarri. Lënda drusore e këtyre anëve shpesh shfrytëzohet në mënyrë të pakontrolluar për përfitime ekonomike vetanake. Shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve ka ndikuar edhe në zbritjen e kufirit të sipërm pyjor.

6.5.4. Tregtia

Në Parkun Kombëtar ‘Sharri’ zhvillohet tregtia me pakicë, në formë kioske, për të tregtuar produkte elementare. Numri maksimal arrinë deri në 9 sosh, në të gjithë parkun. Gjithashtu në bufer zonë janë prezentë 3 hurdha për kultivimin e peshkut e të cilat bazuar në kapacitetin e tyre, renditen në grupin e tregtisë me pakicë. Peshku i kultivuar tregtohet tek banorët e zonës si dhe restorantet në afërsi. Në mungesë të një organizimi më të mirë për ofrimin e produkteve karakteristike të zonës për vizitorët, ato ekspozohen dhe tregtohen nga shitësit ambulant përskaj rrugës. Ky është biznes jo formal brenda parkut.

6.6. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET

Teksti në vazhdim e paraqet gjendjen aktuale të infrastrukturës dhe të shërbimeve të cilat ajo i mundëson në Parkun Kombëtar ‘Sharri’ dhe në vendbanimet për rreth parkut që janë ngushtë të ndërlidhur me parkun në funksione të ndryshme. Këtu bëhet fjalë për infrastrukturën e transportit, infrastrukturën ujore, infrastrukturën e energjisë elektrike, infrastrukturën e telekomunikimit, infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave dhe rrjedhimisht për shërbimet e transportit, furnizimit

me energji elektrike, furnizimit me ujë të pijshëm, qasjes dhe shkëmbimit të informatave dhe të largimit të mbeturinave.

6.6.1. Transporti dhe infrastruktura e tij

Zonën e Parkut Kombëtar “Sharri” e përshkon rruga e asfaltuar regjionale R115 në relacionin Doganaj (komuna e Kaçanikut) - Shtërpc - Prevallë - Prizren. Kjo rrugë është renovuar pas vitit 2000 dhe është në gjendje të mirë. Nga qendra turistike Brezovica deri tek terrenet e skijimit në afërsi të saj shtrihet rruga regjionale R210. Rruga regjionale R116 në relacionin Doganaj - Gllloboçicë (kufiri me Maqedoninë e Veriut) gjendet në afërsi të drejtpërdrejt të parkut kombëtar. Kjo rrugë është në gjendje të mirë dhe shumë e rëndësishme për parkun kombëtar sepse e lidhë atë në një distancë të shkurtër me Maqedoninë fqinje. Një hyrje në park, nga një drejtim tjetër e mundëson rruga regjionale R118, në relacionin Therandë – Mushtisht (Komuna e Therandës) – Vërbeshticë (Komuna e Shtërpcës) – Shtërpc. Rruga R118 nuk është në gjendje të mirë, ndërkaq në segmentin nga Mushtishti deri në Vërbeshticë, në një pjesë të madhe është e paasfaltuar. Rëndësia e kësaj rruge qëndron në faktin se e lidhë territorin e komunës së Therandës drejtpërdrejtë me zonën e parkut kombëtar dhe ua shkurton ndjeshëm distancën banorëve të kësaj komune me qendrën turistike të Brezovicës.

Rruga regjionale R113 në pjesën jugore të saj shtrihet në perëndim të territorit të komunës së Sharrit (Dragashit). Tek fshati Gllloboçicë kjo rrugë afrohet fare pranë kufirit të Parkut Kombëtar “Sharri” gati sa takohet me të. Duke vazhduar kah jugu për tek fshati Restelicë, i cili gjendet mu pranë kufirit të parkut, rruga R113 në një segment fare pranë fshatit Krushevë dhe në një segment midis fshatrave Krushevë dhe Restelicë, kalon nëpër vijën kufitare të parkut. Rruga regjionale R114 që fillon në Sharr (Dragash) dhe vazhdon të shtrihet kah juglindja për tek fshati Brod, afër fshatrave Dikanc dhe Baçkë bashkohet me vijën kufitare të parkut dhe vazhdon nëpër atë vijë deri në Brod, i cili gjendet mu pranë kufirit të parkut. Rruga regjionale R222 lidhet me R113 afër fshatit Pllavë dhe shtrihet kah lindja deri tek fshati Zaplluxhë. Kjo rrugë në një segment midis fshatrave Blaç dhe Zaplluxhë i afrohet më së shumti vijës kufitare të parkut, rreth 1.4 km në vijë ajrore. Asnjëra prej rrugëve regjionale R113, R114 dhe R222 nuk hyn brenda në territorin e parkut, por në vazhdim të këtyre tri rrugëve janë rrugët lokale, të cilat hyjnë në parkun kombëtar. Rrugët regjionale në fjalë janë në gjendje relativisht të mirë fizike, sidomos rruga R 114.

Banorët e vendbanimeve për rreth parkut kombëtar të ndodhura afër kufirit të parkut janë të ndërlidhur me parkun përmes pronave që i kanë atje dhe veprimtarive që i kryejnë, kështu që ata kanë nevojë për qasje sa më të lehtë në territorin e parkut përmes rrugëve të qarkullueshme për vetura apo për automjete të terreneve malore. Vendbanimet në fjalë, të cilat lidhen me territorin e parkut përmes këtyre rrugëve janë: Brezne, Buçë, Rapçë, Kërstec, Gllloboçicë (Komuna e Dragashit), Krushevë, Restelicë, Brod, Radesh, Pllajnik, Kuk, Kuklibeg, Brodosanë, Blaç, Zaplluxhë, Struzhë, Manastiricë, Lubinjë e Epërme, Lubinjë e Poshtme, Mushnikovë, Gornjasellë, Pllanjan, Skorobishtë, Kabash, Greikoc, Mushtisht, Delloc, Maqitevë, Sevcë, Jazhincë, Vërbeshticë, Brezovicë, Shtërpcë, Gotovushë, Drekok, Firajë, Brod, Sllatinë, Vatë, Gllloboçicë (Komuna e Kaçanikut) dhe Strazhë.²⁷ Rrugët nga Lubinja e Epërme dhe Lubinja e Poshtme të çojnë deri tek kufiri i parkut. Disa nga këto vendbanime si: Gllloboçica (Komuna e Dragashit), Restelica, Brodi, Kuk, Zaplluxha, Manastirica, Gornjasella, Jazhinca dhe Brezovica kanë qasje në territorin e parkut përmes rrugëve të asfaltuara, kurse rrugët nga Mushtishti dhe nga Delloci për në park janë duke u asfaltuar.²⁸ Rrugët e asfaltuara të cilat i lidhin vendbanimet Vatë dhe Gllloboçicë (Komuna e Kaçanikut) shtrihen deri tek kufiri i parkut kombëtar pa hyrë brenda në park. Nga Brodosana, rruga për në park është e shtruar me kubëza.²⁹

²⁷ Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”

²⁸ Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”

²⁹ Po aty

Linja kryesore hekurudhore e Kosovës në relacionin Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit kalon jo shumë larg nga hapësira e parkut. Stacioni më i afërt hekurudhor, ai i Ferizajt është 30 km larg parkut kombëtar kurse Aeroporti i Prishtinës është rreth 60 km larg.




Foto: Rruga drejt qendrës turistike

Sa i përket transportit, në rrugën regjionale R115 zhvillohet transporti i udhëtarëve me vetura individuale, kurse në sezonin e skijimit zhvillohet edhe transporti publik i udhëtarëve nga qendrat e ndryshme të Kosovës në drejtim të qendrës së skijimit të Brezovicës dhe anasjelltas. Në këtë rrugë poashtu zhvillohet transporti publik i udhëtarëve në relacionin Prizren – Prevallë dhe anasjelltas.

Brenda territorit të parkut që i përket Komunës së Sharrit (Dragashit) nuk ka vendbanime, prandaj tani për tani nuk ka transport publik që do t’ua mundësonte udhëtarëve shkuarjen në park. Transporti publik me furgonë që realizohet nga operatorët privat, të cilët nuk kanë leje komunale dhe as orar të caktuar të qarkullimit, ua mundëson qytetarëve të shkojnë në të gjitha fshatrat që janë më afër parkut. Disa nga këta fshatra janë mu pranë kufirit të parkut kombëtar. Transporti i organizuar me autobus ku operatori ka leje

komunale, realizohet në relacionin Sharr – Zaplluxhë. Zaplluxha është fshat në afërsi të parkut. Operatori është ndërmarrja transportuese “Edi Tours” me seli në Zaplluxhë.



Harta nr.x Rrjeti rrugor në PK “Sharri” dhe rreth tij

6.6.2. Infrastruktura ujore

Ujësjellësit – Parku Kombëtar “Sharri” është i pasur me burime ujore nga të cilat furnizohen me ujë vendbanimet për rreth parkut përmes ujësjellësve lokal që ujin e sjellin me rënje të lirë.

Të gjitha vendbanimet e komunës së Shtërpcës që janë në afërsi të kufirit të parkut i kanë ujësjellësit e tyre lokal. Uji në këta ujësjellës vjen me rënje të lirë nga rezervoarët, të cilët mbushen me ujë nga burimet ujore të parkut kombëtar.

Në territorin e Komunës së Prizrenit, prej vendbanimeve në afërsi të kufirit të parkut, vetëm fshati Pouskë furnizohet me ujë të pijshëm nga KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren, kurse vendbanimet: Skrobishtë, Dojnicë, Vërbiqan, Novosellë, Llokvicë, Nebregoshtë, Manastiricë, Struzhë, Lubinjë e Epërme, Lubinjë e Poshtme, Mushnikovë, Gornje Sello, Reçan, Zhivinjan, Pllanjan, Sredskë, Drajciq dhe ish karauilla te Guri i Zi furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësit lokal që e marrin ujin nga burimet ujore të parkut. Pika turistike - rekreative e Prevallës që është brenda Parkut Kombëtar “Sharri”, gjithashtu e ka ujësjellësin e saj lokal që furnizon me ujë objektet shërbyese hoteljere që ndodhen aty.

Vendbanimet Mushtisht dhe Grekoc të komunës së Therandës furnizohen me ujë të pijshëm nga KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren.³⁰ Fshati Shtrazë i Komunës së Kaçanikut e ka ujësjellësin i cili ujin e sjellë me rënje të lirë nga rezervoari, i cili mbushet duke e shfrytëzuar burimin ujqor të parkut përmes sistemit të pompimit thithës.


Shumica e vendbanimeve rreth parkut që i përkasin Komunës së Dragashit furnizohen me ujë nga sisteme private që e marrin ujin qoftë nga puset, krojet apo nga ujrata mbitokësor. Ujrata mbitokësor i kanë burimet brenda territorit të parkut. Nga këto vendbanime, vetëm Brezne furnizohet me ujë nga

³⁰ KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh. A Prizren – RAPORT VJETOR, 2022

Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren.³¹ Në Rapçë vetëm rreth 20% të banorëve furnizohen me ujë të cilin e marrin nga puset. Në fshatrat Restelicë dhe Kërstec, 80% e banorëve furnizohen me ujë të pijshëm nga sistemet private, me ç’rast në Restelicë uji merret nga ujrat mbitokësor, kurse në Kërstec nga puset. Në vendbanimet tjera për rreth parkut të komunës së Dragashit, me ujë furnizohen 100% të banorëve. Në Zaplluxhë, Blaç, Bresanë, Kuk, Kuklibeg, Kosavë, Pllajnik, Leshtan, Lubovishtë, Kukuljan, Dikancë, Brod, Baçkë, Zllipotok, Krushevë, Gilloboçicë dhe Buçë uji merret nga ujrat mbitokësor, kurse në Radeshë dhe Orçushë nga krojet.³²

Kanalizimet – Restelica, Zaplluzha, Leshtani, Baçka, Zllipotoku dhe Krusheva janë vendbanimet e Komunës së Dragashit, përreth parkut që janë të lidhur në sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza, kurse pjesërisht të lidhur janë vendbanimet Kërstec, Pllajnik dhe Rapçë. Nga Komuna e Kaçanikut, fshati Shtrazë ka rrjet të kanalizimit.

Vendbanimet e Komunës së Shtërpces me kanalizime janë: Brezovica, Gotovusha, Drajkofci dhe Berofci. Sa i përket Komunës së Therandës, rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza shtrihet në Grejkoc dhe Mushtisht. Asnjë nga vendbanimet në afërsi të kufirit të parkut që i përkasin Komunës së Prizrenit nuk ka rrjet të kanalizimit.



Harta nr. X Ujësjetësimit dhe kanalizimet në PK “Sharri” dhe rreth tij

6.6.3. Infrastruktura e energjisë elektrike

Lokaliteti i Prevallës në hapësirën e Parkut Kombëtar “Sharri” furnizohet me energji elektrike nga largpërquesi 10kV Dalja e Zhupës, i cili është i vjetër dhe shumë i amortizuar. Në Prevallë ekziston


³¹ Po aty

³² UNDP/Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – Korniza për zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të baraspeshuar për Komunën e Dragashit, Kosovë, 2013

vetëm një trafostacion me fuqi instaluese 250kVA. Konsumatorë të përhershëm këtu janë 8 hotele, 10 restorante dhe rreth 230 vikend shtëpi.

Në pjesën e Komunës së Shtërpcës, vikend shtëpizat në lokalitetin “Tërshenje” në hapësirën e parkut kombëtar furnizohen me energji elektrike nga TS 35/10kV Shtërpce drejtimi hotel “Breza” përmes kablllove ajror në shtylla të drunjta që janë në gjendje solide. Në lokalitetin “Tërshenje” janë 6 trafostacione: TTSH Tërshjevina 50kVA, TSB Tërshjevina 100kVA, TSB Tërshjevina 250kVA, Tërshjevina 100kVA, MBTS Lahor 630 kVA dhe MBTS KEK 630kVA. Nga katër të parët furnizohen vikend shtëpizat. Ndërkaq “Qendra e skijimit Brezovica”, “Shkolla e skijimit”, hoteli „Molika”, vikend shtëpizat te „Shtëpia e Stojkut” dhe repetitori, që të gjitha në zonën e parkut kombëtar, furnizohen me energji elektrike nga TS 35/10kV Shtërpce drejtimi Sharri përmes kablllove ajror në shtylla rrjetore. Trafostacionet që furnizojnë objektet e lartpërmendura janë: MBTS Crvena karpa 1x630kVA, MBTS Shkolla e skijimit 630kVA, MBTS Molika 2x100kVA, TSM Kulla 160kVA, TTSH Repetitori 50kVA dhe MBTS Piri Breg 2x630kVA (jashtë funksionit). TS 35/10kV furnizohet nga TS 110/35kV Bibaj (komuna e Ferizajt).

Elektriciteti në Sharr ka arritur në vitin 1957 kur ndërtohet rrjeti elektrik dhe fillon prodhimin hidrocentrali i Dikancës. Ky rrjet është edhe sot në përdorim. Hidrocentrali i vogël i Dikancës është duke operuar përgjatë lumit të Brodit afër fshatit Baçkë. Ky central elektrik është në pronësi të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), mirëpo i është dhënë me koncesion kompanisë Frigo Food në vitin 2009. Rehabilitimi i objekteve të hidrocentralit ka mbaruar me ç’rast janë zëvendësuar pajisjet dhe është rritur kapaciteti i prodhimit deri në 2600 KW.



Harta nr.x Infrastruktura e energjisë elektrike në PK “Sharri” dhe rreth tij

6.6.4. Telekomunikacioni

Infrastruktura fikse brezgjërë e komunikimeve elektronike është e shtrirë në të gjithë hapësirën e Parkut Kombëtar “Sharri” duke përfshirë edhe objektet hoteliere/turistike dhe vendbanimet në afërsi

të kufirit të parkut. Rrjeti i telefonisë fikse mbulon vetëm një pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” që është brenda komunës së Shtërpçës. Në qendrën komunale të Shtërpçës është centrali i telefonisë fikse me kapacitet prej 1500 numrash, por për shkak të zhvillimit të shërbimeve tjera të telefonisë mobile dhe të internetit kërkesa e shfrytëzimit të tyre është në rënie e sipër. Nga ky central përquesi kryesor shkon në drejtim të Brezovicës dhe qendrës së skijimit, të “Brvnara” ai ndahet dhe me këtë rast njëra degë shkon në hotelin „Narcis” kurse tjetra në drejtim të qendrës së skijimit, në Rexhina Tërshenja dhe në hotelin „Molika”. Mbulueshmëria e parkut nga valët e telefonisë mobile është e konsiderueshme. Të gjitha lokacionet e banuara në park dhe për rreth parkut mbulohen nga sinjali GSM që mundësohet nga operatorët Ipko dhe Vala. Infrastruktura fikse brezgjërë e mundëson që të ofrohen shërbimet e Internetit dhe përmbajtjeve televizive në park dhe në vendbanimet rreth parkut.

6.6.5. Menaxhimi i mbeturinave

Shërbimi i largimit të mbeturinave i përfshinë lokacionet e banuara brenda Parkut Kombëtar “Sharri”. Këtë shërbim në Prevallë e realizon Kompania Rajonale e Mbeturinave “Eko-Regjioni” duke e bërë derë më derë grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Në Brezovicë me mbeturinat merret Kompania e Re për Shërbime Publike “Shtërpçe”. Kjo është një kompani komunale e cila është themeluar dhe ende funksionon në kuadër të sistemit të Republikës së Serbisë. Mbeturinat mblidhen derë më derë një herë në javë.

6.7. ANALIZA SWOT

ANALIZA SWOT	
Përparësitë	Mundësitë
<ol style="list-style-type: none"> 1. Pozita e përshtatshme gjeografike e PK “Sharri”; 2. Veçoritë natyrore të llojlojshme (lugina, lumenj, liqene, male të larta); 3. Flora dhe fauna e pasur dhe me disa lloje endemike; 4. Ekzistenca e autoritetit të parkut – Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”; 5. Ekzistenca e planit hapësinor dhe e planit të menaxhimit për PK “Sharri”; 6. Potencialet e mëdha për zhvillimin e turizmit; 7. Trendi i rritjes së numrit të turistëve; 8. Kullosat e cilësisë së lartë; 9. Pasuria e madhe e Parkut Kombëtar “Sharri” me bimë mjekësore, aromatike dhe bimë tjera të rëndësishme për industrinë farmaceutike. 10. Disponueshmëria me të dhëna aktuale globale dhe kombëtare për mbulueshmërinë e tokës; 11. Ekzistenca e hartës së pronësisë në nivel kombëtar dhe për PK “Sharri”; 12. Fond i pasur me pyje dhe kullosa; 13. Asetet me trashëgimi kulturore gjenden në afërsi të parkut. 14. Ligji për ndërtim; 15. Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit (6 udhëzime administrative); 16. Ligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore; 17. Qasja e mirë në park përmes tri rrugëve regionale dhe tri rrugëve lokale; 18. Gjendja e mirë fizike e shumicës së rrugëve; 19. Afërsia me aeroportin e Prishtinës, Shkupit dhe Kukësit; 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shfrytëzimi i përvojave të vendeve të zhvilluara për zhvillimin e parkut; 2. Hulumtimet shkencore për florën dhe faunën; 3. Hulumtimet shkencore për veçoritë fizike në park; 4. Përfshirja në iniciativat e ndryshme ndërkombëtare, shfrytëzimi i projekteve të ndryshme; 5. Iniciativa dhe bashkëpunimin ndërkufitar për projekte të përbashkëta ndërkufitare me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë; 6. Aktivitete edukativo-arsimore; 7. Marketingu dhe promovimi i PK “Sharri” si destinacion turistik; 8. Investimet në përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe rritjen e kapaciteteve në qendrat si Brezovicë, Prevallë, Brod; 9. Aktivizimi i zyrës turistike - informuese në Prevallë; 10. Krijimi i bizneseve turistike në bashkëpunim me ARBK-në; 11. Zbatimi i standardeve të cilësisë për sektorin e akomodimit; 12. Ndihma dhe përkrahja për zhvillimin e turizmit nga donatorë të huaj; 13. Mundësia e përvetësimit të indikatorëve specifikë nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA) ose Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara për monitorimin e shfrytëzimit të tokës; 14. Përfitime ekonomike nga taksat e tatimit në pronë; 15. Parteniteti publiko-privat (PPP) për zhvillimin e qëndrueshëm të parkut; 16. Kufizimi i dendësisë së banimit; 17. Rritja e performancës energjetike të ndërtesave sipas Direktivës së Performancës së Energjisë së Ndërtesave

<p>20. Realizimi i transportit publik në relacionin Prizren-Prevallë dhe nga qendrat e ndryshme të Kosovës deri në Brezovicë;</p> <p>21. Ekzistenca e ujësjellësit lokal në pikën turistike të Prevallës që furnizon me ujë të pijshëm ndërtesat e banimit dhe ndërtesat shërbyese hoteljere që ndodhen aty;</p> <p>22. Infrastruktura fikse brezgjere e komunikimeve elektronike e shtrirë në të gjithë hapësirën e Parkut Kombëtar "Sharri" mundëson shërbimet e Internetit dhe televizionit për ndërtesat hoteliere/turistike, ato të banimit dhe vendbanimet në afërsi të parkut;</p> <p>23. Mbulimi i të gjitha ndërtesave të banimit dhe ndërtesave shërbyese-hoteljere në park nga sinjali GSM i telefonisë mobile;</p> <p>24. Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse deri tek disa ndërtesa shërbyese-hoteljere në park;</p> <p>25. Përfshirja e ndërtesave të banimit dhe ndërtesave shërbyese-hoteljere në park nga shërbimi i largimit të mbeturinave</p>	<p>2010/31/BE dhe Direktivës së Eficiencës së Energjisë 2012/27/BE.</p> <p>18. Ndërtime me standarde të Republikës së Kosovës, BE-se dhe ISO;</p> <p>19. Mundësi për të jetuar pranë natyrës dhe për të eksploruar natyrën;</p> <p>20. Kufizime në madhësinë e ndërtimeve, materialin e përdorur dhe burimet e energjisë të përdorura për energjinë e ndërtesave;</p> <p>21. Krijimi i ambientit të sigurtë dhe i lehtësuarve për investitorët e huaj;</p> <p>22. Shfrytëzimi i burimeve të jashtme financiare për financimin e projekteve zhvillimore;</p> <p>23. Prioritizimi i projekteve zhvillimore dhe fillimisht, financimi i atyre më prioritare;</p> <p>24. Rritja e investimeve nga Qeveria e Kosovës, nga sektori privat apo nga partneriteti publik-privat në zhvillimin e infrastrukturës në përgjithësi dhe në zhvillimin e infrastrukturës ujore në veçanti;</p> <p>25. Realizimi i projekteve më prioritare infrastrukturore siq janë: instalimi i sistemit publik të kanalizimit të ujërave të zeza, i menaxhuar nga kompanitë rajonale të ujësjellësit dhe ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza</p>
Dobësitë	Kërcënimet
<ol style="list-style-type: none"> 1. Shfrytëzimi jo racional dhe i pa planifikuar i resurseve natyrore; 2. Ndërtimet ilegale; 3. Degradimi i pyjeve si pasojë nga: zjarri, sëmundjet dhe prerjet e pakontrolluara; 4. Shkalla e lartë e erozionit; 5. Mungesa e stafit në Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri"; 6. Mungesa e statistikave të sakta për kapacitete të hoteleve, restoranteve, numrit të vizitoreve, prodhimeve të blegtoreve, etj 7. Buxhet jo i mjaftueshëm për menaxhimin e parkut; 8. Mungesë e zyrave të informimit në park; 9. Vonesat në aktivizimin e pikave kontrolluese në të gjitha hyrje-daljet në PK "Sharri"; 10. Menaxhimi dhe mirëmbajtja jo e kënaqshme e shtigjeve për vizitorët; 11. Zgjatja e procesit të privatizimit në Qendrën Turistike Brezovica; 12. Mungesa e një brendi prodhues të zonës; 13. Zvogëlimi e numrit të blegtorëve; 14. Mungesa e hapësirës për ekspozimin e produkteve të zonës – Ekspozimi dhe shitja e prodhimeve të bylmetit dhe produkteve të tjera përgjatë rrugës; 15. Vjelja dhe grumbullimi i frutave, bimëve mjekuese dhe aromatike në mënyrë të pakontrolluar; 16. Mungesa e indikatorëve specifik për monitorimin e shfrytëzimit të tokës në Kosovë. 17. Mungesa e një harte të plotë dhe të aktualizuar të shfrytëzimit të tokës. 18. Mungesa e një kontrolli normativ të mjaftueshëm për dendësinë e zonave urbane në park. 19. Mungesa e fondeve të mjaftueshme të tokës publike në zonat e banuara; 20. Mungesa e aktiviteteve hulumtuese-shkencore dhe edukativo-arsimore; 21. Mungesa e planeve rregulluese të hollësishe; 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbështetje e ultë institucionale; 2. Fatkeqësitë eventuale natyrore (vërshimet , tërmetet, zjarret, etj.); 3. Aktivitetet eventuale që e ndotin mjedisin; 4. Pandemitë apo epidemitë eventuale; 5. Mos koordinimi eventual i investimeve dhe zhvillimeve; 6. Mbajtja ose mosdorëzimi i librave kadastral të Kosovës nga ana e Serbisë; 7. Mospërfshirja në konventa, iniciativa dhe organizata ndërkombëtare (IUCN, ÈTO, RIO, UNESCO, ICOMOS etj); 8. Ndryshimet klimatike; 9. Ndikimi i shëndetit publik në kushtet e banimit; 10. Dështimi për krijimin e një ambienti të sigurtë dhe tërheqës për investimet nga jashtë; 11. Përkeqësimi eventual i situatës politike me pasojë trazirat dhe destabilizimin e vendit; 12. Zhagitja apo dështimi për t'i realizuar projektet zhvillimore tash më të planifikuar dhe atyre që do të planifikohen për shkak të ndikimit frenues eventual të faktorëve të jashtëm; 13. Perceptimi eventual i investitorëve të huaj për Kosovën si vend jo atraktiv për investime në krahasim me vendet tjera të rajonit, pavarësisht krijimit nga qeveria të të gjitha lehtësuarve për ta; 14. Mungesa eventuale e propozimeve dhe kërkesave qoftë nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat për realizimin e projekteve zhvillimore

<p>22. Mangësitë në zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve;</p> <p>23. Lëshimi i lejeve ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë, edhe nga organet e pushtetit lokal edhe nga ato të pushtetit qendror, varësisht nga përkatësia komunale e zonës së parkut;</p> <p>24. Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm me organizatat ndërkombëtare;</p> <p>25. Dëmtimi i peisazhit natyror nga ndërtimet;</p> <p>26. Ndërtimi i njësive të banimit pa infrastrukturë përcjellëse;</p> <p>27. Kosto e lartë e ndërtimit;</p> <p>28. Gjendja e keqe fizike e njërës nga rrugët regjionale në park;</p> <p>29. Mungesa e linjave të rregullta të transportit publik për tek QT Brezovicë dhe QT Prevallë;</p> <p>30. Mungesa e shenjzimeve në shtigje;</p> <p>31. Mospërfshirja në rrjetin e telefonisë fikse të shumicës së ndërtesave të banimit dhe ndërtesave shërbyese-hoteljere në park;</p> <p>32. Mungesa e sistemeve publik të kanalizimit të ujërave të zeza, të menaxhuar nga kompanitë rajonale të ujësjellësit (KRU);</p> <p>33. Mungesa e impianteve për trajtimin e ujrave të zeza</p>	
--	--

6.8. SFIDAT KRYESORE ZHVILLIMORE

Institucionet përgjegjëse për parkun dhe grupet e ndryshme të interesit, në rrugën e tyre për ta ruajtur por edhe zhvilluar parkun, padyshim se do të ballafaqohen me sfida të ndryshme të cilat lidhen pikërisht me këto dy qëllime kryesore: mbrojtjen dhe ruajtjen e parkut, nga njëra anë dhe zhvillimin e tij, nga ana tjetër. Gjatë hartimit të këtij plani hapësinor, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese në park dhe në zhvillimet e dëshiruara në të ardhmen, janë identifikuar këto sfida:

1. Administrimi dhe menaxhimi i parkut;
2. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, peisazhit, biodiversitetit dhe vlerave natyrore e kulturore të parkut;
3. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik në park;
4. Rigjallërimi i aktiviteteve tradicionale në vendbanimet e parkut dhe ruajtja e traditës si faktorë ndikues në ndaljen apo zvogëlimin e migrimit

6.8.1. Administrimi dhe menaxhimi i Parkut Kombëtar “Sharri”

Në territorin e Parkut Kombëtar “Sharri” ka vlera të veçanta natyrore, me rëndësi të jashtëzakonshme, për Republikën e Kosovës dhe më gjerë, prandaj mbrojtja, ruajtja, respektimi dhe shfrytëzimi i këtyre vlerave janë me interes të përgjithshëm vendor por edhe rajonal e ndërkombëtar. Duke qenë kështu, Qeveria e Kosovës, përmes arritjes së pajtimit në mes të të gjitha palëve të rëndësishme të interesit, ka nisur dhe përfunduar procedurat e (ri)shpalljes si park kombëtar të një zone të përcaktuar me vlera të veçanta natyrore nga tërësia e masivit të Maleve të Sharrit. Me këtë rast, në mbështetje të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës me nr. 03/L-233, në vitin 2012 Parku Kombëtar “Sharri” është shpallur me Ligjin për PK “Sharri” me nr. 04/L-087. Shpallja e parkut kombëtar pasohet me nxjerrjen e Rregullores për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare me nr. 21/2013 dhe Planin e Menaxhimit të PK “Sharri” me nr. 18 (1212/15). Më pas, siq e kërkon ligji për parkun, është themeluar Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” (DAPKSH).

Çka është sfida?

Fillimisht, administrimi dhe menaxhimi i kësaj zone të rëndësishme dhe po aq të ndjeshme të parkut është një sfidë në vete dhe shumë e veçantë, meqë ka të bëjë me qasjen, organizimin dhe realizimin e detyrave të cilat bien nën përgjegjësinë e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”. Me qëllim të lehtësimit të punës më efikase të kësaj drejtorie si dhe zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen

me ruajtje, mbrojtje dhe avancim të vlerave natyrore e po ashtu edhe me planifikim, rregullim, udhëheqje dhe kontrollim të zhvillimeve në park, nga Qeveria e Kosovës pritet që paraprakisht të plotësohen kushtet bazike, si: rritja e numrit të stafit profesional e teknik, rritja e nivelit të pagës mujore për stafin zyrtar (dhe nëse ka të angazhuar në sezone), si dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve doracake të nevojshme për punë dhe dalje e siguri të stafit në terren, etj.

Së dyti, ekzistimi dhe funksionimi i disa subjekteve që merren me menaxhimin e resurseve të caktuara në park është shumë sfiduese e sidomos në aspektin e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre. Në rast të moskoordinimit të veprimtarisë së tyre, do të krijohet hapësira dhe mundësia për veprime degraduese apo arsyetime për mosveprime në dobi të parkut që lidhen me ndarjen e përgjegjësisë.

Shembulli i pyjeve: Aktualisht, përgjegjës për menaxhimin e pasurive pyjore të parkut, janë dy subjekte “me hise”, sikurse: a) Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” që është në kuadër të AMMK-së dhe pjesë e MMPHI-së dhe b) Agjencia Pyjeve në kuadër të MBPZHR-së që menaxhon me të gjitha pyjet e Kosovës. Këtu me të drejtë shtrohet pyetja: A është më mirë që parku të menaxhohet nga një apo më shumë subjekte?

Për më tepër, administrimi dhe menaxhimi i Parkut Kombëtar nga DAPKSH, në cilësinë e drejtuesit dhe të koordinatorit të veprimtarive të subjekteve tjera “me hise”, që mbikëqyrret vazhdimisht nga Qeveria e Kosovës duhet të bazohet në rregullore të brendshme për parqet kombëtare. Çështja e administrimit dhe menaxhimit të parkut kombëtar e bazuar në rregulloren e përbashkët, duhet të jetë më e lehtë, reale dhe më praktike. Andaj, edhe gjasat për parandalimin e konflikteve eventuale (mes subjekteve të lartë cekura) janë më të mëdha dhe asnjëra prej tyre nuk mund të fajësoj tjetrën për mosmbarëvajtje eventuale të punëve.

Së treti, administrimi dhe menaxhimi i parkut nga DAPKSH pa e përfshirë tërë territorin e tij dhe pavarësisht hises së komunave pjesëmarrëse në të, ka shkaktuar probleme, paqartësi dhe kaos të dukshëm në procedura e zhvillime të pakontrolluara nga drejtimi e menaxhimi i hapësirës komunale jashtë kësaj drejtorie.

Përfundimisht, administrimi dhe menaxhimi efikas dhe i suksesshëm i parkut është në varësi të zhvillimeve aktuale dhe të ardhshme në park, të cilat janë të kontrolluara e nën mbikëqyrje të DAPKSH, të bazuar në planin e menaxhimit dhe rregulloren e brendshme si dhe në përputhje të plotë me planet rregullues dhe me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Lista e çështjeve dhe problemeve të identifikuar

- Mos përfshirja e Parkut Kombëtar ‘Sharri’ në organizata, konventa dhe iniciativa ndërkombëtare (si: IUCN, WTO, RIO, etj.);
- Menaxhimi një palësh (Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”) në të gjithë territorin e parkut;
- Mungesa e investimeve publike për menaxhim më efikas të rreziqeve dhe të vet parkut;
- Përhapja e zhvillimeve kaotike në mungesë të planeve rregulluese;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve mes subjekteve që menaxhojnë me vlerat e parkut;
- (Ri)Hartimi i një Plani të ri Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”;
- (Ri)Hartimi i Planit për Menaxhim të Parkut Kombëtar “Sharri”
- (Ri)Hartimi rregullores së brendshme për administrimin dhe menaxhimin e parkut/qeve;
- Identifikimi i vlerave të larmisë biologjike (biodiversitetit) që janë të rrezikuara apo në zhdukje;
- Kufizimi i arealit me vlerave të identifikuar dhe përcaktimi i shkallës rigoroze të mbrojtjes tyre;
- Promovimi, publikimi dhe marketingu i vlerave specifike të hulumtuara, për nevoja shkencore, arsimore, edukative, rekreative dhe turistike në park;
- Krijimi i bazës së të dhënave për tërë atë që e posedon Parku Kombëtar “Sharri”;
- Inicimi i shpronësimit dhe ndërimi i titullarit të pronës në rast të zbatimit të zhvillimeve të nevojshme për parkun.

6.8.2. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, peizazhit, biodiversitetit dhe vlerave natyrore e kulturore të parkut

Çka është sfiduese?

Çështja e mjedisit është një ndër çështjet kryesore për shoqërinë tonë. Është shumë i rëndësishëm angazhimi në zbulimin e mistereve të jetës, tokës, ujit dhe ajrit që na rrethon. Poashtu duhet të bëhen gjithënjë e më të qarta pasojat e ndikimit të njerëzimit në mjedis, kur dihet se shumë aktivitete individuale apo kolektive që po ndodhin në hapësirën tonë jetësore, janë të pakontrolluara dhe nuk janë në harmoni me normat dhe standardet evropiane të mjedisit. Kjo dukuri, përveç tjerash, në vendin tonë paraqitet edhe si pasojë e mungesës së planeve hapësinore dhe të menaxhimit për zonat e caktuara, të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Parku Kombëtar "Sharri" ka një pozitë shumë të përshtatshme gjeografike, me reliev të llojlojshëm, male të larta, gryka, lumenj, peizazhe të bukur dhe kullosa, florë dhe faunë të pasur që së bashku paraqesin një vend atraktiv për tu zhvilluar dhe vizituar në të ardhmen. Sfidë e jona është se si mund ta shfrytëzojmë këtë pozitë dhe potencial natyror e kulturor në favor të bashkëpunimit në mes të komunave që janë pjesë e parkut dhe në mes të Kosovës e Maqedonisë së Veriut si dy shtete, në territoret e të cilëve përfshihet masivi malor i Sharrit?

Sfiduese në PK "Sharri" është si duhet të mbrohet parku nga degradimet antropogjene dhe natyrore, ndotja e ekosistemeve, me fjalë të tjera mundësia e shfrytëzimit të pasurive të parkut për zhvillimin e sotëm, duke mbajtur përgjegjësi për ardhmërinë e parkut edhe për gjeneratat e ardhshme.

Peizazhet - Parku është i pasur me peizazhe natyrore si ato hidrografike, malore, fshatare, kulturore etj. Mbrojtja e peizazheve të parkut paraqet një sfidë. Shkatërrimi i pyjeve dhe zhvillimet e pakontrolluara ia humbin vlerën dhe rëndësinë peizazheve, prandaj ato duhet të parandalohen. Në këtë aspekt element i rëndësishëm është krijimi i programeve ndërkufitare në mes të Kosovës e Maqedonisë së Veriut për identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazheve që i kalojnë kufijtë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Peizazhi luan një rol të rëndësishëm në rrafshin kulturor, ekologjik, mjedisor dhe shoqëror e poashtu është burim për veprimtaritë ekonomike, të cilat mundësojnë hapjen e vendeve të reja të punës.

Trashëgimia kulturore - Vendbanimet rreth PK "Sharri" janë të pasura me vlera të trashëgimisë kulturore e sidomos me shtëpi, lokalitete arkeologjike dhe objekte të kultit. Ruajtja, shfrytëzimi, promovimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i këtyre vlerave paraqet një sfidë të veçantë për zhvillimin e ardhshëm të parkut. Shumëllojshmëria e pasurisë me trashëgimi kulturore, etnografike, gastronomike dhe peisazhore paraqet potencial dhe mundëson zhvillimin e turizmit rural, eko-turizmit dhe turizmit kulturor, mundëson bashkëpunimin ndërkomunal në mes të komunave që janë pjesë e parkut si dhe bashkëpunimin ndërshtetëror, me harmonizimin e planeve të zhvillimit të turizmit për Malin Sharr, në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Me anë të ofrimit të bujtinave, ushqimit tradicional, shitjes së prodhimeve vendore dhe artizanale për turistë dhe vizitorë do të favorizohej zhvillimi ekonomik i parkut dhe më gjerë.

Prerja ilegale e pyjeve brenda parkut dhe zonës buferike në pronën shoqërore dhe atë private është dukuri aktuale në park. Ruajtja e resurseve pyjore ka rendësi të madhe për një zhvillim të qëndrueshëm i cili ndikon pozitivisht edhe në ruajtjen e botës shtazore.

Dëmtimi i biodiversitetit nënkupton reduktimin e numrit të llojeve bimore e shtazore. Ruajtja e biodiversitetit, e posaçërisht e llojeve endemike të bimëve është e nevojshme për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik. Keqpërdorimi i botës bimore dhe shtazore, llojeve të bimëve endemike dhe llojeve të shtazëve të egra që janë në park sjell deri te zvogëlimi i numrit të tyre e madje edhe deri tek humbja e

tyre që do të thotë humbja e vlerave natyrore. Ndërtimi i minihidrocentraleve në rrjedhjet ujore të parkut është njëri ndër aktivitetet më sfiduese ndaj biodiversitetit dhe mjedisit në përgjithësi. Ndërhyrjet e dëmshme në lumenj nga kjo veprimtari janë argumente të mjaftueshme që ndërtimi i minihidrocentraleve në park të mos lejohet në të ardhmën.

Fatkeqësitë natyrore që paraqiten në forma të ndryshme si: erozion, sëmundje të pyjeve, zjarre, ortiqe, rrëshqitje të dheut që shkaktohen nga faktorë natyror dhe antropogjen, rrezikojnë begatitë e krijuara dhe të planifikuara. Si mund të menaxhohen ato, cilat janë mundësitë? Cilat janë masat paraprake që do të ndikojnë në zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore?

Degradimi i mjedisit – Edhe pse nuk ka ndotje të madhe në park, kjo megjithatë ka filluar të ndodhë. Këtu nuk kemi zhvillim industrial dhe transport të dendur, si shkaktar më me ndikim negativ në mjedis prandaj cilësia e ajrit është e mirë, mirëpo, aktivitetet tjera si për shembull hedhja e mbeturinave, prerja e drunjve dhe gërryerja e sipërfaqeve për ndërtimin e objekteve ilegale turistike e hoteljere që janë prezentë në zonë, ndikojnë në ndotjen dhe degradimin e mjedisit. Menaxhimi eventual jo i mirë me parkun në të ardhmen dhe mungesa e kontrollit të zhvillimeve në të do të kishin për pasojë rritjen e degradimit. Tek zhvillimet e tilla do të hapeshin deponi të mbeturinave dhe ujërat e zeza do të derdheshin ashtu të patrajtuara dhe në mënyrë të pa kontrolluar.

Çfarë thonë konventat dhe direktivat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore?

Ekziston një varg politikash ndërkombëtare dhe konventash në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore që janë të aplikueshme për Parkun Kombëtar “Sharri”. Ato përfshijnë:

- Konceptet themelore të UNESCO-s thonë që secili send i trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unik dhe zhdukja e cilitdo send përbën një humbje definitive dhe varfërim të pakthyeshëm të trashëgimisë. Trashëgimia natyrore është pronë e përgjithshme që duhet të shfrytëzohet nga të gjithë dhe të mbrohet në mënyrë që t’i dorëzohet gjeneratave të ardhshme, ta shfrytëzojnë edhe ato.
- Unioni Botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës (shkurt në anglisht IUCN) ka bërë kategorizimin e zonave të mbrojtura të natyrës. Pas kategorisë së parë ku hyjnë rezervatet strikte natyrore vjen kategoria e dytë në të cilën janë parqet nacionale. Parku Kombëtar “Sharri” mbrohet me ligj dhe si i tillë zë një vend meritore në këtë familje.
- Në Samitin për Tokën, të mbajtur në vitin 1992 në Rio de Zhaneiro, liderët botëror u morën vesh për një strategji gjithëpërfshirëse për „zhvillimin e qëndrueshëm”. Njëra prej marrëveshjeve kryesore që kanë dalë nga Samiti ka qenë Konventa për Diversitetin Biologjik. Kjo konventë i obligon shtetet që e kanë ratifikuar atë që të nxjerrin ligje dhe akte të tjera juridike përmbajtësore për mbrojtjen e mjedisit dhe të aplikojnë sistematikisht përgjegjësinë ndaj shkatërruesve dhe përgjegjësve për mjedisin jetësor.
- Konventa Europiane për Peizazhin - Firenca 2000 ka për qëllim kryesor mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peisazheve në Europë. Ajo është pjesë e punës së Këshillit të Europës për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, planifikimin hapësinor, mjedisin dhe vetëqeverisjen vendore. Shqetësimi për zhvillim të qëndrueshëm, i shprehur në konferencën e Rio de Zhaneiros, e bën peizazhin element shumë të rëndësishëm në krijimin e një bilanci ndërmjet ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore si refleksion i identitetit dhe diversitetit evropian dhe përdorimit të saj si burim ekonomik i aftë të gjenerojë vende pune në kuadrin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.
- Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore të Europës - Granada 1985, ka për qëllim mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore e cila përbën shprehjen e pazëvendësueshme të pasurisë dhe diversitetit të trashëgimisë kulturore të Europës, është njëra nga dëshmitë e së kaluarës sonë dhe bartjes tek gjeneratat e ardhshme. Përveç kësaj konventa synon përmirësimin e mjedisit urban

dhe rural me përfshirjen e trashëgimisë në politikat e planifikimit urban dhe rregullimit të mjedisit që do të rezultojë me zhvillim ekonomik, social dhe kulturor të shteteve të Europës.

- Konventa e Espoos e vitit 1991 që ka hyrë në fuqi në vitin 1997 e që ka të bëjë me vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkuftar, i obligon shtetet që e kanë ratifikuar atë, që ta bëjnë këtë vlerësim për aktivitete të caktuara qysh në fazat e hershme të planifikimit. Shtetet duhet ta njoftojnë njëra tjetrën dhe të konsultohen nëse implementimi i ndonjë projekti do të mund të kishte ndikim të pafavorshëm në mjedisin e hapësirës ndërkuftare.
- Konventa e Lluganos e vitit 1993 për detyrimet civile për dëmet që rezultojnë nga aktivitetet e rrezikshme për mjedisin jetësor i obligon ratifikuesit e kësaj konvente për kompensimet që palët dëmtuese duhet t'ua bëjnë palëve të dëmtuara për dëmet në mjedisin jetësor e gjithashtu i obligon për sigurimin e mjeteve për mbrojtje dhe për kthimin në gjendjen e mëparshme.
- Direktiva e Këshillit të Evropës për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër e vitit 1992 i përcakton masat që duhet t'i ndërmarrin shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në mënyrë që të ruhen habitatet natyrore, flora dhe fauna e egër.
- Sipas koncepteve të UNESCO-s, konventave dhe standardeve të BE-së, zhdukja e llojeve bimore dhe shtazore si dhe prerjet ilegale të pyjeve janë humbje e trashëgimisë natyrore të parkut

Në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të një trashëgimie të pasur natyrore, autoritetet duhet të punojnë në rritjen e vetëdijes për vlerat saj.

Ligji për Planifikim Hapësinor përmban parimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe tani është koha që të gjitha parimet që përmban ky ligj, pastaj standardet, konventat dhe agjendat e ndryshme të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhim.

Zbatimi i ligjeve në fuqi dhe i konventave ndërkombëtare do të kontribuojë në zvogëlimin e problemeve mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore në Parkun Kombëtar "Sharri". Ligjet relevante me sfidën në fjalë e të cilat duhet të zbatohen janë:

- Ligji Nr. 03/L-025 2009 për Mbrojtjen e Mjedisit,
- Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës,
- Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri",
- Ligji për Pyje,
- Ligji për Mbrojtjen e Tokave Bujqësore,
- Ligji Nr.04/ L-147 për Ujërat e Kosovës,
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja,
- Ligji Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbturina,
- Ligji Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate,
- Ligji Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes,
- Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
- Ligji Nr. 03/L-104 2010 për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare,
- Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësive tjera,
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri,
- Ligji Nr. 08/L-074 për Turizmin,
- Ligji për Trashëgiminë Kulturore,
- Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Cilat janë mundësitë e identifikuarat?

Konteksti i ngushtë – Për mbrojtjen e mjedisit dhe të të gjitha vlerave të parkut do të duhej të ndërmerren hapa konkret si:

- Dhënja e përgjegjësisë për menaxhimin e parkut vetëm Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri";
- Hulumtimet për gjendjen aktuale të biodiversitetit, prerjeve ilegale, fatkeqësive, ndotjeve në park;
- Nënshkrimi i konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës;
- Zbatimi i legjislacionit relevant në park

Konteksti i gjerë - Parku dallohet me zona me vlera të veçanta natyrore, hidrografi, pyje, kullosa, livadhe dhe biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe më gjërë.

Zonat e ndjeshme natyrore dhe zonat tjera të vlefshme nuk mund të trajtohen në izolim, meqë ndikimi i këtyre zonave është më i gjërë. Përveç trendeve lokale nga komunat ku ka shtrirje parku dhe dinamikës rajonale (shtrirja e Malit Sharr edhe në shtetin fqinj, Maqedoninë e Veriut), ndryshimet globale në Ballkan dhe më gjërë, gjithashtu ndikojnë në mjedisin e hapur, si dhe menaxhimin e mbrojtjen natyrore, në veçanti në zonën a parkut.

Si do t'i qaset Kosova ndryshimeve globale me ndryshimin fiziko-gjeografik, biologjik etj. dhe si do të mund të ndihmojë në përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar këtë problem, është sfidë në kontekst më të gjërë?

Lista e çështjeve të identifikuara

- Mungesa e menaxhimit dhe koordinimit të masave dhe aktiviteteve në park;
- Degradimi i pyjeve;
- Rrezikimi i biodiversitetit;
- Fatkeqësitë natyrore (erozioni, ortiqet, zjarri, smundjet);
- Shfrytëzimi joracional i kullosave;
- Mungesa e inventarizimit të llojeve bimore dhe shtazore;
- Mungesa e publikimit të llojeve specifike natyrore;
- Gjetja dhe shfrytëzimi i masave hidroteknike, bujqësore dhe biologjike si mundësi
- Objektet me trashëgimi kulturore në afërsi të parkut;
- Prezenca e vendbanimeve rreth parkut

6.8.3. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik në parkun kombëtar

Përse është sfiduese dhe çfarë do të thotë?

Rregullimi dhe shfrytëzimi i parqeve kombëtare brenda një shteti ofron mundësi për përfitime ekonomike. Territori i Maleve të Sharrit si tërësi gjeografike karakterizohet me vlera dhe llojllojshmëri peizazhore me rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike që janë potencial për zhvillim ekonomik.

Si mund të ruhen dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale resurset natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik, duke pasur parasysh se në një masë janë evidente: prerja e pakontrolluar e pyjeve, ndërtimi i paplanifikuar, shfrytëzimi i pakontrolluar i peizazheve për aspekte komerciale, që kanë pasoja në degradimin e mjedisit dhe në zhvillimin e ardhshëm të parkut?

Çështjet praktike dhe teknike që janë sfiduese për përdorimin e Parkut Kombëtar "Sharri" janë:

- Ngritja e njohurive të përgjithshme për vlerat natyrore dhe kulturore të PK "Sharri", për mundësitë e përfitimit ekonomik;
- Parandalimi i ndikimeve të dëmshme në parkun kombëtar;
- Shfrytëzimi i kullosave, bimëve mjekuese aromatike si dhe pemëve frutore të egra në harmoni me ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe ligjeve përkatëse;
- Zhvillimi i ekoturizmit dhe bujqësisë tradicionale të cilat nuk janë në kundërshtim me mbrojtjen e natyrës por kërkojnë një menaxhimi aktiv;

- Planifikimi i zhvillimeve në park: ndërtimi, rindërtimi dhe mbrojtja e objekteve tradicionale si dhe zhvillimi i turizmit;
- Ngritja e ofertës turistike në dobi të zhvillimit ekonomik;
- Përgatitja e programeve të përshtatshme për grupet e ndryshme të vizitorëve;
- Përgatitja e programeve për aktivitete rekreative, hulumtuese shkencore;
- Bashkëpunimi ndërkomunal, ndërkufitar dhe ndërkombëtar lidhur me zhvillimin e parkut;
- Njohja e PK “Sharri” në WTTC-Këshillin botëror për turizëm (sikurse që është rasti me projektin “Majat e Ballkanit” - të organizuar nga komuna e Pejës;
- Konkurrimi i Kosovës me resurset e veta natyrore në turizëm në rajon dhe më gjerë;

Cilat janë mundësitë e identifikuar?

Konteksti i ngushtë – PK “Sharri” mund të jetë i vetëqëndrueshëm financiarisht, përderisa të hyrat mund të përdoren për mbrojtje dhe zhvillim të tij. Komunat përreth parkut mund të përfitojnë nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe mund të investojnë bashkërisht në ngritjen e ofertës turistike që do të rezultonte me rritje ekonomike të banorëve brenda dhe jashtë parkut.

Është e nevojshme mbështetja (financiare, institucionale, morale, edukative) për ruajtjen e origjinalitetit të traditave lokale, arkitekturës, mënyrës së jetesës, gatimit, ushqimit, sepse këto ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e kapaciteteve të turizmit rural, eko-turizmit dhe mundësi për përfitime ekonomike të krijuara nga vizitorët të cilët i kanë për destinacion këto vende.

Stimulimi i banorëve për shfrytëzimin e kullosave për kultivimin e blegtorisë, për mbledhjen e bimëve mjekuese aromatike dhe frutave të imta si prodhime me shenjë identifikuese të parkut, mundëson përfitim ekonomik të tyre nga plasimi i prodhimeve në tregun vendor dhe më gjerë.

Konteksti i gjerë – Ndikimi ekonomik i Parkut Kombëtar “Sharri” në ekonominë e Kosovës mund të vlerësohet me të hyrat në BPV-në e Kosovës si dhe me gjenerimin e punësimit. Punësimi do të mund të kategorizohet si: i) punësim direkt në park; ii) indirekt në park dhe iii) indirekt jashtë parkut.

Parku ofron punësim të vogël direkt, mirëpo ndikimi i tij në punësimin indirekt brenda dhe jashtë kufijve të tij është i madh. Shembuj specifik janë prodhimet vendore dhe mikpritja tradicionale e cila rritë ofertën turistike.

Vlerat e parqeve kombëtare duhet të mbrohen dhe të ruhen, andaj aktivitetet e turizmit dhe aktivitetet tjera duhet të jenë të atilla që nuk i dëmtojnë këto vlera. Aktivitetet e varura nga kualiteti i mjedisit siç është turizmi dhe rekreacioni, janë shfrytëzues intensiv të mjedisit dhe si të tillë nuk bën ta dëmtojnë mjedisin prej të cilit varen. Punësimi brenda dhe përreth parkut kombëtar, perspektivën e ka në turizëm dhe bujqësi.

Me rregullimin e parkut do të duhej të tentohet të arrihet ajo që në mënyrë sa më të organizuar dhe të menaxhuar të ofrohet qarkullimi i sa më shumë vizitorëve, me qëndrim sa më të shkurtër, bazuar në qëllimet e planifikimit hapësinor të parkut, duke mundësuar vizita të shumta, gjithnjë në pajtim me rregullat e aplikueshme për zonat e ndryshme të mbrojtjes në kuadër të parkut dhe me synimin e përhershëm për ruajtjen e vlerave të parkut. Parqet kombëtare nuk duhet të jenë pjesë e industrisë turistike, por mund të jenë pjesë kualitative e ofertës turistike. Parqet kombëtare dhe parqet natyrore janë hapësira të vlerave dhe potencialeve të larta brenda një shteti, prandaj nuk duhet trajtuar si pjesë të zhvillimit të nivelit lokal.

Oferta turistike mund të rritet nëse zhvillimet janë të planifikuara duke e ditur se:

- Parqet kombëtare janë ikona të turizmit brenda dhe jashtë kufijve shtetëror.
- Parku krijon imazhin apo shenjë identifikuese kombëtare.
- Përfitimi ekonomik është më i madh jashtë parkut.
- Parku mbështetë jo vetëm ekonominë lokale por të Kosovës në tërësi.

Mundësitë që, ato që u thanë në pikat më lartë të jetësohen, do të rriteshin nëse parku do të njihej nga organizma ndërkombëtarë për arsye të mbrojtjes së vlerave të parkut dhe njohja pastaj do të krijonte mundësi për mbështetje financiare nga po të njëjtit organizma financiarë. Joshja e tregut më të gjerë me një frymë më konkurruese në turizmin botëror është një sfidë dhe kjo mund të arrihet përmes ofertës më të specializuar si: turizmi malor dimëror dhe veror, ekoturizmi, turizmi rural, turizmi kulturor, turizmi shëndetësor, turizmi për mirëqenie, turizmi aventurier, etj.

Lista e çështjeve të identifikuar:

- Arritja e standardeve evropiane për turizëm;
- Kapacitetet e pamjaftueshme në krahasim me kërkesat e turistëve/Ngritja e ofertës turistike;
- Kthimi i banorëve në traditat lokale;
- Konkurrimi i Kosovës me resurset e veta natyrore për ofertë turistike, në raport me rajonin;
- Bashkëpunimi në mes të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në funksion të ruajtjes dhe zhvillimeve të planifikuara në hapësirën gjeografike të Maleve të Sharrit;

6.8.4. Rigjallërimi i aktiviteteve tradicionale në vendbanimet rreth parkut dhe ruajtja e traditës si faktorë ndikues në ndaljen apo zvogëlimin e migrimit

Rreth pakut ekziston një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve të cilat me shtrirjen, funksionimin, organizimin e jetës në përgjithësi dhe peizazhin e bukur, japin shumë mundësi të favorshme për zhvillimin e turizmit në përgjithësi e në veçanti të turizmit rural. Këto vendbanime gjenden kryesisht në kodra të larta dhe të rrethuara me peizazhe të bukur natyror. Ato kanë një kulturë të veçantë, veshje dhe manifestime, të cilat janë mjaftë joshëse për turistët vendor dhe të huaj. Ky rajon njihet edhe për veshje karakteristike, këngë dhe valle të veçanta të cilat me endje do të duhej t'i ruajmë dhe kultivojmë. Këtë kulturë, brez pas brezi e kanë trashëguar gjenerata të tëra, por tendencat janë që këto tradita të zëvendësohen me zhvillime bashkëkohore duke bërë që, traditat apo kultura e lashtë e kësaj anë t'i takoj së kaluarës. Kjo është një çështje mjaftë sfiduese për të cilën do të duhej që institucionet vendore dhe shoqëria në përgjithësi të mendojnë dhe të bëjnë përpjekje për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore të kësaj ane.

Ruajtja dhe kultivimi i traditave të sipërpërmendura, kanë efekt pozitiv në zhvillimin e parkut dhe anasjelltas. Bashkimi i vlerave kulturore dhe atyre natyrore të cilat ka kjo anë, janë atraktive për turistët, andaj, do të duhej të bëhej gjithçka që është e mundur nga akterët e ndryshëm që asnjëra vlerë e lartpërmendur të mos e lerë vetëm tjetrën. Kombinimi i këtyre të dyjave, pa dyshim do të ketë ndikim reciprok pozitiv për parkun dhe përfitimet për komunitetin lokal dhe institucionet vendore do të shumëfishoheshin.

Karakteristikë tjetër e këtyre vendbanimeve është kultura tradicionale e ndërtimit të shtëpive dhe organizimi i jetës familjare. Në kohën e sotme, ndërtimi i shtëpive tradicionale është zëvendësuar me ndërtimin e shtëpive moderne, të cilat nuk e kanë ruajtur asnjë tipar arkitektonik të shtëpive tradicionale. Është e kuptueshme që shtëpitë që ndërtohen sot të jenë moderne dhe më të avancuara duke iu përgjigjur kërkesave të kohës, por kjo nuk do të thotë që ato nuk mund apo nuk duhet t'i kenë edhe disa tipare arkitektonike që janë karakteristike për trevën. Këto tipare vetëm sa do ta ruanin dhe pasuronin identitetin e kësaj treve sa i përket arkitekturës.

Kjo anë gjithashtu njihet edhe me zhvillimin e degëve ekonomike siç janë blegtoaria, bletaria, pemëtaria, mbledhja e frutave natyror etj. Të gjitha këto degë ekonomike dikur ishin mjaft profitabile nga të cilat familje të shumta fshatare arrinin të siguronin mirëqenien familjare. Për këto veprimtari ekonomike, në dekadën e fundit, komuniteti lokal ka shfaqur mos interesim të theksuar për arsye të ndryshme duke bërë që shumë nga familjet të heqin dorë nga to. Dikur, para vitit 1999, në këto vendbanime

rurale dhe bjeshkë të larta frekuentonte një numër i madh i blegtorëve, me kope të shumta, të cilët me prodhimet e tyre, përveç përfitimit ekonomik ishin edhe atraktiv për turistët e shumtë.

Marrja me bujqësi e veçanërisht me blegtori dhe sigurimi i të ardhurave familjare nga këto të fundit, aktualisht është një sfidë e madhe sepse interesimi ka rënë në masë të madhe krahasuar me periudhat e mëhershme. Këtë e dëshmon më së miri migrimi i popullsisë nga viset rurale drejt viseve urbane dhe lënia bosh e shumë shtëpive dhe vendbanimeve rurale të asaj ane. Sot, migrimet fshat-qtet janë shëndrruar në përditshmëri ku secilit që i jepet mundësia e bënë atë, duke boshatisur kështu vendbanimin rural ku kanë jetuar gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre. Thuajse të gjitha strukturat e popullsisë në dekadën e fundit janë përfshirë në migrim, e më së shumti bëjnë pjesë gjeneratat e reja. Motivet e migrameve të popullsisë fshat-qtet janë të shumta dhe të ndryshme sa që vështirë të thuash se është ky apo ai motivi parësor, mirëpo kryesisht motivet ndërlidhen me kërkimin e një jete më të mirë. Në anën tjetër, mospërkushtimi i institucioneve vendore për t'i përkrahur në nivelin e dëshiruar, qoftë përmes krijimit të infrastrukturës adekuate, qoftë përmes subvencionimit ka bërë që njerëzit të heqin dorë nga punësimi, nga marrja me degët ekonomike të sipërpërmendura dhe që të migrojnë drejt qyteteve. Rikthimi i interesimit të komunitetit lokal për tu marrë me veprimtaritë bujqësore e blegtorale në vendet e tyre, gjë që do të rezultonte me heqjen apo zbutjen e varfërisë e kështu edhe me ndalimin apo zvogëlimin e boshatisjes së vendlindjes, paraqet një sfidë të madhe për institucionet e Kosovës.

Mungesa e infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore në disa vendbanime të thella kodrinore – malore të kësaj ane, gjithashtu paraqet një rrezik permanent për shpërnguljen e popullsisë dhe në këtë drejtim, në të ardhmen është e nevojshme të bëhen zgjidhje adekuate në mënyrë që kjo mos të ndodhë, të paktën jo në masë të madhe.

Veprimtaritë ekonomike të lartcekura por edhe të tjera, do t'i punësonin pjesëtarët e komunitetit lokal, të cilët pastaj, në njërën anë do të gjeneronin të ardhura nga shitja e produkteve të tyre në treg e në anën tjetër, përmes sigurimit të bujtinave e shujtave tradicionale, nga bereqeti vendor dhe i dorës së parë, do t'i bënin vendbanimet e tyre joshëse për shumë turistë të huaj dhe vendor, me ardhjen e të cilëve do të krijohet një burim tjetër i të ardhurave. Me këto të ardhura, pjesëtarët e komunitetit lokal do ta siguronin një jetë të rehatshme e larg skamjes, kurse vendbanimet e tyre që janë në kufi me parkun kombëtar, me atraktivitetin e tyre në rritje do ta bënin edhe vet parkun më atraktiv për turistët.

Çështjet që duhet adresuar janë:

- Mbështetja e duhur institucionale me qëllim të rikthimit të interesimit të komunitetit lokal për tu marrë me veprimtaritë bujqësore e blegtorale në vendet e tyre dhe për të organizuar ngjarje kulturore;
- Sigurimi i tregut për plasimin e produkteve bujqësore;
- Përkrahja e bujkut në raste të dëmtimit nga fatkeqësitë natyrore apo të tjera

6.8.5. Zhvillimi i infrastrukturës në park

Funksionimi i parkut në masë të madhe varet nga ekzistenca e infrastrukturës së duhur në të. Për këtë arsye, në park duhet të sigurohet infrastruktura e nevojshme sepse ajo e bën të mundshme lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura, komunikimin midis njerëzve, menaxhimin e mbeturinave etj.

Parku Kombëtar “Sharri” ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit, por ai nuk mund të zhvillohet pa u zhvilluar paraprakisht infrastruktura e duhur, e cila është bazë për çdo lloj zhvillimi ekonomik. Aktualisht infrastruktura nuk është në nivelin që do ta mundësonte zhvillimin e dëshiruar të turizmit, por edhe plotësimin e nevojave të banorëve brenda parkut, prandaj shtrohet nevoja që të investohet

në zhvillimin e saj. Këtë e mbështetë fakti se aktualisht infrastruktura që mbështetë zhvillimin e sportit të skijimit në park është në nivel jo të duhur të zhvillimit dhe nuk i kënaq kërkesat e adhuruesve të skijimit. Numri i ski liftave dhe i teleferikëve nuk i përmbushë nevojat për to. Qasja rrugore në territorin e parkut nuk është adekuate nga të gjitha komunat, në territoret e të cilave shtrihet parku. Në park nuk ka mjaftueshëm shtigje për ecje dhe gjendja e tyre nuk është shumë e mirë. Infrastruktura e largimit të ujërave të zeza nuk është në nivelin e kënaqshëm, kurse ajo e trajtimit të këtyre ujërave është inekzistente. Brenda parkut nuk ka rrjet të telefonisë fikse e në disa hapësira nuk ka as sinjal të telefonisë mobile GSM.

Meqenëse parku ka vlera të larta natyrore, ruajtja e këtyre vlerave del si nevojë dhe objektiv për të ardhmen. Në mënyrë që këto vlera të ruhen, çdo zhvillim këtu, pra edhe ai i infrastrukturës duhet të bëhet sipas planit, sepse zhvillimet e pabazuara në plan do t'i devalvonin vlerat natyrore.

Të gjitha mangësitë e lartpërmendura në infrastrukturë, natyrisht që duhet të eliminohen. Çka duhet të bëhet fillimisht? Cilat janë prioritetet investuese në infrastrukturën rrugore, infrastrukturën energjetike, infrastrukturën ujore, në telekomunikacion dhe si të sigurohen mjetet financiare? Si të arrihet zhvillimi i infrastrukturës sipas planit dhe eliminimi i mangësive? Të gjitha këto paraqesin një sfidë, aq më parë që në Kosovë, në periudhën pas vitit 1999 ka pasur shumë zhvillime hapësinore të pabazuara në plane, sepse autoritetet përgjegjës nuk kanë pasur mundësi por edhe vullnet që t'i ndalojnë e në anën tjetër dihet se infrastruktura zhvillohet me investime, kurse Kosova sipas standardeve evropiane ende është shtet i varfër me mundësi të kufizuara për investime.

7. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

7.1. DEKLARATA E VIZIONIT

Parku Kombëtar "Sharri"- një park që administrohet dhe menaxhohet duke i përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe kërkesat e planeve hapësinore e menaxhuese. Park i njohur gjithandej, i pranuar në organizatat ndërkombëtare dhe pjesë e listave botërore të zonave të mbrojtura, të gjitha këto falë bashkëpunimit aktiv të institucioneve që e administrojnë dhe e menaxhojnë atë me institucione e organizata vendore e të huaja.

Parku - shembull i mirë për mjedisin e pastër, ekosistemet dhe biodiversitetin e padëmtuar, si dhe peizazhet e bukur. Një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm që nënkupton shfrytëzimin racional të vlerave të parkut dhe mundëson rritjen e mirëqenjes së komunitetit. Park me një balanc të arritur në mes të ruajtjes së natyrës, në njërën anë dhe zhvillimit ekonomik, në anën tjetër me ndikim pozitiv të ndërsjellë.

Park me infrastrukturë që e mundëson qasjen e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, i siguron të gjitha shërbimet e nevojshme publike për banorët, ofron informacione dhe udhëzime për vizitorët, si dhe e bën të mundshëm zhvillimin në çdo kohë të aktiviteteve rekreative, sportive, kulturore dhe hulumtuese-shkencore.

7.2. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM DHE MBROJTJE

Sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, planifikimi hapësinor dhe rregullimi duhet të bazohen në parimet e mëposhtme:

- Promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillim të qëndrueshëm;
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;

- Promovimin e kornizës themelore, transparente dhe të planifikuar të shfrytëzimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtave pronësore;
- Promovimin e mundësive të barabarta të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Kosovës;
- Promovimin e cilësisë së lartë të jetesës dhe sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve;
- Promovimin e planifikimit hapësinor të integruar përmes ecurive efikase;
- Promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm bazuar në nevojat publike dhe ekonomike;
- Promovimin e vazhdueshëm të harmonizimit me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe me parimet Evropiane për zhvillim hapësinor;
- Zhvillim të qëndrueshëm dhe proporcional të komunitetit, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase fondet publike;
- Parimet ndërkombëtare të planifikimit hapësinor, zhvillim të qëndrueshëm, dhe qeverisje në harmoni me normat e BE-së.

7.3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi – Park me administrim të mirë, menaxhim efikas dhe bashkëpunim të frytshëm

Objektivat:

1. Hartimi i planit të menaxhimit për parkun dhe zbatimi i tij duke i përmbushur të gjitha kërkesat që dalin nga ky plan, 2025;
2. Rikthimi i kompetencave të plota tek Drejtoria për Administrimin e PK “Sharri”, 2026;
3. Ngritja e kapaciteteve humane dhe teknike / teknologjike në DAPKSH, 2026;
4. Bashkëpunimi me subjektet relevant vendor dhe ndërkombëtar dhe lidhja e marrëveshjeve me vendet fqinje dhe më gjërë, 2034;
5. Promovimi i parkut përmes aktiviteteve të ndryshme dhe njohja ndërkombëtare e tij

Qëllimi – Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të natyrës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe shfrytëzimi racional i pasurive natyrore

Objektivat:

1. Mbrojtja dhe monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja dhe degradimi, si dhe monitorimi i elementeve meteorologjike dhe ujrave sipërfaqësor;
2. Mbrojtja nga aktivitetet ilegale: prerja ilegale e pyjeve, mbikullotja, shfrytëzimi pa kontrollë i bimëve mjekësore dhe i frutave, gjuetia ilegale;
3. Zhvillimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit të popullatës për ta nxitur atë të mësojë më shumë rreth biodiversitetit dhe rëndësisë së kujdesit ndaj tij;
4. Mbrojtja dhe ruajtja e rezervateve të natyrës, si dhe promovimi i tyre shkencor
5. Mbrojtja dhe ruajtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit në përgjithësi dhe e llojeve endemike, relikte dhe endemorelikte të bimëve, shtazëve dhe shpezëve në veçanti;
6. Shfrytëzimi i pasurive natyrore sipas planit të menaxhimit: prerjet sanitare të pyjeve dhe për ngrohje, vjelja e bimëve mjekësore dhe frutave, shfrytëzimi i kullosave dhe pejzazheve natyrore për rekreacion;
7. Inventarizimi i specieve të rrezikuara të botës bimore dhe shtazore, si dhe zhvillimi i programeve të monitorimit dhe hulumtimit;
8. Mbrojtja, promovimi, mbarshtrimi dhe rritja e Qenit të Sharrit (Deltari Ilir) si simbol i Parkut Kombëtar “Sharri”;
9. Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera;

10. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Qëllimi – Park me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik

Objektivat:

1. Ngritja e kapaciteteve turistike dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese, deri në vitin 2035;
2. Zhvillimi i bujqësisë tradicionale, blegtorisë dhe bletarisë në funksion të zhvillimit të ekoturizmit nga banorët lokal, deri më 2035;
3. Shfrytëzimi i kontrolluar i bimëve mjekuese dhe aromatike (BMA) dhe pemëve frutore të egra (PFE) për përfitime ekonomike;
4. Krijimi i kushteve që banorët lokal të punësohen në industrinë turistike, deri më 2030;
5. Zhvillime të planifikuara me banim cilësor (vikend shtëpi) dhe ndërtime të kontrolluara, që janë në harmoni me mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit
6. Shërbime shëndetësore të kualitetit të lartë;
7. Sigurimi i burimeve financiare dhe teknike nga organizatat ndërkombëtare dhe partnerët rajonal për të ndihmuar në zhvillimin dhe menaxhimin e parkut kombëtar

Qëllimi – Park në të cilin janë të siguruara qasja e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, si dhe shërbimet publike për banorët

Objektivat:

1. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe përmirësimi i transportit publik, 2035;
2. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së energjisë elektrike, 2030;
3. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës ujore, 2035;
4. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së telekomunikacionit, 2028;
5. Sigurimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i mbeturinave, 2028;

7.4. PRIORITETET STRATEGJIKE

1. Mbrojtja dhe monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja dhe degradimi, si dhe monitorimi i elementeve meteorologjike dhe ujrave sipërfaqësor;
2. Mbrojtja nga aktivitetet ilegale: prerja ilegale e pyjeve, mbikullotja, shfrytëzimi pa kontrollë i bimëve mjekësore dhe i frutave, gjuetia ilegale;
3. Mbrojtja dhe ruajtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit në përgjithësi dhe e llojeve endemike, relikte dhe endemorelikte të bimëve, shtazëve dhe shpezëve në veçanti;
4. Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera;
5. Zhvillimi i bujqësisë tradicionale, blegtorisë dhe bletarisë në funksion të zhvillimit të agroturizmit nga banorët lokal;
6. Ngritja e kapaciteteve turistike dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese;
7. Trajtimi i ndërtimeve jashtë zonave të zhvillimit dhe i ndërtimeve pa leje;
8. Ngritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor;
9. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës ujore;

8. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”. Ajo tekstualisht dhe me hartë e tregon shpërndarjen e ardhshme, të dëshiruar të zhvillimeve të ndryshme të lejuara dhe të nevojshme në hapësirën, territorin e parkut. Me këtë plan hapësinor, shpërndarja e dëshiruar e zhvillimeve hapësinore është bërë mbi bazën e disa qëllimeve të cilat përmbledhen në dy qëllime bazike, për arritjen e të cilave hartohet dhe zbatohet plani në fjalë. Kjo do të thotë se korniza e zhvillimeve në hapësirë është ndërtuar ashtu që ta bëjë të mundur arritjen e këtyre qëllimeve. Qëllimet janë: ruajtja e paprekshmërisë së natyrës me vlerat që ajo i ka dhe zhvillimi

ekonomik i parkut. Në vazhdim koncepti i zhvillimit hapësinor tregon se si do të duket kjo shpërndarje e zhvillimeve të dëshiruara hapësinore në park.

8.1. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti i zhvillimit hapësinor konsiston në ndarjen e territorit të parkut në tri zona, siq e kërkon Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri”. Sipas ligjit në fjalë, territori brenda kufirit të Parkut Kombëtar “Sharri” ndahet në tri zona sipas regjimit të mbrojtjes: zona e parë – mbrojtja strikte, zona e dytë – menaxhimi aktiv dhe zona e tretë – shfrytëzimi i qëndrueshëm. Jashtë parkut, në hapësirën prej 50 metrash nga kufiri i parkut caktohet zona e ndikimit – bafer zona.

Zona e parë – Zona përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Sharri” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte që do të thotë se këtu, veprimet e vetme që lejohen janë vizitat me karakter hulumtues shkencor dhe shëtitjet për rekreacion, gjithënjë nën përcjelljen e autoriteteve të parkut.

Zona e dytë – Kjo zonë përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Sharri” që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes.

Zona e tretë – Zona e tretë apo zona e shfrytëzimit të qëndrueshëm përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Sharri” ku mund të bëhet: ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e parkut kombëtar si dhe shfrytëzim të kullosave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Zona e ndikimit – Kjo zonë përfshinë hapësirën prej pesëdhjetë (50) metrash nga kufiri i Parkut Kombëtar “Sharri” që shërben për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në park.

8.1.1. ZHVILLIMET E ARDHSHEME HAPËSINORE NË ZONAT E PARKUT

Në zonat I, II dhe III të Parkut Kombëtar “Sharri” zbatohet regjim i ndryshëm i mbrojtjes, duke filluar nga regjimi më rigoroz i mbrojtjes për zonën I deri tek ai më liberali që zbatohet për zonën III. Identifikimi dhe definimi i kufinjve të zonave I, II dhe III është bërë përmes ekspeditave hulumtuese në terren duke u bazuar në vlerat natyrore me ç’rast janë përdorur kriteret si:

- Biodiversiteti i vlerave natyrore (florës, faunës, ekosistemeve, habitateve etj.);
- Karakteri endemo-relikt i vlerave natyrore;
- Rrezikshmëria e vlerave natyrore;
- Vlerat biogjeografike, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peisazhore;
- Kufiri natyror dhe fizik i zonave (luginat, kurrizet malore, përrockat dhe lumenjt, kufiri i vegjetacionit pyjor, shkëmbinjtë, rrugët etj.)

Ndihmë e konsiderueshme në definimin e kufinjve të zonave ka qenë përdorimi i dokumentacionit hartografik të kohës së fundit.

ZONA E PARË

Me ndryshimet që i ka bërë ky plan hapësinor në raport me planin e mëparshëm hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”, tani zonën e parë apo zonën e mbrojtjes strikte e përbëjnë 14 rezervate të natyrës dhe jo 15 siq kanë qenë, sepse rezervati i quajtur Lëndina e Shenjtë është hequr. Këta së bashku kanë një sipërfaqe prej 8745.60 hektarësh apo 16.42 % të sipërfaqes së tërësishme të parkut që flasin për një zvogëlim të zonës së parë, sipërfaqja e së cilës i ka patur 9363.51 ha apo 17.5 % të territorit të parkut. Dy nga këta rezervate, Rusenica dhe Pashallarë janë bashkuar në një, kurse rezervatit të

Shutmanit i është zvogëluar pak sipërfaqja dhe tani i ka 4399.39 hektarë. Ky ndryshim është bërë pas hulumtimit dhe gjetjeve në terren, të realizuara nga një grup i ekspertëve gjatë procesit të hartimit të planit hapësinor të parkut. Zona e parë paraqitet me vlera të veçanta natyrore të cilat karakterizohen me biodiversitet të pasur të florës, faunës, habitateve dhe të ekosistemeve. Ajo në përbërjen e saj karakterizohet me ekosistemet me potenciale autentike të pandryshuara ose pak të ndryshuara si rezultat i praktikave tradicionale të menaxhimit. Zona e parë poashtu karakterizohet me dendësi të lartë të llojeve tipike, të rralla dhe endemike të bimësisë, me dendësi të lartë të bimëve që janë vënë nën mbrojtje, me shkëmbinj të veçantë dhe është zonë me rëndësi të madhe për linjat e migrimit të dhive të egra, arinjve dhe rrëqebujve. Këtu, jeta e lirshme e habitateve të botës bimore (flora me speciet pyjore, barishtore, etj) dhe shtazore (fauna me speciet e sisorëve, rrëshqitësve, shpezëve, etj), duhet të zhvillohet në kushte krejtësisht natyrore. Rezervatet e natyrës që e përbëjnë këtë zonë janë nën mbrojtje strikte që do të thotë se mund të shfrytëzohen vetëm për nevojat shkencore dhe arsimore.

ZONA E DYTË

Si zonë e dytë në territorin e PK “Sharri” është caktuar sipërfaqja prej 43721.73 ha që përbën 82.07 % të sipërfaqes së parkut kombëtar. Sipas planit të mëparshëm hapësinor, zona e dytë e ka patur një sipërfaqe prej 40311.9 ha apo 75.4% të sipërfaqes së parkut. Pjesë e konsiderueshme e cila i takon zonës së dytë mbulohet me pyje dhe kullosa. Kullosat janë të përhapura mbi vegjetacionin barishtor ku mbizotëron klima e maleve të larta (alpine dhe subalpine).

Zona e dytë është me sipërfaqe më të madhe në krahasim me dy zonat e tjera dhe karakterizohet me ekosisteme pyjore dhe barishtore. Në këtë zonë janë të pranishme llojet e rralla e të rrezikuara si dhe endemike të florës, faunës, por në krahasim me zonën e parë, prania e tyre është më e kufizuar. Kjo zonë, përveq biodiversitetit të pasur natyror, posedon edhe vlera të rëndësishme biogeografike, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, pedologjike dhe peizazhore.

Zona e dytë është zonë me mbrojtje të orientuar, më pak rigoroze se sa në zonën e parë dhe ku njeriu mund të intervenojë, por në mënyrë të kontrolluar. Zona është e dedikuar për pushim aktiv dhe rekreacion të popullsisë. Aktivitetet e lejuara në këtë zonë janë:

1. Aktivitetet bujqësore në tokat private si: kultivimi i drithërave dhe kulturave të tjera bujqësore, por me norma të caktuara të përdorimit të pesticideve, herbicideve dhe plehrave azotike;
2. Prerja e pyjeve për qëllime sanitare, për plotësimin e nevojave të banorëve rezident për ngrohje dhe për evitimin e shpërndarjes së zjarreve;
3. Ripyllëzimi në hapësira që shërbejnë si mbrojtës dhe rregullues të dëmtimeve mjedisore pa ndikim në pyjet ekzistuese;
4. Aktivitetet për një blegtori ekstenzive, mbajtja e lopëve, deleve dhe kuajve, kullotja e kontrolluar e tyre;
5. Bletaria;
6. Vjelja e frutave të imta dhe bimëve mjekuese në periudha të caktuara kohore gjatë vitit;
7. Kultivimi i frutave, por jo i frutave dhe bimëve komplementare që u bëjnë konkurrencë frutave ekzistues;
8. Ndërtimi i shtigjeve të skijimit në vendet ku nuk dëmtohen ose ku shumë pak dëmtohen pyjet, ndërtimi i shtigjeve për shetitje me punkte për çlodhjen e vizitorëve;
9. Instalimi i ski liftave, teleferikëve dhe shtyllave për shpërndarjen e energjisë elektrike;
10. Aktivitetet rekreative sportive si shetitja, ngasja e biçikletës, skijimi, etj;
11. Ndërtimi i rrugëve që lidhin territoret të cilët i përkasin zonës së tretë;
12. Nuk lejohet transportimi i derivateve dhe materieve të tjera të dëmshme;
13. Shfrytëzimi i resurseve ujore të rrjedhshme që ndodhen deri në lartësinë prej 2.000 metrash me qëllim të furnizimit të banorëve me ujë;

14. Shfrytëzimi i resurseve ujore me qëllim të furnizimit të banorëve me ujë përmes puseve duke e ndërtuar infrastrukturën e tyre përcjellëse;
15. Për nevoja të blegtorisë dhe rasteve emërgjente lejohet formimi i akumulacioneve ujore të përmasave të vogla;
16. Me leje të autoriteteve përgjegjëse mundësohet hulumtimi i resurseve minerare, ndërsa nuk lejohet operimi i minierave sipërfaqësore si guroret dhe i atyre nëntokësore, apo xeheroret;
17. Me leje të veçantë mund të ndërtohen spitale me karakter specifik siç janë spitalet për sëmundjet kardiovaskulare, të mushkërive etj.

Përveç ndërtimeve që u përmendën më lartë, ndërtime tjera nuk lejohen në këtë zonë. Aktivitetet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pasurive të natyrës në zonën e dytë, më hollësisht rregullohen me planin e menaxhimit të parkut kombëtar.

Një hapësirë të caktuar të zonës së dytë mund t'i ndryshohet kategoria e të bëhet pjesë e zonës së tretë vetëm në rastet kur kërkohet zbatimi i ndonjë projekti me interes të veçantë për Qeverinë e Kosovës. Vendimi për ndryshimin e kategorisë dhe për sipërfaqen e nevojshme për zhvillimin e projektit propozohet nga qeveria dhe aprovohet nga Kuvendi i Kosovës, përkatësisht autoriteti përgjegjës i emëruar nga kuvendi. Ndryshimi eventual automatikisht duhet të bëhet pjesë e hartës së zonimit në dokument.

ZONA E TRETË

Zona e tretë i përfshinë të gjitha sipërfaqet barishtore dhe gurore të cilat nuk kanë vlera të veçanta të biodiversitetit as vlera të veçanta kulturore-historike. Sipas planit hapësinor të mëparshëm, kjo zonë përfshinte një sipërfaqe prej 3769.81 ha apo 7.1% të sipërfaqes së parkut. Pas verifikimit në terren, shikimit të dokumentacionit hartografik dhe konsultimeve të gjëra, grupi punues, i caktuar për rishikimin e zonës së tretë gjatë procesit të hartimit të planit hapësinor konstatoj se në zonën e tretë ishin përfshirë edhe disa sipërfaqe me vlera të veçanta të natyrës, të cilat në fakt do të duhej të ishin pjesë të zonës së dytë. Për këtë arsye, me këtë plan hapësinor këto sipërfaqe janë hequr nga zona e tretë dhe janë bërë pjesë e zonës së dytë. Tani zona e tretë në territorin e PK "Sharri" përfshinë sipërfaqen prej 803.81 ha që përbën 1.51 % të sipërfaqes së parkut.


Zona III-të, në krahasim me zonën I-rë dhe të II-të, ka kushte të volitshme gjeografike, relievo dhe klimatike për zhvillimin e turizmit. Në zonën e tretë, përveç aktiviteteve që lejohen në zonën e dytë, lejohen edhe ndërtime në funksion të banimit, arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit. Këtu lejohet edhe shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës, duke përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme për këtë (punëtori për përpunimin e sasive të lejuara të drurit; për grumbullimin dhe përpunimin e frutave/bimëve të imëta; për prodhimin e ujit të pijes; për grumbullimin dhe prodhimin e produkteve të qumështit) e cila duhet të jetë në harmoni me normat dhe standardet mjedisore në fuqi.

Në pjesët e zonës së tretë ku mund të ketë sipërfaqe shumë të vogla të mbuluara me drunj, nuk lejohen aktivitetet që janë karakteristike vetëm për zonën e tretë, pra ndërtimet etj. Në përgjithësi, në zonën III-të nuk lejohet ndërtimi i kapaciteteve industriale të cilat e ndotin mjedisin, duke përfshirë impiantet hidroenergjetike dhe shfrytëzimin e paautorizuar të inerteve. Ndërtimet duhet të jenë të bazuara në këtë plan hapësinor apo në planet rregullues të hollësishëm e poashtu të jenë në harmoni të plotë me mjedisin natyror.

ZONA E NDIKIMIT


Kjo zonë shtrihet jashtë parkut kombëtar, në largësi prej 50 metrave nga kufiri i parkut. Zona në fjalë do të shërbejë si pengesë fillestare në drejtim të mbrojtjes së vlerave natyrore në brendi të parkut.

Zonimi në park		
Zona	ha	%
Z1	8745.60	16.42
Z2	43723.59	82.07
Z3	803.81	1.51
Totali	53273	100
Komuna e Prizrenit		
Z1	1798.21	3.38
Z2	9751.50	18.30
Z3	112.65	0.21
Totali	11662.36	21.89
Komuna e Dragashit		
Z1	5341.13	10.03
Z2	18341	34.43
Z3	326.72	0.61
Totali	24008.85	45.07
Komuna e Shtërpçës		
Z1	930.43	1.75
Z2	11825.32	22.20
Z3	128.04	0.24
Totali	12883.79	24.19
Komuna e Therandës		
Z1	567.21	1.06
Z2	1787.17	3.35
Z3	158.98	0.30
Totali	2513.36	4.72
Komuna e Kaçanikut		
Z1	108.62	0.20
Z2	2018.60	3.79
Z3	77.42	0.15
Totali	2204.64	4.14



Harta x. Zonimi i parkut sipas planit hapësinor të mëparshëm

Tabela X. Pjesëmarrja e sipërfaqes së parkut në territoret e komunave



Harta x. Zonimi i parkut


8.1.2. SKENARËT E ZHVILLIMIT

Gjatë fazës së përpilimit të konceptit të zhvillimit hapësinor janë analizuar tre koncepte apo tre skenarë të ndryshëm të zhvillimeve të ardhshme në territorin e parkut. Skenarët janë ndërtuar mbi bazën e favorizimit të dy qëllimeve bazike për parkun: ruajtjes së parkut dhe zhvillimit ekonomik të tij. Pas analizës, si koncept për zhvillimet e ardhshme në park është përzgjedhur skenari i cili ka rezultuar si më i miri për arritjen e qëllimeve të lartpërmendur.

Skenari i ruajtjes maksimale – Ky skenar e favorizon qëllimin e ruajtjes së parkut në një masë të madhe duke i dhënë shumë pak hapësirë zhvillimit ekonomik të parkut. Kjo do të thotë se sipërfaqja e zonës së parë – zonës strikte në park rritet shumë, kurse zona e tretë reduktohet në maksimum. Ky skenar është vlerësuar i paqëndrueshëm për faktin e kufizimeve të mëdha të zhvillimit, pa të cilin është e vështirë të arrihet mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit. Me një skenar të tillë është e pamundur të zhvillohet turizmi dhe degët e saj, si një fushë e fuqishme e zhvillimit jo vetëm për zonën në fjalë.

Vlerësimi i skenarit të ruajtjes maksimale		
Qëllimi	Ndikimi në arritjen e qëllimit	Përshkrimi i ndikimit
Park me administrim të mirë, menaxhim efikas dhe bashkëpunim të frytshëm	Pozitiv	
	Negativ	
	Neutral	Nuk duket që ky skenar të ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ në arritjen e këtij qëllimi. Arritja e tij kryesisht varet nga përgatitja, profesionalizmi dhe përkushtimi i stafit menaxherial e poashtu nga gatishmëria për bashkëpunim.
Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të natyrës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe shfrytëzimi racional i pasurive natyrore	Pozitiv	Ky skenar konsiston në rritjen sa më të madhe të zonës së parë të parkut ku aplikohet regjimi i mbrojtjes strikte të vlerave të parkut, prandaj ndikimi i tij sa i përket ruajtjes është mjaft pozitiv.
	Negativ	Skenari ka edhe ndikim negativ në këtë qëllim, sepse aty ku nuk lejohen aktivitetet njerëzore, vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore mbeten të pashfrytëzuara, të pashijua.
	Neutral	
Park me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik	Pozitiv	
	Negativ	Zgjerimi i madh i zonës strikte do t'i zvogëlonte shumë hapësirat në park ku do të mund të investohej në ndërtimin e kapaciteteve turistike e rrjedhimisht zhvillimin e turizmit e poashtu ku do të mund të zhvilloheshin edhe aktivitetet tjera ekonomike.
	Neutral	
Park në të cilin janë të siguruara qasja e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, si dhe shërbimet publike për banorët	Pozitiv	
	Negativ	Ky skenar e pamundëson qasjen me automjete në disa vende-stane të cilët sipas këtij skenari i mbulon zona e parë ku nuk mund të ketë ndërtim të rrugëve.
	Neutral	


Skenari i ruajtjes maksimale



Harta x. Skenari i ruajtjes maksimale

Skenari i zhvillimit maksimal – Ky është një skenar krejtësisht i kundërt nga ai i ruajtjes maksimale. Skenari i zhvillimit maksimal e kërkon një zhvillim sa më të madh ekonomik të parkut dhe rrjedhimisht rritjen maksimale të zonës së tretë. Një zgjidhje e tillë është vlerësuar me ndikim shumë negativ në mjedis, me rrezik të madh në humbjen e karakteristikave themelore të parkut e në këtë drejtim edhe të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Skenari i zhvillimit maksimal



Harta x. Skenari i zhvillimit maksimal

Vlerësimi i skenarit të zhvillimit maksimal		
Qëllimi	Ndikimi në arritjen e qëllimit	Përshkrimi i ndikimit
Park me administrim të mirë, menaxhim efikas dhe bashkëpunim të frytshëm	Pozitiv	
	Negativ	
	Neutral	Nuk duket që ky skenar të ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ në arritjen e këtij qëllimi. Arritja e tij kryesisht varet nga përgatitja, profesionalizmi dhe përkushtimi i stafit menaxherial e poashtu nga gatishmëria për bashkëpunim.
Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të natyrës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe shfrytëzimi racional i pasurive natyrore	Pozitiv	
	Negativ	Ky skenar konsiston në shtrirjen maksimale të zonës së tretë të parkut duke i përfshirë kështu edhe pjesët ku janë përqëndruar vlerat e trashëgimisë natyrore, të cilat duhet t'u takojnë zonës së dytë dhe të parë. Meqenëse në zonën e tretë regjimi i mbrojtjes është më pak rigoroz se në tjerat, vlerat natyrore që do të hynin në këtë zonë do të ishin dukshëm më pak të mbrojtura.
	Neutral	
Park me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik	Pozitiv	Zgjerimi i zonës së tretë e ka një ndikim pozitiv në arritjen e këtij qëllimi vetëm në aspektin e një zhvillimi ekonomik pak më të madh sepse do të thotë më shumë hapësirë për ndërtime në funksion të ngritjes ekonomike të parkut.
	Negativ	Hapësira më e madhe për ndërtime ka poashtu ndikim negativ në këtë qëllim dhe ndikimi negativ është më i madh se ai pozitiv. Sa më shumë vlera të natyrës që humbin për shkak të shndërrimeve të tokës në tokë ndërtimore aq më pak atraktiv bëhet parku për vizitorët dhe aq më pak një zhvillim i tillë mund të quhet zhvillim i qëndrueshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton arritjen e balancit në mes të zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së parkut.
	Neutral	
Park në të cilin janë të siguruara qasja e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, si dhe shërbimet publike për banorët	Pozitiv	Sigurimi i hapësirës për ndërtime, pra siguron edhe hapësirën për ndërtimin e infrastrukturës që mundëson arritjen e qëllimit.
	Negativ	
	Neutral	

Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm – Ky skenar paraqet përmbledhjen e ideve dhe propozimeve nga dy skenarët tjerë. Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm është vlerësuar si më i përshtatshmi dhe në harmoni me kërkesat e përgjithshme që do të kenë ndikim maksimal në zhvillimin e qëndrueshëm të parkut. Sipas këtij skenari, në përgjithësi, koncepti i zhvillimit hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri” konsiston në mbrojtjen e vlerave natyrore ekzistuese dhe zhvillimin e kontrolluar. I gjithë territori i parkut, duke iu referuar rregullave në fuqi, është ndarë në disa zona, të cilat për kriter kryesor e kanë nivelin dhe mënyrën e mbrojtjes dhe shfrytëzimit. Bazuar në këto rregulla, territori i parkut do të përbëhet nga zona të nivelit strik të mbrojtjes (Zona e I-rë), të cilat dallohen për nga përmbajtja e vlerave natyrore, shkalla e mbrojtjes maksimale dhe niveli minimal i shfrytëzimit. Siparfaqja më e madhe e parkut do të mbulohet nga zona e II-të ose zona më e lirë e shfrytëzimit, e cila kryesisht përbëhet nga kullosat dhe pyjet. Shkalla më liberale e shfrytëzimit në këto zona mundëson realizimin e disa aktiviteteve që duhet të jenë në harmoni me rregullat dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Në mesin e zonave të parkut, zona e III-të ose zona e zhvillimit, për nga sipërfaqja është zona më e vogël, ndërsa për nga hapësira zonë e shtrirë në të gjitha komunat pjesëmarrëse në park. Në aspektin e mbrojtjes zona në fjalë ka më pak kufizime dhe më shumë mundësi për zhvillim, i cili duhet të jetë i kontrolluar dhe në përputhje me mjedisin.


Vlerësimi i skenarit të zhvillimit të qëndrueshëm		
Qëllimi	Ndikimi në arritjen e qëllimit	Përshkrimi i ndikimit
Park me administrim të mirë, menaxhim efikas dhe bashkëpunim të frytshëm	Pozitiv	
	Negativ	
	Neutral	Nuk duket që ky skenar të ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ në arritjen e këtij qëllimi. Arritja e tij kryesisht varet nga përgatitja, profesionalizmi dhe përkushtimi i stafit menaxherial e poashtu nga gatishmëria për bashkëpunim.
Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të natyrës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe shfrytëzimi racional i pasurive natyrore	Pozitiv	Sipas këtij skenari, zonimi i parkut është bërë në mënyrë të balancuar, pra nuk ka zgjerim të ndonjë zone në dëm të tjetrës. Me këtë rast i është kushtuar rëndësia e duhur si mbrojtjes së vlerave natyrore e kulturore të parkut, ashtu edhe zhvillimit ekonomik të tij.
	Negativ	
	Neutral	
Park me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik	Pozitiv	Ky skenar parasheh hapësirë të mjaftueshme për zonën e tretë të parkut ku do të përqendrohen aktivitetet për ngritjen ekonomike të parkut.
	Negativ	
	Neutral	
Park në të cilin janë të siguruara qasja e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, si dhe shërbimet publike për banorët	Pozitiv	Sigurimi i hapësirës së mjaftueshme për zonat II dhe III të parkut, siguron edhe hapësirën për ndërtimin e infrastrukturës që mundëson arritjen e qëllimit.
	Negativ	
	Neutral	

Zona e ndikimit jashtë parkut e cila përfshinë hapësirën prej pesëdhjetë (50) metrash nga kufiri i parkut ka ndikim pozitiv në ruajtjen e parkut. Ajo paraqet barierën e parë në parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme në park.

Për rreth kësaj zone, rrjedhimisht për rreth parkut ekziston një numër i vendbanimeve të cilat së bashku po i quajmë “zona e vendbanimeve”. Në aspektin zhvillimor zona e vendbanimeve ka potencial të madh. Nga ndihma financiare që planifikohet të ofrohet përmes donatorëve dhe programeve qeveritare, do të krijohen kushte për ngritjen e ofertës për turizëm ekologjik rural, si njëra nga degët më në trend të zhvillimit të turizmit. Kjo zonë do të jetë ndërlidhja e parkut dhe vlerave të tij natyrore me trashëgiminë kulturore të bollshme të rajonit në përgjithësi. Fuqizimi i kësaj lidhjeje do të bëhet përmes zhvillimit të agjendave, itinerareve dhe paketave të ndryshme turistike, të cilat do të realizohen në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit.

Komunikimi si veprimtari e rëndësishme në park do të zhvillohet përmes rrugëve automobilistike, në të cilat në maksimum do të ulet shfrytëzimi i tyre nga automjetet e rënda. Në masë të madhe përparësi do ti ipet shtigjeve që do të përdorën nga këmbësorë, biciklistë dhe mjete të lehta motoristike dhe si të tilla do të jenë lidhja më e natyrshme e përmbajtjeve kryesore në park.

Qëllimi kryesor i konceptit është që, respektimi i normave dhe rregullave mjedisore të jetë kushti themelor që kjo zonë të shndërrohet në atraksion turistik përtej kërkesave vendore. Zhvillimi i pa kontrolluar duke përfshirë prerjen e pa kontrolluar të pyjeve dhe ndërtimet e pa planifikuara, duhet të zëvendësohet me një qasje më mike ndaj mjedisit. Turizmi si veprimtari më e levërdishme ekonomike do të jetë baza themelore për zhvillim, në kuadër të të cilit duhet të ketë vend për të gjithë, duke e përfshirë komunitetin lokal, sektorin e biznesit dhe vendimarrjen lokale dhe qendrore.



Harta x. Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm

9. STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Strategjia është një pako e masave, aktiviteteve, veprimeve apo projekteve konkrete me realizimin e të cilave tentohet të arrihen qëllimet dhe objektivat që janë përcaktuar për Parkun Kombëtar “Sharri”. Për secilin objektiv veç e veç janë të caktuar projektet apo veprimet konkrete të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave. Qëllimet dhe objektivat që dëshirohet të arrihen në park kanë të bëjnë me çështje dhe fusha të ndryshme si: administrimi dhe menaxhimi i parkut, mjedisi, trashëgimia kulturore, zhvillimi social, zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura.

Qëllimi 1 (Q1) – Park me administrim të mirë, menaxhim efikas dhe bashkëpunim të frytshëm

Sot kur zhvillimi ekonomik në përgjithësi dhe ndërtimet në veçanti kanë marrë hov dhe në jo pak raste ato janë bërë pa leje dhe të pabazuara në plan, madje edhe në sipërfaqet nën mbrojtje të shtetit, siq janë parqet kombëtare, parandalimi i kësaj dukurie shtrohet si nevojë e kohës. Administrimi i mirë dhe menaxhimi efikas i parkut kombëtar janë në funksion të parandalimit të ndërtimeve të paligjshme në park dhe si të tillë përbëjnë një qëllim shumë të rëndësishëm për tu arritur në park. Ky qëllim mund të arrihet duke i arritur objektivat në vazhdim.

Q1/Objektivi 1 – Hartimi i planit të menaxhimit për parkun dhe zbatimi i tij duke i përmbushur të gjitha kërkesat që dalin nga ky plan

Hartimi i Planit të Menaxhimit për Parkun Kombëtar “Sharri” është hapi i parë, i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të lartpërmendur, ndërkaq zbatimi i tij i plotë është në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të parkut.

Q1/Objektivi 2 – Rikthimi i kompetencave të plota tek Drejtoria për Administrimin e PK “Sharri”

Aktualisht Drejtoria për Administrimin e PK “Sharri” (DAPKSH) ka kompetenca të kufizuara për menaxhimin e të gjitha resurseve të parkut. Kjo është për arsye se legjislacioni që i rregullon çështjet e mjedisit dhe të natyrës nuk është i harmonizuar. Janë 4 ligje që i rregullojnë këto çështje e të cilat kanë të bëjnë edhe me parqet kombëtare. Ligjet në fjalë nuk i japin kompetenca të njëjta DAPKSH gjë që ia vështirëson punën asaj në menaxhimin e parkut dhe kështu e bën menaxhimin më pak efikas.

Q1/Objektivi 3 – Ngritja e kapaciteteve humane dhe teknike / teknologjike në DAPKSH

Aktualisht Drejtoria për Administrimin e PK “Sharri” ka kapacitete humane dhe teknike të pamjaftueshme për ta realizuar një administrim dhe menaxhim të kënaqshëm të parkut. Numri i stafit profesional nuk i përmbushë kërkesat e DAPKSH e gjithashtu numri i vogël i rojtarëve të parkut, aktualisht është në gjendje ta mbulojë vetëm një pjesë të parkut. Stafi i kësaj drejtorie ka nevojë edhe për një ngritje të mëtejshme profesionale. Në mënyrë që të mund t’i kryej detyrat e veta, DAPKSH duhet të posedojë mjete të transportit që mund të lëvizin në terrene të vështira malore. Aktualisht numri i tyre nuk është i mjaftueshëm. Gjendja aktuale në DAPKSH, e përshkruar më lartë, shtron nevojën për ngritjen e kapaciteteve humane e teknike në këtë institucion.

Q1/Objektivi 4 – Bashkëpunimi me subjektet relevant vendor dhe ndërkombëtar dhe lidhja e marrëveshjeve me vendet fqinje dhe më gjërë

Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me subjektet relevant vendor dhe ndërkombëtar, përveq që është një tregues për administrim të mirë të parkut, ndikon pozitivisht në menaxhimin e të njëjtit dhe rrjedhimisht në ruajtjen dhe zhvillimin e tij. Bashkëpunimi sjell shkëmbim informatash dhe përvojash të mira në ruajtjen dhe zhvillimin e parkut. Ai gjithashtu siguron burime të reja financiare, qofshin ato për financimin e projekteve të pëbashkëta ndërkufitare apo ato për projekte të tjera në dobi të parkut kombëtar.

Q1/Objektivi 5 – Promovimi i parkut përmes aktiviteteve të ndryshme dhe njohja ndërkombëtare e tij

Promovimi i parkut përmes aktiviteteve të ndryshme në mënyrë që ai të njihet sa më shumë brenda e sidomos jashtë vendit, e mundëson që parku të tërheqë sa më shumë vizitorë apo turistë. Rritja e numrit të turistëve apo rritja e kërkesës për ta vizituar parkun sjell rritjen e të ardhurave nga turizmi duke e mundësuar kështu rritjen e ofertës përmes shtimit të kapaciteteve turistike në mënyrë që oferta t'i përgjigjet kërkesës. Kjo rritje e të ardhurave, përveq që ka ndikim pozitiv në zhvillimin e parkut, ndikon pozitivisht edhe në menaxhimin e parkut, rrjedhimisht edhe në ruajtjen e tij.

Qëllimi 2 (Q2) – Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të natyrës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe shfrytëzimi racional i pasurive natyrore

Parku Kombëtar "Sharri" është një hapësirë, vlerat natyrore dhe kulturore të të cilit janë vënë nën mbrojtje ligjore të shtetit. Arritja e qëllimit për ruajtjen e vlerave të natyrës dhe të trashëgimisë kulturore, si dhe për shfrytëzimin racional të pasurive natyrore të parkut e ruan mjedisin dhe e ngritë kualitetin e jetës, e poashtu e përmbushë edhe obligimin ligjor. Ky qëllim qëndron në vet thelbin e ekzistencës së parkut si park kombëtar, sepse pa arritjen e tij, kjo hapësirë do të mund të degradohej gradualisht duke rrezikuar kështu që me kalimin e kohës t'i humbasë atributet e një parku të mirëfillt kombëtar dhe të mbetet vetëm në letër park kombëtar. Qëllimi mund të arrihet duke i arritur objektivat në vazhdim.

Q2/Objektivi 1 – Mbrojtja dhe monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja dhe degradimi, si dhe monitorimi i elementeve meteorologjike dhe ujrave sipërfaqësor

Qëllimi kryesor i këtij objektivi është parandalimi i ndotjes dhe mbrojtja e ajrit, ujit dhe tokës nga ndikimet negative që e degradojnë natyrën. Obligohen institucionet që e administrojnë dhe e menaxhojnë parkun kombëtar t'i monitorojnë, ruajnë dhe vëzhgojnë të gjitha elementet natyrore si dhe t'i jetësojnë veprimet që janë të nevojshëm për arritjen e këtij objektivi.

Q2/Objektivi 2 – Mbrojtja nga aktivitetet ilegale: prerja ilegale e pyjeve, mbikullotja, shfrytëzimi pa kontrollë i bimëve mjekësore dhe i frutave, gjuetia ilegale

Aktualisht, aktiviteti që më së shumti e degradon mjedisin në Parkun Kombëtar "Sharri" është prerja ilegale e pyjeve. Në masë më të vogël, aty ndodhin edhe aktivitete tjera të dëmshme siq janë gjuetia ilegale dhe shfrytëzimi pa kontrollë i bimëve mjekësore dhe i frutave. Në këto rrethana, arritja e objektivit për mbrojtje nga këto aktivitete të dëmshme ilegale është nevojë e kohës.

Q2/Objektivi 3 – Zhvillimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit të popullatës për ta nxitur atë të mësojë më shumë rreth biodiversitetit dhe rëndësisë së kujdesit ndaj tij

Parku Kombëtar "Sharri" është një vend që është shpallur nën mbrojtje të shtetit. Republika e Kosovës i ka institucionet shtetërore, përgjegjëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e parkut, të cilat veprojnë në këtë drejtim duke u bazuar në detyrat e tyre të punës, të mbështetura në legjislacionin përkatës dhe në planet hapësinore e menaxhuese të parkut. Në mënyrë që parku të ruhet sa më mirë, është shumë e rëndësishme që atë, përveç institucioneve shtetërore, ta ruajë edhe popullata. Një parakusht i rëndësishëm që kjo të realizohet është zhvillimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit të popullatës për ta nxitur atë të mësojë më shumë rreth biodiversitetit dhe rëndësisë së kujdesit ndaj tij.

Q2/Objektivi 4 – Mbrojtja dhe ruajtja e rezervateve të natyrës, si dhe promovimi i tyre shkencor

Rezervatet e natyrës brenda territorit të parkut kombëtar, për shkak të vlerave të veçanta natyrore që i posedojnë i nënshtrohen regjimit më rigoroz të mbrojtjes ligjore të natyrës. Aktualisht jemi dëshmitarë se rezervatet nuk ruhen konform kërkesës ligjore për një natyrë të paprekur. Për këtë

arësye duhet të bëhen përpjekje që në rezervate të pamundësohet çdo aktivitet që është në kundërshtim me regjimin e vendosur të mbrojtjes rigoroze dhe natyra të mbetet e paprekur.

Q2/Objektivi 5 – Mbrojtja dhe ruajtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit në përgjithësi dhe e llojeve endemike, relikte dhe endemorelikte të bimëve, shtazëve dhe shpezëve në veçanti

Ajo që tentohet të arrihet me këtë objektiv është që llojet unike dhe të rralla të bimëve dhe të shtazëve të kenë vazhdimësi dhe të parandalohet zhdukja e llojeve të atyre bimëve dhe shtazëve që janë në rrezik. Duhet të merren masa për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik, llojeve dhe ekosistemeve të veçanta që janë thelbësore për diversitetin biologjik.

Q2/Objektivi 6 – Shfrytëzimi i pasurive natyrore sipas planit të menaxhimit: prerjet sanitare të pyjeve dhe për ngrohje, vjelja e bimëve mjekësore dhe frutave, shfrytëzimi i kullosave dhe pejzazheve natyrore për rekreacion

Në mënyrë që pasuritë natyrore të parkut të shfrytëzohen në mënyrë racionale, të mos keqpërdoren dhe kështu të ruhen sa më shumë vlerat e parkut është e domosdoshme që kjo të bëhet sipas planit të menaxhimit të parkut. Plani i menaxhimit e tregon mënyrën e qëndrueshme të shfrytëzimit të pyjeve, frutave, bimëve mjekësore, kullosave, pejzazheve të natyrës etj.

Q2/Objektivi 7 – Inventarizimi i specieve të rrezikuara të botës bimore dhe shtazore, si dhe zhvillimi i programeve të monitorimit dhe hulumtimit

Ky objektiv ka të bëjë me monitorimin e botës bimore dhe shtazore që për shkak të ndryshimeve klimatike apo edhe mjedisore, si dhe ndikimit të faktorit njeri, është rrezikuar. Përmes këtij objektivi identifikohen dhe inventarizohen speciet e rrezikuara të botës bimore dhe shtazore, si dhe zhvillohen strategjitë për mbrojtjen e tyre.

Q2/Objektivi 8 – Mbrojtja, promovimi, mbarshtrimi dhe rritja e Qenit të Sharrit (Deltari Ilir) si simbol i Parkut Kombëtar “Sharri”

Me këtë objektiv dëshirohet të promovohet dhe të ruhet Deltari Ilir (Qeni i Sharrit) që ka histori të njohur deltare dhe është autokton në Malin Sharr. Qeni i Sharrit është një kafshë e fuqishme, inteligjente dhe besnike, prandaj është i nevojshëm kujdesi për të, ushqimi i përshtatshëm dhe kujdesi veterinar për mbarshtrimin dhe rritjen e tij. Duke e bërë këtë mund të sigurojmë që ky qen të jetë i shëndetshëm, i lumtur dhe i përshtatshëm për mjedisin dhe shoqërinë.

Q2/Objektivi 9 – Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera në Parkun Kombëtar “Sharri” është një çështje e rëndësishme për ruajtjen e mjedisit dhe sigurinë e vizitorëve. Në fokus të këtij objektivi janë: studimi i rreziqeve në kuadër të parkut, planet e veprimeve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës, ndërtimi i sistemeve parandaluese në rast rreziku, informimi me kohë etj.

Q2/Objektivi 10 – Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Me këtë objektiv synohet ruajtja e identitetit kombëtar duke siguruar ekzistencën fizike dhe duke ruajtur autenticitetin e zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore (TK), ku secili nga ato ka një histori në vehte. Me funksionalizimin e objekteve të TK do të mundësohet ruajtja dhe shfrytëzimi i tyre, si dhe përcjellja tek gjeneratat e ardhshme. Për zonat dhe asetet me TK duhet të sigurohet infrastruktura e nevojshme dhe çasja e lehtë tek ato. Është shumë i rëndësishëm informimi dhe vetëdijesimi për rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në park dhe rrethinë, si dhe për shfrytëzimin racional të vlerave të saj. Pjesë e TK është edhe trashëgimia e luajtshme dhe shpirtërore. Ajo paraqet formën e shprehjes kulturore të traditave popullore, zakoneve, gjuhës, festave, ritualeve, valleve, muzikës, këngëve, si dhe ushqimit tradicional që së bashku e kanë një rol të

rëndësishëm në aspekt të mbrojtjes, zhvillimit dhe promovimit të parkut dhe të vendbanimeve në afërsi të tij.

Qëllimi 3 (Q3) – Park me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik

Zhvillimi ekonomik në park do të jetë në funksion të krijimit të kushteve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të vlerave të parkut. Aty, përveç blegtorisë si veprimtari tradicionale, synojmë që të fuqizohet zhvillimi i turizmit duke siguruar mbrojtjen e burimeve natyrore dhe ekosistemin nga të cilat përfiton ekonomia dhe shoqëria në përgjithësi.

Turizmi në PK do të mundësojë krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e infrastrukturës dhe tërheqjen e investimeve. Të ardhurat nga turizmi sjellin rritje dhe prosperitet socio-ekonomik të komunitetit të zonës dhe më gjerë.

Nxitja e zhvillimit të bujqësisë tradicionale dhe zhvillimi rural do të krijojë stabilitet ekonomik duke garantuar që prodhimet bujqësore të jenë cilësore sipas standardeve të kërkuara. Rritja e të hyrave nga bujqësia ndikon në përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës për komunitetin.

Në zonat e planifikuara për zhvillim (zonat e III-ta) duhet të ofrohet banim cilësor (vikend shtëpi), sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi, të cilat duhet të jenë në harmoni me mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit në përgjithësi. Banimi në park do të sjell përfitime ekonomike nga taksat e tatimit në pronë dhe ofron standard më të lartë jetësor për të jetuar pranë natyrës dhe për tu relaksuar me atraktivitetet natyrore.

Në park do të ofrohet qasje në shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor për vizitorët dhe banorët lokal, nëpërmjet institucioneve shëndetësore të nivelit parësor.

Arritja e këtij qëllimi bëhet e mundur duke i arritur objektivat që janë dhënë në vazhdim.

Q3/Objektivi 1 – Ngritja e kapaciteteve turistike dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese

Me këtë objektivi tentohet që zona e tretë brenda parkut të jetë në funksion të zhvillimit të turizmit, duke ofruar infrastrukturë adekuate dhe atraktive për vizitorët. Zhvillimi i infrastrukturës turistike nënkupton ngritjen e objekteve: hoteleve, restoranteve, bujtinave, kampeve, shtigjeve dhe funksionimin e transportit në park dhe vendbanimet përreth, bazuar në planet rregulluese për zonat e parapara për zhvillim.

Zonat e zhvillimit do të ngritën në bazë të planeve rregulluese, duke u bazuar në dispozitat për zbatim. Prioritet do të kenë zonat ku janë duke ndodhur zhvillimet, ndërsa lokalitetet tjera si potenciale turistike, do të përcaktohen nga Drejtoria e Parkut në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunave pjesëmarrëse në park. Gjithashtu, do të mundësohet privatizimi i kapaciteteve ekzistuese dhe joshja e investitorëve për të investuar në zhvillimin e infrastrukturës turistike.

Në bazë të kërkesës së turistëve do të investohet në ngritjen e kapaciteteve turistike plotësuese, për të përmbushur kërkesat e turistëve në zonat e vendbanimeve përreth parkut të cilat kanë qasje të lehtë në park.

Q3/Objektivi 2 – Zhvillimi i bujqësisë tradicionale, blegtorisë dhe bletarisë në funksion të zhvillimit të ekoturizmit nga banorët lokal

Ky objektivi ka të bëjë me ndërgjegjësimin e fermerëve për përfitime ekonomike nga kultivimi ekologjik i prodhimeve me metoda tradicionale organike, që si rezultat do të ketë promovimin e kulturës dhe traditës së zonës, që zgjon interesimin e turistëve dhe rritë atraktivitetin turistik në zonë. Kontrolli, shfrytëzimi i kullosave dhe livadheve për blegtori do të bëhet në mënyrë të organizuar sipas etapave kohore dhe sipërfaqeve të destinuara të cilat caktohen me Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar "Sharri".

Q3/Objektivi 3 – Shfrytëzimi i kontrolluar i bimëve mjekuese dhe aromatike (BMA) dhe pemëve frutore të egra (PFE) për përfitime ekonomike

Me këtë objektivi arrihet kontrolli i shfrytëzimit të kullosave, livadheve për blegtori, BMA dhe PFE. Këto shfrytëzohen në mënyrë ekologjike dhe të organizuar, sipas etapave kohore sezonale duke i përcaktuar sipërfaqet e vjeljes që rezultojnë në mbrojtjen e mjedisit të pasur, në menaxhimin e mirë dhe në përfitime ekonomike.

Q3/Objektivi 4 – Krijimi i kushteve që banorët lokal të punësohen në industrinë turistike

Zhvillimi i turizmit ofron mundësi të shumta për përfitime ekonomike të komunitetit. Me zhvillimin e turizmit synohet të përfitojnë edhe banorët lokal, gjithmonë duke pasur parasysh pasuritë natyrore dhe llojllojshmërinë kulturore të zonës. Zhvillimi i turizmit do të ofrojë mundësi të shumta të punësimit si për burra dhe për gratë e komunitetit lokal, duke filluar nga pozicionet e nivelit fillestar deri te rolet drejtuese ekzekutive.

Banorët lokal të zonës përreth Parkut Kombëtar “Sharri” karakterizohen me një laramani kulturash, traditash dhe atraksionesh të zonës, gjë që i bën të veçantë këto komunitete, prandaj me këtë objektivi synojmë që ti inkurajojmë në angazhimin e tyre në industrinë turistike, duke i ofruar kushte për menaxhimin e bizneseve akomoduese, promovimin e gastronomisë dhe artizanateve, produkteve të tjera turistike si dhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në industrinë turistike. Angazhimi rreth zbatimit të këtyre aktiviteteve të banorëve lokal do të mund të sigurojë përfitime ekonomike dhe të rrisi mirëqenien sociale për komunitetin rural, si dhe të ndihmojë në ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave dhe traditave lokale. Në fillim këto aktivitete do të jenë plotësim i të hyrave materiale për disa nga banorët, ndërsa më vonë edhe burim kryesor i të ardhurave.

Q3/Objektivi 5 – Zhvillime të planifikuara me banim cilësor (vikend shtëpi) dhe ndërtime të kontrolluara, që janë në harmoni me mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit

Me këtë objektivi synohet që të sigurohen kushtet e zhvillimit dhe të rregullimit hapësinor në territorin e parkut kombëtar.

Objektet e ndërtimit³³ në kuadër të parkut duhet të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duhet t’iu nënshtrohen disa procedurave administrative që realizohen nga organet kompetente të nivelit qendror dhe lokal e që janë përgjegjëse edhe për koordinimin e inspektimeve ndërtimore.

Aktivitetet në zonën e II-të të mbrojtjes dhe në zonën e III-të të planifikuar për zhvillim duhet t’i nënshtrohen një kontrolli rigoroz, i cili bazohet në standarde ndërkombëtare dhe norma teknike të përshtatura me vendin tonë, të cilat duhet të jenë në harmoni me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik të popullatës. Ndërtimet në park duhet të realizohen me materiale ndërtimore që janë në harmoni me mjedisin dhe minimizojnë ndikimin negativ në ambientin natyror ndërsa punët ndërtimore duhet të kryhen me teknologji të avancuar për të zvogëluar ndotjen dhe për të ruajtur vlerat natyrore dhe biodiversitetin në përgjithësi.

Në kuadër të parkut duhet të planifikohen ndërtime për të cilat duhet të sigurohet infrastruktura rrugore, sistemi i ujësjellësit e kanalizimit dhe energjia. Në raste të veçanta, ndërtesat ekzistuese dhe ato të reja, që përdoren gjatë gjithë vitit mund të përfshihen në rritjen e performancës energjetike të ndërtesave³⁴.

Në kuadër të parkut është evidente dukuria e ndërtimeve pa leje të cilat sipas legjislacionit duhet t’i nënshtrohen procesit të legalizimit. Në të njëjtën kohë, gjatë fazës së ndërtimeve dhe pas përfundimit

³³ Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim/”1.2. Ndërtim apo objekt ndërtimor - çdo gjë që ndërtohet apo rezultojnë nga punët ndërtimore”.

³⁴ Rritja e performancës energjetike të ndërtesave sipas Direktivës së Performancës së Energjisë së Ndërtesave 2010/31/BE dhe Direktivës së Efiçencës së Energjisë 2012/27/BE.

të tyre, duhet t'i kushtohet kujdes mbrojtjes së florës dhe faunës në park dhe trajtimit të peizazheve të cilat janë degraduar pas ndërhyrjeve ndërtimore, gjë e domsdoshme kjo për të kthyer mjedisin në gjendjen natyrore.

Në zonat e planifikuara për zhvillim duhet të sigurohet banimi cilësor (vikend shtëpitë), sipas masave dhe veprimeve të qëndrueshme për të parandaluar dhe minimizuar ndikimet negative në mjedis. Sipas Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar "Sharri", të gjitha zhvillimet duhet kontrolluar strikt në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e mjedisit, biodiversitetit dhe të promovohen aktivitetet ekonomike në park.

Q3/Objektivi 6 – Shërbime shëndetësore të kualitetit të lartë

Me këtë objektivi tentojmë që ta përmirësojmë kualitetin e kujdesit shëndetësor dhe qasjen në shërbime shëndetësore dhe emergjente për vizitorët dhe banorët lokal. Në park duhet të planifikohet qasja në shërbime shëndetësore, në mënyrë që shërbimet emergjente të jenë të lidhura me qendrat regjionale përkatëse.

Qendrat turistike si dhe shumë vendbanime për rreth parkut kanë mungesë të shërbimeve shëndetësore, prandaj përmes këtij objektivi do t'iu mundësojmë banorëve dhe vizitorëve të parkut qasje dhe siguri në shërbime kualitative të kujdesit shëndetësor. Vëmendja do t'iu kushtohet shërbimeve emergjente dhe shërbimeve shtëpiake për të ofruar ndihmën e parë.

Q3/Objektivi 7 – Sigurimi i burimeve financiare dhe teknike nga organizatat ndërkombëtare dhe partnerët rajonal për të ndihmuar në zhvillimin dhe menaxhimin e parkut kombëtar

Sigurimi i mjeteve financiare është parakusht për arritjen e qëllimit për zhvillimin socio-ekonomik të parkut. Për këtë arsye, shteti përmes organizmave të tij përgjegjës për zhvillimin e parkut, duhet të sigurojë burime financiare, përveç tjerash, edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe partnerët rajonal.

Qëllimi 4 (Q4) – Park në të cilin janë të siguruara qasja e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, si dhe shërbimet publike për banorët

Në mënyrë që parku të mund të shfrytëzohet sa më mirë për pushim dhe rekreacion, qytetarëve duhet t'iu sigurohet një qasje e lehtë në hapësirat dhe objektet e ndryshme të parkut, si dhe shërbimet e nevojshme për ta. Ky qëllim arrihet me ndërtimin e infrastrukturës. Ndërtimi i infrastrukturës së transportit apo ndërtimi i rrugëve e mundëson qasjen në destinacionet e dëshiruara të parkut. Sigurimi i shërbimeve publike për banorët do të thotë: sigurimi i energjisë elektrike dhe termike, sigurimi i ujit të pijshëm, sigurimi i largimit dhe trajtimit të ujërave fekal, sigurimi i transportit publik, sigurimi i shërbimeve telekomunikuese dhe sigurimi i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Këto shërbime gjithashtu mundësohen me ndërtimin e infrastrukturës përkatëse për secilin prej tyre. Rrjedhimisht, objektivat që duhet të arrihen në mënyrë që të arrihet qëllimi në fjalë, si dhe veprimet që janë të nevojshme për arritjen e objektivave kanë të bëjnë me ndërtimin e komponentave të ndryshme të infrastrukturës.

Q4/Objektivi 1 – Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe përmirësimi i transportit publik

Njëra nga komponentat e infrastrukturës që duhet të sigurohet në park është infrastruktura rrugore. Me anë të rrugëve lehtë të kalueshme për automjete dhe shtigjeve për ecje dhe çiklizëm mundësohet qasja tek të gjitha përmbajtjet e parkut që janë në funksion të pushimit, sportit dhe rekreacionit. Sigurimi i një rrjeti të mirë rrugor e mundëson zhvillimin e transportit publik dhe privat që është një mundësi më shumë për t'iu përjetuar vlerat natyrore në park, ndërkaq banorëve të parkut ua lehtëson lëvizjen në relacionet fshat-fshat dhe fshat-qytet. Objektivi është që, përveç tjerash, të realizohet edhe një lidhje rrugore me Maqedoninë e Veriut. Kjo rrugë, Prizrenit me vendbanimet rreth tij do t'ia

shkurtonte dukshëm distancën me vendbanimet e Maqedonisë Veriore: Tetovë, Shkup, Gostivar dhe vendbanimet rreth tyre. Rruga poashtu do t'ua shkurtonte shumë distancën banorëve të pjesës veriore të Shqipërisë me vendbanimet e lartpërmendura apo me Maqedoninë Veriore, kurse kësaj të fundit do t'ia shkurtonte distancën me bregdetin shqiptar. E tërë kjo do ta lehtësonte dhe do ta rriste shkëmbimin tregtar ndërmjet tri shteteve dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Q4/Objektivi 2 – Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së energjisë elektrike

Për zhvillimin ekonomik të parkut kombëtar, është i domosdoshëm sigurimi i furnizimit të rregullt me energji elektrike. Të gjitha llojet e ndërtesave dhe veprimtarive në park dhe në vendbanimet rreth tij kanë nevojë për energji elektrike në mënyrë që të mund të funksionojnë. Meqenëse këto do të shtohen në të ardhmen, shtrohet nevoja që infrastruktura e tanishme e energjisë elektrike të zhvillohet më tej. Duhet të përmirësohet rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike duke përfshirë edhe instalimin e trafave të rinj.

Q4/Objektivi 3 – Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës ujore


Gjendja aktuale kur në hapësirat e parkut dhe në vendbanimet rreth tij janë shumë pak të shtrirë sistemet publik të ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilët janë më të sigurtë në pikëpamje shëndetësore se sa sistemet lokal privat dhe menaxhohen më mirë, sepse menaxhohen nga kompanitë rajonale të ujësjellësit dhe kur në këto hapësira nuk ekziston asnjë impiant për pastrimin e ujërave të zeza, i cili do t'i pastronte këto ujëra para se të derdhen në lumenj, e shtron nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës ujore. Ky zhvillim është parakusht për zhvillimin e turizmit, por edhe të degëve të tjera të ekonomisë.

Q4/Objektivi 4 – Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së telekomunikacionit


Ndonëse aktualisht e kemi një gjendje ku infrastruktura e telekomunikacionit është relativisht e avancuar dhe mundëson informimin dhe komunikimin ndërmjet njerëzve, me gjithë atë, në hapësirën e parkut kombëtar dhe në vendbanimet rreth tij ekzistojnë disa mangësi sa u përket shërbimeve të telekomunikacionit. Siq është thënë, rrjeti i telefonisë fikse shtrihet vetëm në një sipërfaqe të kufizuar të parkut, kurse sinjali i telefonisë mobile GSM nuk e mbulon tërë hapësirën e parkut. Kjo shtron nevojën për investime që të arrihet edhe objektivi i radhës që është zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së telekomunikacionit.

Q4/Objektivi 5 – Sigurimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i mbeturinave

Imazhi i një parku të pastër, të liruar nga mbeturinat është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit. Është e kuptueshme që një park ku mbeturinat do të shpërndaheshin gjithandej, nuk do të ishte tërheqës për vizitorët dhe rrjedhimisht zhvillimi i turizmit do të ngadalësohej. Për këtë arsye, në park duhet të sigurohet infrastruktura për mbeturinat dhe menaxhimi i mirë i tyre në mënyrë që parku të mbahet i pastër.



Harta x. Infrastruktura në Parkun Kombëtar "Sharri"



Harta x. Strategjia e zhvillimit hapësinor në Parkun Kombëtar "Sharri"

9.1. PLANI I VEPRIMIT

Qëllimi 1							
Park me administrim të mirë, menaxhim efikas dhe bashkëpunim të frytshëm							
Objektivi	Veprimi/Masa/Projekti		Akterët vendim marrës	Akterët e zbatimit	Afat i kohor	Burimi financiar	Implikimi financiar
1. Hartimi i planit të menaxhimit për parkun dhe zbatimi i tij duke i përmbushur të gjitha kërkesat që dalin nga ky plan	1	Nxjerrja e vendimit për hartimin e planit	MMPHI	MMPHI	*	BK	I ultë
	2	Caktimi i subjektit bartës të hartimit dhe grupit punues mbështetës (GPM) në hartimin e planit	MMPHI	MMPHI	*	BK	I ultë
	3	Grumbullimi i informatave dhe përpilimi tekstual dhe hartografik i dokumentit	Drejtoria për Administrimin e PK "Sharri", kompania hartuese	Drejtoria për Administrimin e PK "Sharri", kompania hartuese (DAPKSH)	*	BK	I ultë
	4	Mbajtja e takimeve informuese dhe konsultative me GPM dhe me palët tjera të interesit	DAPKSH, kompania hartuese	DAPKSH, kompania hartuese	*	BK	I ultë
	5	Mbajtja e shqyrtimit publik (SHP) të dokumentit	DAPKSH, kompania hartuese	DAPKSH, kompania hartuese, subjektet pjesëmarrës në SHP	*	BK	I ultë
	6	Përfundimi i draftit final të planit dhe aprovimi i tij.	DAPKSH, kompania hartuese, xx	DAPKSH, kompania hartuese, xx	*	BK	I ultë
	7	Përpilimi dhe zbatimi i planeve vjetor të punës dhe përmbushja e të gjitha kërkesave tjera të planit të menaxhimit nga ana e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" (DAPKSH).	DAPKSH	DAPKSH	***	BK	I ultë
2. Rikthimi i kompetencave të plota tek Drejtoria për Administrimin e PK "Sharri"	1	Harmonizimi i Ligjit për Pyjet me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Parkun Kombëtar "Sharri" në mënyrë që të definohen qartë përgjegjësitë institucionale në menaxhimin e parkut kombëtar duke ia kthyer DAPKSH kompetencat e plota për t'i menaxhuar të gjitha resurset në park	Qeveria (MMPHI, MBPZHR)	MMPHI, MBPZHR	*	BK	I ultë
	2	Harmonizimi i dokumenteve të planifikimit si: Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar „Sharri” dhe Planit të Menaxhimit të PK “Sharri” me legjislacionin (ligjet e lartpërmendur)	MMPHI (IPH, DAPKSH)	MMPHI (IPH, DAPKSH)	*	BK	I ultë

3. Ngritja e kapaciteteve humane dhe teknike / teknologjike në DAPKSH	1	Sigurimi i numrit të nevojshëm të stafit të DAPKSH – stafit profesional e teknik dhe rojtarëve.	Qeveria (MMPHI)	MMPHI	*	BK	I ultë
	2	Ndjekja e trajnimeve për parqet kombëtare dhe menaxhimin e tyre, si dhe realizimi i vizitave studimore nga stafi i DAPKSH.	MMPHI	DAPKSH	**	BK	I ultë
	3	Sigurimi i numrit të nevojshëm të mjeteve të transportit dhe i paisjeve tjera të nevojshme për DAPKSH.	MMPHI	MMPHI	*	BK	I ultë
4. Bashkëpunimi me subjektet relevant vendor dhe ndërkombëtar dhe lidhja e marrëveshjeve me vendet fqinje dhe më gjërë	1	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet fqinje Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në funksion të ruajtjes së parkut dhe të realizimit të projekteve të përbashkëta në zonat ndërkufitare	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI)	*	BK	I ultë
	2	Organizimi dhe pjesëmarrja në konferencat që mbahen brenda dhe jashtë vendit për arritjen e partneritetit në mes të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar	Qeveria (MMPHI)	MMPHI, donatori i caktuar	**	BK, nga donatori	I mesëm
	3	Bashkëpunimi i DAPKSH me individët dhe subjektet relevant vendor, si pjesë e aktiviteteve të menaxhimit të parkut	MMPHI DAPKSH	DAPKSH	***	BK	I ultë
	4	Mbajtja e takimeve të DAPKSH me simotrat e saj nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut në funksion të shkëmbimit të informatave dhe përvojave	MMPHI DAPKSH	DAPKSH	***	BK	I ultë
5. Promovimi i parkut përmes aktiviteteve të ndryshme dhe njohja ndërkombëtare e tij	1	Promovimi i parkut përmes mediave të ndryshme si: televizionit, radios, mediave sociale, web faqeve, broshurave dhe dokumenteve tjera informuese	MMPHI, mediat elektronike dhe ato të shkruara	MMPHI, mediat elektronike dhe ato të shkruara, sponsorizues privat	**	BK, nga sponzori zuesi privat	I ultë
	2	Organizimi dhe mbajtja e takimeve me karaktere të ndryshme, vendore dhe ndërkombëtare në të cilat prezantohet parku	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI), sponsorizues privat	***	BK, nga sponzori zuesi privat	I ultë
	3	Zhvillimi i një platforme digjitale për të ofruar informacion dhe udhëzime për vizitorët, duke përfshirë hartat interaktive dhe detaje mbi aktivitetet në park					
	4	Përdorimi i teknologjisë së informacionit për të siguruar qasje në Internet dhe për të ofruar informacion shtesë për vizitorët në vendet kyçe të parkut					
	5	Distribuidimi i materialit promovues për PK "Sharri" përmes: mediave lokale dhe ndërkombëtare, agjencive turistike të vendit dhe të huaja, ambasadave të Republikës së	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI), mediat lokale dhe ndërkombëtare,	**	BK, nga agjencitë turistike, nga avio-	I ultë

		Kosovës, avio kompanive që e kanë destinim Kosovën etj.		agjencitë turistike të vendit dhe të huaja, ambasadat e Republikës së Kosovës, avio kompanitë që e kanë destinim Kosovën		kompani të	
6		Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Lugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat	Qeveria e Kosovës	Kuvendi i Kosovës, Qeveria (MMPHI)	*	BK	I ultë
7		Aplikimi për njohje në organizatat ndërkombëtare si: IUCN, WTO etj.	Qeveria e Kosovës	Qeveria e Kosovës	*	BK	I ultë

Qëllimi 2

Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të natyrës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe shfrytëzimi racional i pasurive natyrore

Objektivi	Veprimi/Masa/Projekti	Akterët vendim marrës	Akterët e zbatimit	Afat i kohor	Burimi financiar	Implikimi financiar	
1. Mbrojtja dhe monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja dhe degradimi, si dhe monitorimi i elementeve meteorologjike dhe ujrave sipërfaqësor	1	Ngritja e kapaciteteve profesionale njerëzore të DAPKSH në lëmitë si: pylltaria, bujqësia, biologjia, gjeografia, ekologjia etj, në funksion të aftësimin sa më të mirë për t'u marrë me mbrojtjen dhe monitorimin	Qeveria (MMPHI)	AMMK (DAPKSH)	*	BK	I mesëm
	2	Ndërtimi i dy stacioneve meteorologjike ku bëhen matjet meteorologjike dhe cilësia e ajrit në dy pika strategjike: Prevallë dhe Brezovicë	Qeveria (MMPHI)	AMMK (DAPKSH, IHMK)	***	BK	I ultë
	3	Ngritja e stacioneve hidrologjike dhe monitorimi i ujërrjedhave lumore në dalje të kufirit të parkut, për ujërrjedhat e lumenjve: Lepenc, Lumbardh i Prizrenit dhe Plavë	Qeveria (MMPHI)	AMMK (DAPKSH, IHMK)	***	BK	I ultë
2. Mbrojtja nga aktivitetet ilegale: prerja ilegale e pyjeve, mbikullotja, shfrytëzimi pa kontrollë i bimëve mjekësore dhe i frutave,	1	Sigurimi i numrit të mjaftueshëm të rojtarëve të parkut	MMPHI (AMMK-DAPKSH)	AMMK (DAPKSH)	*	BK	I ultë
	2	Përcaktimi i zonave të rrezikuara nga mbikullotja	MMPHI (AMMK-DAPKSH)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionist të nga universiteti dhe OJQ	*	BK	I ultë
	3	Përcaktimi i zonave të rrezikuara nga mbledhja e frutave	MMPHI (AMMK-DAPKSH)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionist të nga	***	BK	I ultë

gjuetia ilegale				universiteti dhe OJQ			
	4	Krijimi i programit për parandalimin e gjuetisë	MMPHI (AMMK-DAPKSH)	AMMK (INK)	***	BK	I ultë
3. Zhvillimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësi mit të popullatës për ta nxitur atë të mësojë më shumë rreth biodiversitetit dhe rëndësisë së kujdesit ndaj tij	1	Pasurimi i planprogrameve mësimore të shkollave fillore dhe të mesme me temat për biodiversitetin dhe përmes mësimit të këtyre temave, vetëdijesimi i nxënësve për rëndësinë e madhe që ka kujdesi ndaj biodiversitetit	Qeveria (MASHTI)	MASHTI, Kontraktori	**	BK	I ultë
	2	Organizimi vjetor i ekskurzioneve të nxënësve në parqet kombëtare dhe në zonat tjera të natyrës që janë nën mbrojtje të shtetit	Komunat	Komunat, Operatori i transportit	***	BK	I ultë
	3	Përgatitja e broshurave apo materialeve tjera për parqet kombëtare në Kosovë me qëllim të informimit dhe senzibilizimit të popullatës për rëndësinë e kujdesit ndaj tyre	MMPHI	MMPHI, Kontraktori	**	BK	I ultë
	4	Shfrytëzimi i mediave elektronike në funksion të informimit dhe senzibilizimit të popullatës për rëndësinë e kujdesit ndaj parkut, me theks të veçantë të informimit të investitorëve potencial se ku dhe çka mund të bëhet në park	MMPHI, Mediat elektronike dhe ato të shkruara	Mediat elektronike dhe ato të shkruara	***	BK, Nga mediat	I mesëm
	5	Realizimi i aktiviteteve të natyrave të ndryshme me banorët e vendbanimeve rreth parkut dhe me të gjithë që kanë prona në park, me qëllim të senzibilizimit të tyre për përkujdesjen ndaj parkut, sidomos duke i njoftuar ata me aktivitetet që lejohen dhe ato që nuk lejohen në park	Qeveria (MMPHI)	MMPHI, Institucione apo organizata të huaja, OJQ	***	BK, Nga Institucione apo organizata të huaja	I mesëm
4. Mbrojtja dhe ruajtja e rezervateve të natyrës, si dhe promovimi i tyre shkencor	1	Si në pikën 1.1 dhe 2.1	Qeveria (MMPHI-AMMK)	AMMK (DAPKSH)	*	BK	I ultë
	2	Hulumtime shkencore në zonat e rezervateve të natyrës	MMPHI (AMMK-DAPKSH)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga universiteti dhe OJQ	***	BK	I ultë
	3	Promovimi shkencor i projekteve nga humumtimet shkencore: harta, atllase, broshura, libra etj.	MMPHI (AMMK-DAPKSH)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga universiteti dhe OJQ	***	BK	I mesëm

5. Mbrojtja dhe ruajtja e ekosistemeve e dhe biodiversitetit në përgjithësi dhe e llojeve endemike, relikte dhe endemorelikte të bimëve, shtazëve dhe shpezëve në veçanti	1	Si në pikën 1.1 dhe 2.1			*	BK	
6. Shfrytëzimi i pasurive natyrore sipas planit të menaxhimit: prerjet sanitare të pyjeve dhe për ngrohje, vjelja e bimëve mjekësore dhe frutave, shfrytëzimi i kullosave dhe pejzazheve natyrore për rekreacion	1	Projekt studimi i zonave, përcaktimi i kufinjve, metodat e prerjes, lëshimi i lejeve dhe monitorimi i vazhdueshëm i zonave në PKSH që kanë arsye për prerje sanitare	MMPHI (AMMK, DAPKSH, INK)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga universiteti dhe OJQ	*	BK	I ultë
	2	Projekt studimi i zonave për vjelje të bimëve medicinale dhe frutave malore	MMPHI (AMMK, DAPKSH, INK)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga universiteti dhe OJQ	*	BK	I ultë
	3	Projekt studimi i zonave të kullosave: mënyra e shfrytëzimit, kufinj, numri i blegtorisë, stimulimi për blegtorë, taksa e ultë dhe monitorimi i vazhdueshëm	MMPHI (AMMK, DAPKSH, INK)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga universiteti dhe OJQ	***	BK	I mesëm
	4	Përcaktimi i zonave të pejzazheve dhe marshutave turistike, hartave, ndërtimi i pushimoreve të përkohshme, informimi i publikut me anët pozitive etj.	MMPHI (AMMK, DAPKSH, INK)	AMMK (DAPKSH, INK), operatorët turistik, profesionistë nga universiteti dhe OJQ	***	BK	I mesëm
7. Inventarizimi i i specieve të rrezikuara të botës bimore dhe shtazore, si dhe zhvillimi i programeve të monitorimit dhe hulumtimit	1	Projekt studimi i zonave për inventarizimin e specieve të rrezikuara të botës bimore dhe shtazore, si dhe zhvillimi i programeve të monitorimit dhe hulumtimit	MMPHI (AMMK, DAPKSH, INK)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga universiteti dhe OJQ	***	BK	I mesëm
	2	Publikimi rezultateve të arritura për hulumtimin e specieve të rrezikuara: Punime shkencore, revista shkencore, krijimi i atlasit me specie të rrezikuara	MMPHI (AMMK, DAPKSH, INK)	AMMK (DAPKSH, INK), profesionistë nga	***	BK	I mesëm

				universiteti dhe OJQ			
8. Mbrojtja, promovimi, mbarshtrimi dhe rritja e Qenit të Sharrit (Deltari Ilir) si simbol i Parkut Kombëtar "Sharri"	1	Financimi, zhvillimi dhe promovimi i projektit për mbarështrimin e Qenit të Sharrit	Qeveria (MBPZH R, MMPHI)	MBPZHR, MMPHI, Fakulteti i Veterinës, OJQ - kenologjisë dhe njohësit vendor	***	BK	I mesëm
	2	Ndërtimi brenda parkut i stacionit për mbarështrim dhe veterinarin për nevojat në park dhe rreth tij	MMPHI	MMPHI (AMMK), Kompania ndërtimore	*	BK	I mesëm
9. Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera	1	Hartimi i dokumentit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera në park që bazohet në Ligjin Nr.04/L-027, si dhe në Rregulloren Nr. 28/2012 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Zjarret, Rrëshqitjet, Erozionin dhe Ortekët	MMPHI, AME, PKSH	MMPHI (AMMK – DAPKSH)	**	BK	I mesëm
	2	Ndërtimi i pritave, mureve natyror, gardione për parandalimin e rrezikut nga erozioni dhe nga ortekët	MMPHI	Agjencia e Pyjeve të Kosovës, AMMK – DAPKSH, Kompania ndërtimore	***	BK	I lartë
	3	Hartimi i planit për mbrojtjen nga zjarret dhe ngritja e kapaciteteve të mjaftueshme me resurse njerëzore dhe logjistike	MMPHI (AMMK - DAPKSH), AME	MMPHI (AMMK - DAPKSH)	**	BK	I mesëm
10. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	1	Definimi i perimetrit dhe zonave mbrojtëse si dhe digjitalizimi i aseteve me TK (arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme, shpirtërore dhe peizazheve) të vendbanimeve në afërsi të parkut	MKRS (DTK), IMMK	MKRS (DTK), QRTK-të, MMPHI (IPH), Komuna	***	BK	I ulët
	2	Ndërtimi i rrugëve, shtigjeve dhe parkingjeve të nevojshme të cilat shpiejnë gjer te asetet me trashëgimi kulturore dhe natyrore, me qëllim të mbrojtjes së pyjeve nga prerjet e pakontrrolluara, nga zjarri, erozioni dhe orteku	Qeveria (MMPHI) Komuna	Komuna, investitori i caktuar, kompania për rrugë	***	BK, nga investitori	I lartë
	3	Krijimi i një sistemi të shenjëzimit me anë të paneleve informuese, hartave, fletëpalosjeve dhe broshurave, lidhur me rëndësinë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore e natyrore në park dhe vendbanimet në afërsi të tij	MMPHI (IPH, AMMK – IMNK, DAPKSH)	MMPHI (DAPKSH), MKRS, APK	*	BK	I ulët

4	Sigurimi i ndriçimit të zonave dhe asetëve me trashëgimi kulturore	Qeveria (MKRS, MMPHI, ME), KESCO	KESCO	**	BK, nga KESCO	I mesëm
5	Vetëdijesimi dhe informimi për parkun, me anë të përgatitjes së hartave, broshurave, fletëpalosjeve, reklamave dhe kalendarit për vizita turistike të monumenteve dhe tërësive me TK dhe TN që posedon parku dhe VB në afërsi të tij	MMPHI (AMMK, DMM, IPH), APK, MINT	AMMK (DAPKSH, IMNK), APK	*	BK	I ulët
6	Organizimi i aktiviteteve në formë të ekspozitave, panairëve, koncerteve, festave dhe projekteve ku mund të prezantohet trashëgimia kulturore përfshirë atë shpirtërore (zakonet, doket, ritet, vallet, muzika, kënga dhe shprehjet artistike-artizanatet, zejjet etj.)	Qeveria (MKRS, MMPHI, MINT)	MMPHI (DAPKSH), MKRS, komunitat	*	BK, donatorët	I ulët
7	Ndërtimi i një muzeu për parkun në të cilin do të prezantohen vlerat natyrore dhe kulturore (veshjet, armët, enë për ushqim, elementet dekorative, veglat e punës, ato muzikore, veglat e shtëpisë, si dhe ushqimi tradicional i këtyre anëve.)	Qeveria (MKRS, MMPHI)	MMPHI (DAPKSH), MKRS, komunitat	**	BK, donatorët	I mesëm
8	Përkrahja e projekteve që stimulojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale dhe kultivimin e gastronomisë tradicionale në kuadër të parkut dhe në vendbanimet në afërsi të tij	Qeveria (MBPZHR, MKRS)	MBPZHR, MKRS, komunitat	**	BK, donatorët	I mesëm
9	Specializimi i udhërrëfyesve turistik për vlerat natyrore, historike dhe kulturore të parkut të Sharrit dhe VB në afërsi të tij	Qeveria (MKRS, MMPHI, MINT)	MKRS, MMPHI (DAPKSH), MINT, Institucioni i specializuar	**	BK, donatorët	I ulët

Qëllimi 3

Park me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik

Objektivi	Veprimi/Masa/Projekti	Akterët vendim marrës	Akterët e zbatimit	Afat i kohor	Burimi financiar	Implikimi financiar	
1. Ngritja e kapaciteteve turistike dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese	1	Privatizimi i kapaciteteve hoteliere dhe infrastrukturës përcjellëse turistike në Brezovicë	Qeveria (MINT)	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	*	BK	I ultë
	2	Revitalizimi i qendrës turistike Brezovica dhe ngritja e infrastrukturës sportive sipas standardeve, pas privatizimit në qendrën turistike në Brezovicë	Partnerit et publik-privat (PPP)	MMPHI, MINT, Investitori privat, K. ndërtimore	**	BK, Investim privat	I lartë
	3	Krijimi dhe zbatimi i politikave stimuluuese për lidhjen e kontratave përmes partneritetit publik-privat (PPP), si në: investime dhe	Qeveria (MINT)	MINT, Investitori privat	*	BK, Investim privat	//

		shfrytëzim të kapaciteteve për kohë të caktuar, infrastrukturë, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e mbeturinave, transportin publik etj.					
	4	Ngritja e kampeve dhe organizimi i tyre duke i plotësuar të gjitha standardet infrastrukturore dhe përfshirja e tyre në hartën e turizmit	Komunat	Komunat dhe PPP	**	PPP	I mesëm
	5	Investime për përmirësimin e infrastrukturës së sportit dhe kulturës	Qeveria (MKRS)	MKRS	**	BK, donator	I mesëm
	6	Zhvillimi i produktit turistik dhe aktiviteteve, fillimisht duke përfshirë komunat që kanë pjesëmarrje direkte në park	MINT, Komunat	MINT, Komunat	*	BK	I ultë
	7	Investimi në promovim dhe informimin e saktë për kapacitetet akomoduese me të dhëna cilësore	MINT, Komunat	MINT, Komunat, ASK	*	BK	I ultë
	8	Inicimi i paketës stimuluese B&B, si njësi akomoduese për vizitorët në zonat rurale rreth parkut	Investitori privat, Komunat	Investitori privat	*	Investim privat	I ultë
	9	Organizimi i fshatit turistik si strukturë e organizuar në përputhje me standardet për zhvillimin e turizmit	MINT, Komunat DAPKSH	MINT, Komunat DAPKSH	**	BK	I mesëm
	10	Organizimi i trajnimeve të kulinarisë për gatimet tradicionale sipas kërkesave të turistëve	MINT, Komunat	MINT, Komunat, OJQ	*	BK, Donatori	I ultë
	11	Ofrimi i trajnimeve dhe edukimi i komunitetit dhe bizneseve lokale me theks të veçantë për gratë në industrinë turistike	MINT, Komunat	OJQ	*	BK	I ultë
	12	Ngritje të kapaciteteve njerëzore për industrinë turistike, duke përfshirë komunat që kanë pjesëmarrje direkte në park	MASHT, Komunat	MASHT, Komunat	***	BK	I mesëm
2. Zhvillimi i bujqësisë tradicionale, blegtorisë dhe bletarisë në funksion të zhvillimit të ekoturizmit nga banorët lokal	1	Hartimi i programit për ngritjen e vetëdijes së banorëve për mundësitë e kultivimit të bujqësisë organike në zonat brenda dhe për rreth parkut, sipas dispozitave të parapara në planin e menaxhimit të parkut	MBPZHR, Komunat	Komunat	*	BK	I ultë
	2	Mbështetje e vendbanimeve përreth parkut për të ofruar eko-prodhime tradicionale, standardizim të artikujve ushqimor dhe të tjerë artizanal me etiketë karakteristike të PK "Sharri" (krijimi i brendit identifikues)	MINT, MBPZHR, MZHR, Komunat	MINT, MBPZHR, MZHR, Komunat	**	BK	I mesëm
	3	Hartimi i broshurës për promovimin e prodhimeve unike tradicionale të këtyre zonave me logon e parkut	MINT, MBPZHR, MZHR	MBPZHR, DAPKSH	*	BK	I ultë
	4	Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë	MBPZHR, MZHR	MBPZHR, MZHR Komuna	**	BK	I ultë
	5	Krijimi i lehtësirave për kultivimin e blegtorisë dhe hapjen e fermave	MBPZHR, MZHR	MBPZHR	**	BK	I mesëm
	6	Asistim në aplikim për grante për hapjen e fermave dhe përmirësimin e teknologjisë për zhvillimin e turizmit rural	MBPZHR	MBPZHR	*	BK	I ultë

	7	Ngritja e pikave grumbulluese në afërsi të parkut me gjithë infrastrukturën e nevojshme, si dhe përcaktimi i një lokacioni të vetëm për tregun e agro-turizmit, i cili do të përcaktohet në bashkëpunim me komunën përkatëse dhe ekspertët e sektorit përkatës	MBPZHR, MZHR, Komunat	Komunat, PPP	**	BK, PPP	I mesëm
	8	Asistencë për ndihmë nga IPARD ³⁵ që është një instrument financimi për të ndihmuar fermerët që kanë nevojë dhe ide për rritjen e aktivitetit të tyre në bujqësi apo agro-turizëm	MZHR, MBPZHR	IPARD	*	BK, IPARD	I ultë
3. Shfrytëzimi i kontrolluar i bimëve mjekuese dhe aromatike (BMA) dhe pemëve frutore të egra (PFE) për përfitime ekonomike	1	Hartimi i rregullores për shfrytëzimin e qëndrueshëm të sipërfaqeve të caktuara, për mbledhjen e BMA dhe PFE, për çmimet si dhe afatin kohorë të vjeljes, e cila duhet të përfshihet në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar "Sharri"	AMMK (DAPKSH)	DAPKSH	*	BK	I ultë
	2	Hartimi i projektit për krijimin e një brendi për të gjitha produktet e prodhuara në "Sharr", qofshin bimë mjekuese, fruta të egra, apo produkte bujqësore, blegtorale etj.	MBPZHR, MZHR	MBPZHR	*	BK	I ultë
	3	Ofrimi i lehtësirave për hapjen e pikave grumbulluese për trajtimin dhe ruajtjen e bimëve mjekuese dhe aromatike (BMA) dhe pemëve frutore të egra (PFE)	MBPZHR, MZHR	Komunat	*	PPP	I mesëm
	4	Kontrolli i shfrytëzimit të kullosave, livadheve dhe vjeljes së BMA dhe PFE nga zyrtarët kompetent të parkut	DAPKSH	DAPKSH	***	BK	//
	5	Përkrahje financiare për fermerët që merren me kultivimin e BMA dhe PFE, që t'iu ofrojnë mundësi turistëve të angazhohen në mbledhjen e frutave malore dhe bimëve mjekuese	MBPZHR, MZHR	MBPZHR, PPP	*	BK, Investitori privat	I mesëm
	6	Bashkëpunimi mes fermerëve dhe pronarëve të restoranteve/hoteleve në PK "Sharri" për mundësitë e diversifikimit të shërbimeve të tyre, duke ju ofruar vizitorëve mbledhjen e frutave malore dhe në të njëjtën kohë t'i përjetojnë bukuritë e natyrës	MZHR	MZHR	*	BK	I mesëm
4. Krijimi i kushteve që banorët lokal të punësohen në industrinë turistike	1	Ofrimi i trajnimeve dhe edukimi i komunitetit dhe bizneseve lokale me theks të veçantë për gratë në industrinë turistike	Komunat	Komunat, OJQ	***	BK	I mesëm
	2	Mbështetja e bizneseve lokale, si dyqanet artizanale dhe tregjet tradicionale, në mënyrë që të inkurajohen turistët të blejnë produkte të zonës	MINT, Komunat	Komunat	**	BK	I mesëm

³⁵ IPARD - Instrumenti i Asistencës së Para - Aderimit për Zhvillim Rural

	3	Ngritja e pazareve të vogla apo tezgave në zonat e zhvillimit për ofrimin e produkteve karakteristike të zonës	Komunat DAPKSH	Komunat	*	BK	I mesëm
	4	Partneriteti me organizatat lokale, si bordet e turizmit dhe organizatat joqeveritare, për të mbështetur zhvillimin e turizmit rural	MINT, Komunat DAPKSH	MINT, OJQ, MBPZHR, Kompanitë turistike	*	BK, PPP	I ultë
	5	Angazhimi dhe përfshirja e komuniteteve në zhvillimin e promovimit të turizmit lokal dhe inkurajimi i njerëzve për të vizituar zonat rurale dhe të përjetojnë kulturën, ushqimin dhe traditat lokale	MINT, MBPZHR, Komunat	OJQ	*	BK	I ultë
	6	Vetëdijesim i banorëve duke u bazuar në praktika të mira nga rajoni dhe bota, si dhe për përfitimet e mundshme nga menaxhimi ekologjik i parkut për përdorimin e materialeve të riciklueshme dhe kujdesit ndaj mbetjeve etj.	MINT, MBPZHR, Komunat	OJQ	*	BK	I ultë
	7	Hartimi i projekteve për kualifikimin e banorëve në ofrimin e shërbimeve turistike, të mikpritjes dhe informatave rreth organizimit dhe mirëmbajtjes së bujtinave si dhe aktivitete tjera të mundshme si: shëtitje, çiklizëm, lojëra tradicionale etj.	MINT, MBPZHR, Komunat	MINT, MBPZHR, MPMS, OJQ	*	BK	I ultë
	8	Identifikimi dhe adoptimi i staneve për ti kthyer në bujtina për promovimin e ekoturizmit, turizmit shëndetësor dhe agroturizmit në park	Komuna, DAPKSH	Komuna, DAPKSH	**	BK PPP	I mesëm
	9	Ofrimi i lehtësimeve në tatim për stimulimin e banorëve lokal dhe përfshirjen në industrinë turistike për të ndikuar në ofertën turistike lokale	MF, Komunat	Komunat	*	BK	I mesëm
	10	Mbështetje në themelimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për industrinë turistike	MINT	MINT	*	BK	I ultë
5. Zhvillime të planifikuara me banim cilësor (vikend shtëpi) dhe ndërtime të kontrolluara , që janë në harmoni me mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe	1	Identifikimi/inventarizimi i të gjitha objekteve ndërtimore në zonën e mbrojtur të parkut, klasifikimi i ndërtimeve pa leje (pronë private dhe publike apo në zonën e II-të dhe të III-të) ³⁶ dhe trajtimi i tyre sipas procesit të legalizimit	MMPHI (DAPKSH)	MMPHI (DAPKSH), Komunat	*	BK	I ultë
	2	Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm (PRrH) për qendrën turistike në Brezovicë	MMPHI, Komuna e Shtërpcës	Komuna e Shtërpcës	*	BK	I ultë
	3	Hartimi i PRrH për qendrën turistike në Prevallë	MMPHI, Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	*	BK	I ultë

³⁶ PHPK "Sharri" - Prishtinë, Tetor, 2013

biodiversitetit	4	Hartimi i PRrH për qendrën turistike në Komunën e Suharekës	MMPHI, Komuna e Suharekës	Komuna e Suharekës	*	BK	I ultë	
	5	Hartimi i PRrH për qendrën turistike në Komunën e Dragashit	MMPHI, Komuna e Dragashit	Komuna e Dragashit	*	BK	I ultë	
	6	Hartimi i PRrH për qendrën turistike në Komunën e Kaçanikut	MMPHI, Komuna e Kaçanikut	Komuna e Kaçanikut	*	BK	I ultë	
	7	Përgatitja e raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis për zhvillimet në park	MMPHI, Komuna	MMPHI, Komuna, PPP	*	BK	I ultë	
	8	Hartimi i programit të veçantë për përcaktimin e kritereve dhe masave të nevojshme për mbrojtjen e florës dhe faunës në park gjatë fazës së ndërtimit dhe pas tij	MMPHI	Komunat, DAPKSH	*	BK	//	
	9	Definimi i organeve kompetente për lëshimin e lejeve ndërtimore sipas kategorisë së ndërtimit dhe për koordinimin e inspektimeve ndërtimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi	MMPHI	MMPHI, Komuna	*	BK	//	
	10	Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve të nivelit lokal dhe nivelit qendror për monitorimin dhe kontrollin e zhvillimeve sipas planeve rregulluese të hollësishme brenda parkut	MMPHI, Komunat	MMPHI, Komunat	***	BK	//	
	6. Shërbime shëndetësore e të kualitetit të lartë	1	Ngritja e punkteve ambulatore në afërsi të qendrave turistike si: Brezovica, Prevala, Luboteni dhe Brodi, për ofrimin e shërbimeve emergjente të ndihmës së parë	MSH, Komunat	MSH, Komunat	*	BK	I mesëm
		2	Ngritja e ndërtesave të punkteve të mjekësisë familjare (PMF), sipas nevojës duke respektuar distancën prej 3km, në fshatrat përreth parkut për nevoja të vizitorëve dhe banorëve lokal	MSH, Komunat	MSH, Komunat	*	BK	I mesëm
		3	Rritja e stafit në qendrat regjionale të komunave që kanë qasje direkte në park, për ofrimin e shërbimeve të emergjencave/ambulancat mobile	MSH, Komunat	Komunat	*	BK	I ulët
4		Vendosja e tabelave për informim lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe emergjente	MSH, DAPKSH	DAPKSH	*	BK	I ulët	
5		Sigurimi i shërbimeve shëndetësore dhe i qasjes së lehtë për personat me nevoja të veçanta	MSH, Komunat	MSH, Komunat	*	BK	I ulët	
7. Sigurimi i burimeve financiare dhe teknike nga	1	Identifikimi i projekteve zhvillimore për parkun dhe identifikimi i burimeve apo organizatave nga të cilat do të mund të financoheshin këto projekte	Qeveria (ministrit ë sipas projekte	Qeveria (ministritë sipas projekteve) komunat	**	BK	I ulët	

organizatat ndërkombëtare dhe partnerët rajonal për të ndihmuar në zhvillimin dhe menaxhimin e parkut kombëtar	2	Kontaktimi i organizatave dhe i partnerëve rajonal dhe konkurimi tek ata për financimin e projekteve zhvillimore për parkun	ve), komunat	Qeveria (ministrit ë sipas projekteve), komunat	Qeveria (ministritë sipas projekteve) komunat	***	BK	I ulët
	3	Konkurimi për fondet ndërkombëtare me projekte të përbashkëta të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore për zonën ndërkufitare të Malit Sharr	Qeveria (ministrit ë sipas projekteve), komunat	Qeveria (ministritë sipas projekteve) komunat	***	BK	I ulët	

Qëllimi 4

Park në të cilin janë të siguruara qasja e lehtë në hapësirat dhe objektet e parkut, si dhe shërbimet publike për banorët

Objektivi	Veprimi/Masa/Projekti	Akterët vendim - marrës	Akterët e zbatimit	Afat i kohor	Burimi financiar	Implikimi financiar	
1. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe përmirësimi i transportit publik	1	Përmirësimi i shtigjeve ekzistuese dhe ndërtimi i shtigjeve të reja për ecje dhe çiklizëm	Qeveria (MMPHI) Komuna	Komuna; Investitori i caktuar; Kompania për rrugë	***	BK; Nga investitori	I lartë
	2	Ndërtimi i pikave të pushimit në çdo kilometër përgjatë shtigjeve për ecje	Qeveria (MMPHI) Komuna	Komuna; Investitori i caktuar; Kompania për rrugë	***	BK; Nga investitori	I ultë
	3	Ndërtimi i rrugës automobilistike në relacionin Prizren – Tetovë dhe tunelit nëpër të cilin ajo kalon nën sipërfaqen e parkut	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI); Investitori i caktuar; Kompania për rrugë	***	BK; Nga investitori	I lartë
	4	Asfaltimi i rrugës R118 në segmentin Delloç – Vërbeshticë	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI); Kompania për rrugë	**	BK	I lartë
	5	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidh lokacionin Moqurishte në veri të parkut kombëtar (Komuna e Therandës) në të cilin do të ketë ndërtime në funksion të pushimit, rekreimit dhe rehabilitimit shëndetësor me rrugën R118	Qeveria (MMPHI) Komuna	Komuna; Kompania për rrugë	**	BK	I lartë
	6	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Orçushë me Kuksin në Shqipëri	Qeveria (MMPHI) Komuna	Komuna; Kompania për rrugë	**	BK	I lartë
	7	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë lokacionin Nënahishte (komuna e Kaçanikut), ku do të ketë ndërtime në funksion të pushimit dhe rekreimit, me rrugën regionale R116	Qeveria (MMPHI) Komuna	Komuna; Kompania për rrugë	**	BK	I lartë
	8	Ndërtimi i infrastruktures së nevojshme për funksionalizimin e	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI);	*	BK	I mesëm

		vendkalimeve kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut		Kompania ndërtuese			
	9	Ndërtimi i parkingjeve në hyrje-daljet e parkut dhe në vendet me kapacitete turistike	Qeveria (MMPHI) Komunat	Komunat; Kompania ndërtuese	**	BK	I ultë
	10	Vendosja e linjave të rregullta të transportit publik deri tek të gjitha hapësirat në park me përmbajtje të rëndësishme siç mund të jenë ski qendrat me hotele dhe infrastrukturë përcjellëse	Qeveria (MMPHI) Komunat	Qeveria (MMPHI) Komuna; Operatori i transportit	**	BK; Nga investitori	I mesëm
	11	Vendosja e linjave të rregullta të transportit publik në mes të vendbanimeve për rreth parkut	Qeveria (MMPHI) Komunat	Qeveria (MMPHI) Komuna; Operatori i transportit	**	BK; Nga investitori	I mesëm
2. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së energjisë elektrike	1	Realizimi i një studimi me parashikimin për sasinë e energjisë elektrike të nevojshme për furnizimin e parkut në 10 vjetët e ardhshëm duke i përfshirë këtu edhe veprimet e nevojshme për sigurimin e kësaj sasive	Qeveria (ME, MMPHI)	Qeveria (ME); Investitori i caktuar ; Kompania që e bën studimin	*	BK; Nga investitori	I ultë
	2	Realizimi i një studimi për gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve alternative, të ripërtërishe të energjisë	Qeveria (ME, MMPHI)	Qeveria (ME); Investitori i caktuar; Kompania që e bën studimin	*	BK; Nga investitori	I ultë
	3	Ndërtimi i linjave të reja furnizuese 10 kV gjegjësisht 0.4 kV me trafostacione përcjellës	Qeveria (ME); KEDS	KEDS	***	BK; Nga KEDS	I mesëm
	4	Zëvendësimi i linjave ajrore me ato kablore nëntokësore	Qeveria (ME); KEDS	KEDS	***	BK; Nga KEDS	I mesëm
	5	Rekonstruktimi-përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes dhe trafove ekzistues, vendosja-instalimi i trafove të rinj, të gjitha në bazë të studimit nën pikën 1	Qeveria (ME); KEDS	KEDS	***	BK; Nga KEDS	I lartë
	6	Sigurimi i ndriçimit publik në park dhe në vendbanimet rreth tij	Qeveria (MMPHI, ME); KESCO	KESCO	*	BK; Nga KESCO	I ultë
3. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës ujore	1	Realizimi i studimit për burimet e ujërave nëntokësor që figurojnë në librin e kadastrit, në mënyrë që të konstatohet se cilat nga këto burime do të mund të shfrytëzoheshin për furnizimin e parkut dhe të vendbanimeve rreth tij me ujë të pijshëm	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI); Investitori i caktuar; Kompania që e bën studimin	*	BK; Nga investitori	I ultë
	2	Hulumtimi i burimeve të reja të ujërave nëntokësor	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI); Investitori privat;	*	BK; Nga investitori	I ultë

				Kompania që e bën hulumtimin			
	3	Instalimi i sistemeve publik të ujësjellësit që menaxhohen nga kompanitë rajonale të ujësjellësit në hapësirat e ndërtuara brenda parkut dhe në vendbanimet rreth parkut ku këta sisteme nuk ekzistojnë aktualisht	MMPHI (Autoriteti i Pellgut Lumor); Komunitat	MMPHI (Autoriteti i Pellgut Lumor); Komunitat rajonale të ujësjellësit	**	BK; Nga Kompanitë rajonale të ujësjellësit (KRU)	I mesëm
	4	Instalimi i sistemeve publik të kanalizimit të ujërave të zeza që menaxhohen nga kompanitë rajonale të ujësjellësit në hapësirat e ndërtuara brenda parkut dhe në vendbanimet rreth parkut ku këta sisteme nuk ekzistojnë aktualisht	MMPHI (Autoriteti i Pellgut Lumor); Komunitat	MMPHI (Autoriteti i Pellgut Lumor); Komunitat; KRU	**	BK; Nga KRU	I mesëm
	5	Ndërtimi i impianteve për pastrimin e ujërave të zeza dhe të kolektorëve që mbledhin ujërat e zeza dhe i dërgojnë deri tek impianti	Qeveria (MMPHI/AMMK)	MMPHI (AMMK); Investitori i caktuar; KRU	**	BK; Nga investitori	I mesëm
	6	Realizimi i studimit të arësyeshmërisë për krijimin e liqeneve në Semajë, Brod (komuna e Shtërpces) dhe Reçan që do të furnizonin me ujë të pijshëm kapacitetet e parkut kombëtar dhe vendbanimet rreth parkut	Qeveria (MMPHI)	Qeveria (MMPHI); Investitori i caktuar; Kompania që e bën studimin	*	BK; Nga investitori	I ultë
4. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së telekomunikacionit	1	Mbulimi i tërë hapësirës së parkut dhe të vendbanimeve rreth tij me sinjalin e telefonisë mobile GSM	Qeveria (ME); Telekomunikacioni i Kosovës (TK); Kompania private e telekomunikacionit (KPT)	TK; KPT	*	BK; Nga TK dhe KPT	I mesëm
	2	Instalimi i linjës telefonike kablore nëntokësore për sjelljen e signalit të telefonisë fikse tek kapacitetet turistike në park	Qeveria (ME); TK; KPT	TK; KPT	**	BK; Nga TK dhe KPT	I mesëm
	3	Vendosja e punkteve postare në vendet me kapacitetet turistike	Qeveria (ME); Posta e Kosovës	Posta e Kosovës	*	BK; Nga Posta e Kosovës	I ultë
5. Sigurimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i mbeturinave	1	Kontraktimi i operatorit që do të menaxhojë me mbeturinat në park	MMPHI	MMPHI	*	BK	I ultë
	2	Vendosja e paisjeve për menaxhimin e mbeturinave në vendet ku ka kapacitete turistike dhe në të gjitha hapësirat në park të cilat frekuentohen nga vizitorët	MMPHI	Operatori për administrimin e mbeturinave	*	BK	I ultë

Vërejtje: Implikimi financiar mund të jetë: I ultë – deri në 500000 €; I mesëm – 500000 deri në 5000000 €; dhe I lartë – mbi 5000000 €. Simbolet për afatin kohor kanë domethënjën: *(0-3 vjet); **(3-7 vjet); dhe *** (mbi 7 vjet).

10. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Dispozitat për zbatim përmbajnë kushtet dhe masat me karakter obligativ që respektivisht duhet të plotësohen dhe të ndërmerren gjatë zbatimit të planit hapësinor. Këto dispozita e drejtojnë zbatimin e planit.

10.1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Sharri" (në tekstin e mëtejshëm: plani) i definon caqet e rregullimit/planifikimit të territorit/hapësirës, organizimit dhe destinimit të territorit/ hapësirës, i përcakton kushtet dhe masat e shfrytëzimit, rregullimit dhe mbrojtjes së parkut;
2. Plani Hapësinor i PK "Sharri" mbulon periudhën kohore prej minimum dhjetë vitesh nga aprovimi përfundimtar në Kuvendin e Kosovës;
3. Rishikimi i planit bëhet pas pesë vitesh, por mund të bëhet edhe në periudhë më të shkurtër varësisht nga kërkesa esenciale për ndryshime në terren;
4. Me dispozitat për zbatim të planit definohet mënyra e rregullimit të hapësirës dhe e ndërtimit në territorin/sipërfaqen e parkut;
5. Të gjitha planet tjera të niveleve më të ulëta me ndikim në territorin e parkut, i nënshtrohen Planit Hapësinor të PK "Sharri";
6. Ky dokument hyn në fuqi pasi të jetë aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Sipërfaqja e parkut

Sipas Ligjit Nr. 04/L - 087 për Parkun Kombëtar "Sharri", sipërfaqja e parkut është 53469 ha. Gjatë procesit të hartimit të planit hapësinor për PK "Sharri" është konstatuar se sipërfaqja e parkut në fjalë është 53273ha. Sipas vlerësimit tonë, dallimi në mes sipërfaqeve është si rrjedhojë e gabimit teknik në të shkruar dhe jo si rezultat i projeksioneve të aplikuara WGS84 ose KosovaRef. Prandaj të gjitha analizat dhe shqyrtimet e temave, çështjeve dhe veprimeve në dokument janë realizuar duke u bazuar në sipërfaqen prej 53273 ha.

10.2. DISPOZITAT PËR PËRGJEGJËSITË E MINISTRISË

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) është përgjegjëse për hartimin, revidimin, monitorimin dhe zbatimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri".
2. Ministria përcakton autoritetin përgjegjës për administrimin e parkut, e përcakton përbërjen dhe buxhetin e nevojshëm për funksionimin e autoritetit.
3. Ministria është përgjegjëse për ndarjen e fondeve për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" (DAPKSH).
4. Ministria është përgjegjëse për nxjerrjen e rregullores për rendin e brendshëm të funksionimit për Parkun Kombëtar "Sharri".
5. Ministria është përgjegjëse për dhënien e lejeve të ndërtimit për objektet e kategorisë së III-të të ndërtimit.
6. Ministria është përgjegjëse për dhënien e pëlqimit për planet rregullues të hollësishëm ose zgjidhjet urbane të propozuara nga investitori kur ato hartohen brenda zonës së III-të, para se të njëjtat të aprovohen nga autoritetet përkatëse komunale.

10.3. DISPOZITAT PËR PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE KOMUNALE

1. Autoritetet komunale që përfshihen në territorin e parkut (Prizreni, Shtërpce, Dragashi, Suhareka dhe Kaçaniku), përpos përgjegjësisë të parapara në bazën ligjore në fuqi, janë përgjegjëse edhe për:

- a. Pjesëmarrje aktive në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të parkut;
- b. Respektimin e rregullave të parapara dhe të nxjerra nga autoritetet qendrore, duke i përfshirë edhe rregullat e nxjerra nga DAPKSH;
- c. Lëshimin e lejeve të ndërtimit në zonën e III-të për objektet e kategorisë së I-rë dhe të II-të të ndërtimit sipas dispozitave/kushteve të ndërtimit të përcaktuara në këtë plan. Në rast se dispozitat/kushtet e ndërtimit nuk janë të mjaftueshme, komunitat me përkrahjen e Ministrisë mund të fillojnë iniciativën e hartimit të planit rregullues të hollësishëm ose kushtet shtesë mund të plotësohen edhe në bazë të zgjidhjes urbane që propozohet nga investitori.
- d. Në të dy rastet, plani rregullues i hollësishëm dhe zgjidhja urbane e ofruar nga investitori duhet të pajisen me pëlqim nga Ministria, para se të bëhet aprovimi i tyre përfundimtar nga komunitat përkatëse.

10.4. DISPOZITAT PËR PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRIMIN E PARKUT

1. Autoritet përgjegjës për administrimin e parkut është Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” (DAPKSH);
2. Përpos përgjegjësive që dalin nga baza ligjore në fuqi, DAPKSH është përgjegjëse edhe për:
 - a. Zbatimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri” duke përfshirë masat për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe shfrytëzimin e qendrueshëm të parkut;
 - b. Përkujdesje ndaj mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së parkut duke e plotësuar rregullisht dokumentin (kronikën) e parkut, e cila përmban kryesisht të dhëna mbi faktorët natyrorë, llojin dhe vëllimin e punimeve në park, gjendjen dhe ndryshimet në florë dhe faunë, qarkullimin pikniko – turistik, si dhe organizimin dhe drejtimin e faktorëve tjerë domethënës për parkun;
 - c. Nxitjen dhe krijimin e përmbajtjeve natyrore-shkencore, koleksioneve etnografike, kopshtit botanik, nxitë hulumtimet shkencore dhe udhëheq punën edukative-arsimore me të rinjtë gjatë ekskursioneve të prirë nga ekspertë profesional;
 - d. Nxitjen e revitalizimit të vendbanimeve rurale dhe ndihmon përfshirjen e banorëve autokton në ngritjen e ofertës turistike të parkut, në pajtim me orientimet e këtij plani;
 - e. Përgatitjen e ofertës turistike për zonën në të cilën specifikohen: kushtet për vizitat, vizitat e kontrolluara, orientimi për lëvizjen nëpër shtigjet e këmbësorëve, informatat për vlerat e parkut dhe për ruajtjen e tyre;
 - f. Ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të plotë informativ për tërë zonën, të dizajnuar në mënyrë të veçantë në përputhje me kërkesat dhe specifikat;
 - g. Inicimin dhe hartimin e planit për menaxhimin e parkut, në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi;
 - h. Përcaktimin e simbolit (shenjës/logos) mbrojtës të parkut, i cili duhet të prezantojë elementet karakteristike të parkut dhe përmbajtjet kryesore të tij, duke përfshirë edhe elementet shumë të njohur tradicional që e bëjnë këtë zonë shumë të veçantë.

10.5. DISPOZITAT DHE KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN DHE PËRKUFIZIMIN E HAPËSIRAVE/OBJEKTEVE PUBLIKE

1. Caktimi i hapësirave/objekteve publike duhet të jetë në harmoni me kushtet e mbrojtjes së mjedisit, ngritjes së kualitetit të jetesës, mos rrezikimit të shëndetit të popullatës dhe shfrytëzimit racional të territorit dhe të resurseve natyrore.
2. Në kuadër të këtyre sipërfaqeve bëjnë pjesë: objektet shkollore, objektet shëndetësore, të cilat duhet të caktohen në zonën e tretë sipas regjimit të mbrojtjes në park, rrugët e niveleve të ndryshme, shtigje për ecje, çiklizëm apo kalërim, shtigje për skijim, ski-lifta dhe teleferikë, shtyllat për transmisionin e valëve të telefonisë mobile, parkingjet e përbashkëta dhe hapësirat tjera që janë në shërbim të përgjithshëm, të cilat mund të planifikohen edhe në zonën e dytë.

3. Objektet e arsimit fillor duhet të vendosen brenda sipërfaqeve të destinuara për banim ose në afërsi të tyre, në përputhje me normat dhe standardet në fuqi. Hapësirat ku janë të vendosura këto objekte duhet të kufizohen me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik. Ngastrat e dedikuara për këto objekte duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Institucionet parashkollore 20 - 40 m²/fëmijë;
- b. Shkollat fillore 20 - 50 m²/fëmijë;

4. Në kuadër të oborrit shkollor duhet të sigurohet hapësirë e lirë e mjaftueshme, në përputhje me normat dhe standardet në fuqi.

5. Sipërfaqet që destinohen për veprimtari tregtare – furnizim të popullatës me mallra të konsumit të përditshëm, duhet të jenë brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre.

6. Përparësi në përcaktimin e lokacionit për hapësirat/objektet publike kanë zonat ku ekziston infrastruktura e domosdoshme teknike si: qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, ujësjellësi e kanalizimi dhe shërbimet tjera.

7. Ndërtimi në sipërfaqet publike dhe në ato me destinime tjera duhet të bëhet sipas parametrave urbanistik, arkitektonik dhe teknik që caktohen me këtë plan hapësinor, me planet rregulluese të hollësishme dhe në bazë të zgjidhjeve urbanistike/arkitektonike të ofruara nga investitorët.

10.6. PROCEDURA PËR MARRJEN E LEJES SË NDËRTIMIT

1. Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë i miratuar në Kuvendin e Kosovës, me shkresë përcjellëse i dorëzohet të gjitha komunave pjesëmarrëse, territori i të cilave është pjesë e kësaj zone. Të dhënat e dokumentit duke i përfshirë edhe hartat përkatëse do të shfrytëzohen nga autoritetet komunale për përcaktimin e kushteve dhe dhënien e lejeve përkatëse të ndërtimit.

2. Hapi i parë është shqyrtimi i kërkesës për ndërtim e cila bëhet sipas kompetencave:

- o Ministria – Për objektet e kategorisë së III-të të ndërtimit; dhe
- o Komuna – Për objektet e kategorisë së parë dhe të dytë të ndërtimit.

3. Autoritetet përgjegjëse si në nivelin qendror dhe atë lokal duhet të dallojnë nëse kërkesa është nën kompetencën e tyre, në mënyrë që e njëjta të drejtohet në adresën adekuate, nga komuna në Ministri ose anasjelltas nga Ministria në komunën përkatëse.

4. Nëse kushtet ndërtimore të përcaktuara me këtë plan hapësinor janë të mjaftueshme, ka informata të qarta për të realizuar projekt idenë, nga aplikuesi kërkohet të verifikohet nëse për projekt idenë duhet të hartohet raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM).

5. Nëse po, investitori obligohet të hartojë raportin e VNM dhe për të njëjtin të kërkojë pëlqim/aprovim nga Ministria.

6. Nëse jo, vazhdohet me hapat më tutje.

7. Në ndërkohë investitori duhet të aplikojë dhe të pajiset me të gjitha lejet dhe pëlqimet tjera të nevojshme për projektin, të cilat janë parakusht përfundimtar për tu pajisur me lejen e ndërtimit brenda parkut nga:

- o Ministria – Për objektet e kategorisë së III-të të ndërtimit; dhe
- o Komuna – Për objektet e kategorisë I-rë dhe të II-të të ndërtimit.

8. Në rastet kur për një zonë përkatëse kushtet e përcaktuara me këtë plan hapësinor nuk janë të mjaftueshme, e poashtu për atë zonë nuk ka plan rregullues të hollësishëm, investitori i propozon kushtet ndërtimore për parcelën e vet, duke e përfshirë edhe zonën me diametër prej 50m' nga kufinj të parcelës.

9. Sipas nevojës, kushtet ndërtimore duhet të kërkohen edhe nga sektorët tjerë relevant (infrastruktura rrugore, energjia, uji, bujqësia, pylltaria, trashëgimia kulturore dhe natyrore, etj.).

10. Bazë për fillimin e hartimit të PRRH-së ose zgjidhjes së propozuar nga investitori, duhet të jenë dispozitat për zbatim të këtij plani.

11. Planet rregullues të hollësishëm ose zgjidhjet e propozuara nga investitori hartohen për sipërfaqe të caktuara në zonën e III-të parkut, të përcaktuara me këtë plan hapësinor të parkut. Sipërfaqja për të cilën duhet të hartohet PRrH ose të ofrohet zgjidhja urbane nga investitori mund të përfshijë edhe hapësira të zonës së dytë të parkut që ndodhen në afërsi të sipërfaqes. Në këto raste zona e dytë mund të shfrytëzohet vetëm për aktivitetet sipas kushteve të përcaktuara për zonën në fjalë.

12. Për çdo sipërfaqe për të cilën duhet të hartohet PRrH ose të ofrohet zgjidhja urbane nga investitori, paraprakisht duhet të bëhen matjet gjeodezike ose rievimi përkatës aerofotogrametrik.

13. Plani rregullues i hollësishëm ose zgjidhja e propozuar nga investitori aprovohen në kuvendin komunal të komunës përkatëse.

14. Para aprovimit, plani rregullues i hollësishëm ose zgjidhja e propozuar nga investitori merr pëlqimin nga Ministria.

15. Pëlqimi për PRrH merret, pasi Ministria të bëjë verifikimin nëse PRrH ose zgjidhja e propozuar nga investitori është në harmoni me synimet, objektivat dhe dispozitat për zbatim të këtij plani hapësinor.

16. Pas aprovimit të kushteve ndërtimore dhe marrjes së të gjitha lejeve dhe pëlqimeve tjera të nevojshme, mund të lëshohet leja e ndërtimit brenda parkut kombëtar nga:

- o Ministria – Për objektet e kategorisë së III-të të ndërtimit;
- o Komuna – Për objektet e kategorisë I-rë dhe të II-të të ndërtimit

10.7. PROCEDURAT PËR MARRJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS PUBLIKE

Me rregulloren për funksionimin e brendshëm të Parkut Kombëtar “Sharri” do të përcaktohen procedurat për shfrytëzim të pronës publike për personat fizik dhe juridik. Rregullorja në fjalë në mes tjerash do të përmbajë: Aktivitetin që do të ushtrojnë personat fizik dhe juridik në pronën e paluajtshme publike; Përshkrimin e pronës së paluajtshme të dhënë në shfrytëzim; Periudhën kohore dhe lokacionin e pronës së dhënë në shfrytëzim; Ndërprerjen e mundshme të parakohshme të marrëveshjes për shfrytëzim; Obligimet e palëve të pronës së paluajtshme pas afatit të shfrytëzimit etj.

10.8. NDËRTIMET EKZISTUESE

Ndërtimet ekzistuese në kuadër të parkut, të identifikuar në ortofoto dhe në bazë të raporteve të hartuara nga drejtorja e parkut do të jenë subjekt i ligjeve përkatëse, duke përfshirë edhe Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

10.9. KUSHTET SPECIFIKE TË NDËRTIMIT

1. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore në park për objektet familjare nuk mund të jetë më e vogël se **1000 m² (10 ari)** ndërsa për objektet hoteliere sipërfaqja e parcelës përcaktohet me PRrH ose me kushte të përcaktuara nga investitori.

2. Sipërfaqja e ndërtuar (shputa) e parcelës mund të jetë deri në 10 % nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore.

3. Fasadat e ndërtesave në park duhet të jenë të punuara nga guri, druri, tullat dhe materiale tjera natyrore.

4. Ndërtimi i rrethojave për përkufizimin e parcelës duhet të bëhet nga materialet natyrore (gardh i gjallë, druri dhe guri) duke mënjanuar hekurin dhe betonin si mundësi, me lartësi maksimale prej 1.2 m.

5. Në rastet e rindërtimit nuk lejohet ndryshimi i gabariteve në kundërshtim me planin rregullues të hollësishëm ose të lejes ekzistuese të ndërtimit;


6. Në park mund të ketë rekonstruktime në kuptim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe të punës, sikurse që janë ripërtëritja e amvisërive fshatare, të bujqësisë tradicionale për involvim në turizëm rural;

7. Rekonstruktimi i objekteve individuale dhe të amvisërisë, duhet t'i nënshtrohet procedurave të njëjta sikur ato për ndërtime të reja;


8. Përveç ndërtesave publike, tek të tjerat rekomandohet që kulmet të jenë dyujorësh, me rënie prej 30 - 60 shkallë, me strehë të mbështjellë me dërrasa, shindër apo ndonjë material të ngjashëm nga të gjitha anët;

9. Në varësi të hyrjes në objekt (ekuivalente me kotën zero), lartësia maksimale e objekteve familjare duhet të jetë B+P+NK për terrenet me pjerrësi të vogël deri në 30° (maksimum dy etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin), ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe (më shumë se 30°) lartësia maksimale duhet të jetë B+S+P+NK si në skicën e mëposhtme.

Objektet familjare



Objektet hoteliere



Skica – Rregullat për etazhitetin e objekteve

Lartësia maksimale e objekteve hoteliere duhet të jetë: për terrenet me pjerrësi të vogël B+P+2+NK, ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe B+S+P+1+NK dhe B+S+P+3+NK në rastet kur objekti është i vendosur në mënyrë terrasore si në skicën e mësipërme (maksimum pesë etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin). Në të gjitha rastet lartësia e bodrumit do të varet nga pjerrësia e terrenit. Sa më e madhe pjerrësia aq më e lartë do të jetë lartësia e bodrumit, por jo më shumë se dy etazhe, njëra nga të cilat mund të shfrytëzohet si suterren (S)³⁷.

10. Vendosja e objekteve të bëhet në distancë jo më të vogël se 3,5m' nga vija kufizuese e parcelës ndërtimore. Në rastet kur kjo dispozitë nuk është e mundur duhet të aplikohen kushtet e përcaktuara me plan paraprak.

³⁷ Suterren është etazhi i cili me më pak se ½ e lartësisë është vendosur nën tokë.

11. Në rast të rekonstruktimit të objekteve ekzistuese të banimit është i mundur ndërrimi i destinimit në funksion të parkut kombëtar dhe/ose për nevoja të turizmit rural. Objektet ekzistuese mund të rekonstruktohen dhe zëvendësohen në pajtim me normat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të cilat nënkuptojnë përdorimin e materialeve dhe formësimit të hapësirave në mënyrë tradicionale autoktone duke ruajtur tiparet burimore.

12. Me rekonstruktimit të objekteve të lartpërmendura, sipas dispozitave nënkuptohet: rindërtim i objektit të banimit, rindërtimi i objektit të stallës, rindërtimi i pjesës konstruktive të vjetër të objektit, adaptimi dhe rindërtimi i hapësirave sanitare, ndërtimi i gropës septike të padepërtueshme, riorganizimi funksional i brendshëm i objektit të banimit dhe riorganizimi funksional i pjesëve ndihmëse të objektit të banimit.

13. Të gjitha objektet publike mund të rekonstruktohen në gabarin dhe formën arkitektonike ekzistuese, bazuar në projektin e aprovuar. Rekonstruktimi duhet t'i nënshtrohet procedurave të njëjta sikur ato për ndërtime të reja.

14. Kushtet e tjera të nevojshme mund të caktohen në bazë të PRRH ose të propozohen nga investitorët, të aprovuar nga komuna përkatëse, pas marrjes së pëlqimit nga MMPHI.

10.10. JO – KONFORMITETET

Jo-konformiteti është një shfrytëzim, një ndërtim, ose parcelë kadastrale që ka ekzistuar para miratimit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri" dhe nuk është në përputhje me shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore të vendosura në këtë plan. Jo-konformitetet në Parkun Kombëtar "Sharri" do të trajtohen si më poshtë:

1. Zona I-rë:

1.1. Ndërtimet jo-konforme nuk janë të lejuara në zonën e I-rë dhe do të mënjahen.

2. Zona e II-të:

2.1. Ndërtimet jo-konforme mund të qëndrojnë në zonën e II-të nëse ndërtimi përputhet me ligjet tjera të aplikueshme dhe udhëzimet administrative në fuqi. Ndërtimet jo-konforme në zonën e II-të nuk do të lejohen të zgjerohen, ndryshohen ose rindërtohen përpos në rastet kur bëhet fjalë për objekte të trashëgimisë kulturore si dhe arsye për këto ndryshime është forca madhore.

3. Zona e III-të:

3.1. Shfrytëzimi jo-konform mund të vazhdojë në zonën e III-të nëse një shfrytëzim i tillë është në përputhje me ligjet dhe aktet tjera në fuqi duke përfshirë edhe kushtet e parapara në lejet e mëhershme të ndërtimit. Ndryshimet eventuale në shfrytëzim duhet të përputhen me kërkesat e planit hapësinor në fuqi.

3.2. Ndërtimet jo-konforme mund të qëndrojnë në zonën e III-të nëse ndërtimet përputhen me ligjet dhe aktet tjera në fuqi. Kushtet e zhvillimit të parapara në planin hapësinor do të respektohen vetëm në rastet kur për ndërtimet jo-konforme kërkohet zgjerim përmbajtjesor, kërkohet ndryshim ose rindërtim për të gjitha rastet përveç arsyeve të krijuara nga forca madhore.

10.11. QENDRA TURISTIKE/REKREATIVE/REHABILITUESE

Organizimi i hapësirës dhe ndërtimi i qendrave turistike/rekreative/rehabilituese duhet të bëhet duke siguruar kushtet për realizimin e parimeve themelore të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës. Kjo nënkupton planifikimin dhe përdorimin e kufizuar të resurseve të përgjithshme të zonës së III-të për realizimin e produktit të përshtatshëm dhe atraktiv turistik.

Në planifikimin e këtyre zonave, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet pozitës së objekteve e në veçanti objekteve kryesor që e përbëjnë zonën në fjalë. Të gjitha përmbajtjet duhet maksimalisht të përshtaten me natyrën përreth, të ndërtuara me forma bashkëkohore dhe materiale natyrore. Lartësia maksimale e këtyre objekteve duhet të jetë: për terrenet me pjerrësi të vogël B+P+2+NK (katër etazhe mbitokësore), ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe B+S+P+1+NK dhe B+S+P+3+NK në rastet kur

objekti është i vendosur në mënyrë terrasore si në skicën e mësipërme (maksimum pesë etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin).

Forma e jashtme e objekteve duhet të jetë në harmoni maksimale me traditën e ndërtimit në zonën përkatëse, e veçanërisht për objektet përcjellëse si: objektet shërbyese, objektet ndihmëse, strehët e ndryshme kundër shiut dhe diellit, shitoret, objektet e veçanta sanitare, elementet për pushim/ulje dhe përjetim etj. Për të gjitha këto objekte duhet të shfrytëzohen materialet natyrore rrethana si guri druri dhe materiale tjera karakteristike për zonën. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet gjelbërimit, gjatë trajtimit të të cilit nuk duhet të përdoren lloje të florës që nuk janë autoktone me rrethinën.

10.12. FSHATRA TURISTIK

1. Fshatrat turistik janë struktura të organizuara në formë fshati, me objekte hoteliere specifike, të ndërtuara në zona rurale turistike, të cilat brenda një perimetri unik të kufizuar ofrojnë shërbime të vendosjes, pushimit, rekreacionit dhe shërbime tjera.

2. Planifikimi i lokacionit për zhvillimin e fshatrave turistik bëhet në kuadër të zonave të treta të zhvillimit, me plan rregullues të hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike të propozuar nga investitori.

3. Dizajni i komplekseve turistike – hotele apo fshatra turistik, duhet t'i përshtatet peizazhit natyror rrethues.

4. Fshatrat turistik mund të jenë: fshatra me villa dhe fshatra me bungallou.

o Fshatrat me vila janë njësi hoteliere për akomodim me arkitekturë të veçantë, në përshtatje me vendndodhjen, jo më shumë se 2 kate (P+NK), të përbëra prej apartamentesh, me hyrje të pavarura, të ndara ose brenda së njëjtës njësi.

o Fshatrat me bungallou janë njësi hoteliere për vendosje-akomodim të përshtatshëm dhe të ndërtuara nga druri ose materiale të tjera karakteristike të zonës.

5. Përcaktimi i kategorisë së fshatit turistik bëhet në bazë të normave dhe standardeve në fuqi, sipas të cilave fshatrat turistik ndahen në fshatra me: "1 yll", "2 yje", "3 yje", dhe "4 yje"; dhe varësisht nga kategoria përcaktohen edhe përmbajtjet tjera:

o Fshati me "1 yll" me bungallou duhet t'i ketë minimum 7 njësi me sip. min. për dy persona 28m², min. 3m² shtesë për një person, jo më shumë se katër persona;

o Fshati me "1 yll" me vila duhet ta ketë kapacitetin min. 7 apartamente me sip. min. për dy persona 35m², min. 8m² shtesë për person, por jo më shumë se katër persona;

o Fshati me "2 yje" duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret e fshatrave turistike me "1 yll", plus:

- Me bungallou duhet ta ketë sipërfaqen minimale 32 m²;
- Me vila duhet ta ketë sipërfaqen minimale 40 m².

o Fshati me "3 yje", përveç kërkesave të fshatit turistik me "2 yje", duhet t'i plotësojë:

- Me bungallou – sip. min. 35 m²;
- Me vila – sip. min. 45 m².

o Fshati me "4 yje" përveç kërkesave të fshatit turistik me "3 yje", duhet të ketë:

- Parking të mjaftueshëm në hyrje të fshatit;
- Sipërfaqe të lirë min. 40% të sipërfaqes totale, etj.

10.13. VEND KAMPINGJET

1. Lokacioni i vend-kampingut duhet të planifikohet në kuadër të zonës së tretë të parkut.

2. Madhësia, forma dhe lokacioni caktohet me plan rregullues të hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike të propozuar nga investitori.

3. Kampet janë bashkësi funksionale të rregulluara, të cilat ofrojnë kushte për vendosje të mysafirëve në hapësirat e jashtme me auto-shtëpiza dhe tenda, duke plotësuar nevojat elementare dhe shërbimet tjera për pushim dhe rekreim.

4. Vend-kampingu është hapësirë në të cilën parcelat mund të dimensionohen si të veçanta dhe të grupuara.

5. Çdo parcelë duhet të ketë qasje direkte në rrjetin e furnizimit me energji elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimit.
6. Hapësira e nevojshme për organizimin e kampingut mund të përfshijë 10% të sipërfaqes së planifikuar për zhvillim.
7. Për një njësi parcele në kamp duhet të sigurohen minimum 60m².
8. Shërbime tjera përcjellëse: ndriçimi i vendit të kampit, sanitaret e përbashkëta me gardëroba, grapa septike për ujërat e zeza, hapësirat higjienike, depo ushqimore, depo për rekuizita tavolina, karrige, shtretër mobilë dhe rekuizita sportive; hapësirat rekreative (fushë tenisi, futboll, volejball, basketboll, ping-pong, etj).
9. Hapësirat (ndërtesat) përcjellëse të kampit duhet të jenë njëkatëshe dhe më kulme dy ujore, me lartësi 4,5m' nga pika më e ulët e terrenit (prej kuotës më të ulët deri te maja e kulmit). Është i obligueshëm përdorimi i sistemit montazh nga materialet natyrore (guri, druri etj.) dhe përshtatja me konfiguracion të terrenit, duke i ruajtur vlerat e peizazhit të zonës.
10. Recepcioni duhet të jetë në brendi të kampit ose para hyrjes në kamp, me shërbime përcjellëse për komunikim, marketing. Në kamp mund të parashihen edhe objekte tjera të shërbimeve të ndryshme (tregtare, furnizuese dhe shërbyese restorante, nevoja të tjera të domosdoshme, si: njësi postare, bankomat, etj.).
11. Kampet duhet të kenë rrethoja të sigurta dhe natyrore, të kenë qasje në infrastrukturë të jashtme rrugore dhe hapësirën adekuate të parkingut.
12. Rrugët brenda kampit duhet të mundësojnë qasjen e automjeteve dhe këmbësorëve deri te njësia e vendparkimit. Rruga kryesore i lidhë të gjitha rrugët anësore në drejtim të recepcionit dhe me infrastrukturën jashtë kampit.
13. Kampet duhet të jenë të furnizuara me ujë të pijshëm nga rrjeti publik ose ndonjë burim tjetër i kontrolluar.
14. Largimi i ujërave të zeza nga kampet duhet të sigurohet me sistem të mbyllur, në pajtueshmëri me normat dhe standardet për parqet kombëtare.
15. Kampet duhet të jenë të lidhur në rrjetin publik ose në ndonjë burim tjetër alternativ të energjisë elektrike. Rrugët kryesore si dhe rrugët tjera të cilat çojnë te restoranti, përmbajtjet e objekteve shërbyese dhe sanitare duhet të jenë të ndriçuara.
16. Kampet duhet të jenë të mbuluar nga sinjali i telefonisë mobile GSM dhe Interneti;
17. Kampet duhet të përmbajnë shenjat orientuese për hyrje-dalje nga kampi në raste të rrezikut, ato duhet të kenë dalje ndihmëse. Në kampe duhet të sigurohen mjetet për dhënien e ndihmës së parë.
18. Hapësirat sanitare në kampe duhet të jenë të përbashkëta.
19. Kampet duhet t'i kenë njësitë e veçanta të përbashkëta – hapësirat për larjen e enëve, hapësirat e ftohta për ruajtjen e ushqimit dhe frigoriferët, utiliti i përbashkët (larja, tharja dhe hekurosja e rrobave) dhe hapësirat për higjienë të kafshëve shtëpiake.
20. Përcaktimi i kategorisë së kampit bëhet sipas normave dhe standardeve në fuqi, sipas të cilave ekzistojnë kampet me "1 yll", "2 yje" dhe "3 yje", dhe varësisht nga kategoria përcaktohen edhe përmbajtjet tjera.

10.14. OBJEKTET HOTELIERE

1. Lokacioni i objekteve hotelerie duhet të planifikohet në kuadër të zonës së tretë të parkut.
2. Ngastra e ndërtimit të objektit hotelier përcaktohet me plan rregullues të hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike që mund të propozohet nga investitori.
3. Lartësia maksimale e objekteve hoteliere duhet të jetë: për terrenet me pjerrësi të vogël B+P+2+NK, ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe B+S+P+1+NK dhe B+S+P+3+NK në rastet kur objekti është i

vendosur në mënyrë terrasore si në skicën e mësipërme (maksimum pesë etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin).

4. Përcaktimi i kategorisë së objekteve hoteliere bëhet sipas normave dhe standardeve në fuqi të përcaktuara nga MINT/Departamenti i Turizmit.

5. Varësisht nga kategoria përcaktohen edhe përmbajtjet tjera që duhet të jenë në përputhje me normat teknike dhe në harmoni me mbrojtjen e natyrës.

6. Dizajni i hoteleve duhet të jetë në përputhje maksimale me peizazhin natyror rrethues.

10.15. MOTELET

1. Motelet janë të destinuar për t'u shërbyer personave që janë në kalim. Në to ofrohen shërbimet e të ushqyerit, fjetjes dhe rekreimit. Motelet në çdo rast duhet të jenë pranë rrugëve automobilistike e poashtu mund të jenë edhe në afërsi të qendrave turistike, historike, kulturore dhe sportive.

2. Në varësi të vendndodhjes dhe kapacitetit, motelet mund të kenë edhe përmbajtje tjera si kënde lojërash për fëmijë, fushë për lojra të ndryshme etj.

3. Rekomandohet që të shmanget ndërtimi i dhomave në katin përdhësë të motelit.

4. Lartësia e objektit të jetë deri në 10m' ose tri etazhe mbi sipërfaqen e tokës duke përfshirë përdhësen, katin dhe nënkulmin (B+P+1+Nk).

5. Vendparkingjet duhet ta mbulojnë 100% kapacitetin e motelit për vendosje.

6. Sipërfaqja minimale e dhomave në motele, pa përfshirë paradhomën dhe tualetin duhet të jetë: dhomë me një shtrat 9 m²; dhe dhomë me shtrat çift 11 m².

10.16. VEND PIKNIKËT

1. Lokacioni për piknik duhet të caktohet në vendet e përshtatshme nga aspekti i sigurisë nga zjarri, në pjesët e relievit të rrafshët pa pjerrtësi të madhe dhe sa më largë zonave strikte të mbrojtjes.

2. Madhësia, forma dhe lokacioni caktohet me plan rregullues të hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike të propozuar nga investitori.

3. Rregullat për sjellje dhe shfrytëzimin e vend-piknikut përcaktohen nga drejtoria e parkut.

4. Vendpikniqet duhet të kenë sipërfaqe të mjaftueshme nën hije natyrore të krijuara nga drunjtë e lartë. Burimi i ujit është i domosdoshëm, mund të jetë burim, përroskë apo burim i improvizuar artificial.

5. Varësisht nga madhësia e vendpiknikut, duhet të parashihen punktet e sanitareve të përhershme apo mobile si dhe kontejneri i mbeturinave.

6. Pajisjet në vendpikniqe si: ulëset, tavolinat etj. duhet të jenë të punuara nga materialet natyrore, druri, guri, në harmoni me ambientin rrethues.

7. Në largësi optimale nga vendpikniku duhet të jetë parkingu i veturave.

8. Pas çdo intervenimi në rregullimin e vendpiknikut duhet të rregullohet rrethina, mbjellja dhe kultivimi i gjelbërimit, bazuar në peizazhin rrethues.

9. Vendpikniqet duhet t'i kenë tabelat informative lidhur me kushtet për shfrytëzimin e hapësirës, mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore etj.

10.17. STANET

Stanet janë objekte domethënëse të parkut, dhe si të tillë duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Në PK "Sharri", stanet janë të vendosur në pronat publike dhe në ato private. Ata përdoren për nevoja të blegtorisë. Në vazhdim janë kushtet e ndërtimit për stanet sipas të cilave:

1. Një objekt stani edhe pse është i ndërtuar në pronë publike mund të ekzistojë edhe më tutje, nëse dëshmohet se objekti shfrytëzohet vetëm për nevoja të bujqësisë përkatësisht blegtorisë.

2. Stanet ekzistues dhe zonat përreth duhet të ruajnë funksionin primar të tyre, duke përfshirë banimin, strehimin e bagëtisë, përgatitjen dhe ruajtjen e bulmetit.

3. Me rastin e ndërtimit të ri apo rikonstruktimit të staneve ekzistuese, duhet të ofrohen informata dhe argumente të mjaftueshme, të cilat dëshmojnë qëllimin e ndërtimit të stanit. Kushti kryesor për të gjitha rastet është se, maksimalisht duhet të respektohet mënyra tradicionale e ndërtimit: guri, druri dhe mbulesa prej kashte, rrasa prej gurëve ose ndonjë mbulesë tjetër natyrore dhe se madhësia e objektit kryesor dhe objekteve tjera përciellëse duhet të jetë në përputhje me kriteret për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore/blegtorale. Sipas këtyre kriterëve madhësia e objekteve dhe hapësirës së nevojshme është:

- Torishta – rrethimi me gardh prej druri dhe guri; sipërfaqja maksimale 5m²/kokë bagëtie;
- Objekti i banimit – parcela jo më e vogël se 500m², sipërfaqja e shfrytëzueshme prej maksimum 80m², me lartësi maksimale B+P+Nk;
- Objekti përcjellës (depo) – sipërfaqja maksimale prej 0.2m²/kokë bagëtie, me lartësi maksimale P;
- Materiali – në përgjithësi material natyror/rrethanor (guri, druri ose derivatet e tyre);
- Kushtet e mësipërme nuk janë të vlefshme për qëllime tjera.

Sipërfaqja e nevojshme:

Për shtalla:

- lopët dhe kuajt – 7.0-9.0 m²/kokë bagëtie;
- delet dhe dhitë – 2.0-2.5 m²/kokë bagëtie

Për kotece:

- pula – 0.3-0.4 m²/kokë;
- çura (gjeldeti) – 0.5-0.6 m²/kokë

10.18. HYRJET NË PARK

1. Në territorin e Parkut Kombëtar “Sharri” ekzistojnë 7 hyrje në të cilat arrihet përmes rrugëve regjionale që janë nën kompetencën e pushtetit qendror dhe një numër më i madh i hyrjeve ku arrihet përmes rrugëve të kategorisë pak më të ultë apo rrugëve lokale që janë nën kompetencën e pushtetit lokal (komunave). Hyrjet në të cilat arrihet përmes rrugëve regjionale janë shumë më të frekuentuara se sa hyrjet tjera, sepse banorët e Kosovës përmes tyre hyjnë në park, ndërkaq hyrjet në të cilat arrihet përmes rrugëve lokale frekuentohen vetëm nga ata pak banorë që jetojnë në vendbanimet e afërta rreth parkut dhe për këtë arsye janë më pak të rëndësishme. Hyrjet në rrugët regjionale janë ndarë në: kryesore dhe sekondare, kurse hyrjet në rrugët lokale janë hyrje terciare.

- o Hyrja kryesore 1 – Rruga regjionale R115 që e lidhë vendbanimin Shtërpçë me parkun;
- o Hyrja kryesore 2 – Rruga regjionale R115 që e lidhë vendbanimin Gornje Sello me parkun;
- o Hyrja kryesore 3 – Rruga regjionale R210 që e lidhë vendbanimin Brezovicë me parkun;
- o Hyrja sekondare 1 – Rruga regjionale R118 që e lidhë vendbanimin Vërbeshticë me parkun;
- o Hyrja sekondare 2 – Rruga regjionale R118 që e lidhë vendbanimin Mushtisht me parkun;
- o Hyrja sekondare 3 – Rruga regjionale R115 që e lidhë Prizrenin me parkun;
- o Hyrja sekondare 4 – Rruga regjionale R115 që e lidhë vendbanimin Zhivinjan me parkun;

2. Në hyrjen kryesore 1 duhet të vendoset objekti – degë e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” me administratën dhe zyrën e informimit, me sipërfaqe deri në 30m² dhe etazhitet P, me lartësi dysheme – dysheme 3 m.

3. Në hyrjet kryesore 2 dhe 3, si dhe në hyrjet sekondare 1,2,3 dhe 4 duhet të vendosen zyrat e kontrollit dhe informimit me sipërfaqe maksimale prej 9m² me lartësi dysheme – tavan 2.6m.

4. Objektet që parashihen në hyrjet e parkut duhet të ndërtohen me materiale natyrore duke përfshirë drurin, gurin dhe materialet tjera natyrore. Rekomandohet që ndërtimi të bëhet në sistemin montazh dhe me kulm dy uJOR me pjerrtësi minimale 30%.

5. Pjesë e hyrjeve mund të jenë edhe objektet shërbyese me sipërfaqe maksimale prej 12m² dhe me lartësi (dysHEME – tavan) 2.6m.
6. Në hyrjet e parkut duhet të vendoset simboli i parkut i punuar dhe i dizajnuar me elemente karakteristike të parkut. Ai poashtu duhet të vendoset, në përmasa më të vogla, pranë rrugëve automobilistike që të çojnë në hyrjet kryesore të parkut, nga dy simbole, njëri 2 km dhe tjetri 4 km larg hyrjes.
7. Në hyrjet kryesore të parkut duhet të parashihen parkingje të mjaftueshme për të gjitha llojet e automjeteve. Lokacioni, numri i nevojshëm i vend parkingjeve dhe përmbajtjeve tjera, përcaktohet me plan rregullues të hollësishëm.
8. Hyrjet në park rekomandohen të jenë të dizajnuara me stilin tradicional.
9. Hyrjet terciare duhet gjithashtu të menaxhohen nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”.

10.19. INFRASTRUKTURA FIZIKE

1. E gjithë infrastruktura fizike ekzistuese dhe e planifikuar duhet të jetë në harmoni me rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Varësisht nga niveli i tyre parashihet edhe përgjegjësia e ekzekutimit, e cila në të gjitha rastet mbikëqyret nga Ministria, përkatësisht drejtoria e parkut.
2. Trasetë përfundimtare të rrugëve të planifikuara të prezantuar në hartën e infrastrukturës, mund të ndryshohen dhe plotësohen pas analizave detaje dhe marrëveshjeve të palëve të interesit.
3. Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë apo me materiale tjera që i përshtaten dhe janë në harmoni me rrethinën në të cilën ndërtohen.
4. Gjerësia e shtigjeve për këmbësorë në park, varësisht nga terreni, duhet të jetë maksimum 1.5 metra.
5. Elementet për ulje tek pikat e pushimit që ndodhen përgjatë shtigjeve për këmbësorë duhet të ndërtohen nga druri ose materiale tjera të ngjashme natyrore.
6. Në pjesët ku shtegu është i rrezikshëm për lëvizje, duhet të parashihen rrethoja që do të ndikojnë në ngritjen e sigurisë së vizitorëve.
7. Në vendet e duhura, si aty ku fillon territori i Parkut Kombëtar “Sharri” dhe përgjatë rrugëve e shtigjeve për këmbësorë, duhet të vendosen tabelat me informatat e nevojshme për vizitorët.
8. Duhet të respektohet brezi mbrojtës rrugor i cili paraqet sipërfaqen në të dy anët e autoudhëve, rrugëve nacionale, regjionale dhe lokale, gjerësia e të cilit është e përcaktuar me Ligjin për Rrugët.
9. Gjatë intervenimit (ndërtim i ri apo përmirësim i rrugëve) në rrugët automobilistike, duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike (gjerësia, pjerrtësia, shtresat dhe trashësia e tyre) për ndërtimin e tyre të përcaktuara me rregullat e nxjerra nga Ministria.
10. Përgjatë rrugëve automobilistike në park duhet të vendosen të gjitha shenjat e nevojshme të komunikacionit.
11. Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët automobilistike të parkut duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat dhe normat e përcaktuara me rregullat e veçanta të nxjerra nga Ministria dhe kufizimet që parashihen me rregullat mjedisore.
12. Qarkullimi i automjeteve për transportin e mallrave në rrugët e parkut duhet të jetë nën monitorimin e pandërprerë të drejtorisë së parkut, në mënyrë që të parandalohet transporti ilegal i masës drusore dhe produkteve të tjera të parkut.
13. Transporti publik i udhëtarëve duhet të realizohet nga operatorët e licencuar.
14. Për shkaqe sigurie, automjetet transportuese duhet t’i plotësojnë të gjitha kushtet teknike të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi të nxjerra nga Ministria.

15. Gjatë ndërtimit të parkingjeve duhet të respektohen rregullat teknike të përcaktuara me kriteret teknike për ndërtimin e tyre, të nxjerra nga Ministria.

16. Numrin e parkingjeve, vendin e tyre në hapësirë dhe standardet për parkingje i përcakton plani rregullues i hollësishëm për zonën e caktuar ose zgjidhja urbanistike e propozuar nga investitori. Në vazhdim janë dhënë disa standarde për numrin e nevojshëm të parkingjeve:

- a. Shërbime – 1 vend parkim (VP) për 3 të punësuar;
- b. Restorante – 1 VP për 1 tavolinë;
- c. Hotele – 1 VP për 1 dhomë dhe jo më pak parkingje se sa për 30% të kapacitetit hoteljer;
- d. Zyre – 1 VP në 75m² btto zone;
- e. Dyqane – 1 VP në 50m² btto zone.

17. Gjatë projektimit, ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të teleferikëve, duhet që respektivisht të zbatohen dhe të plotësohen në tërësi rregullat teknike dhe kërkesat që dalin nga legjislati në fuqi.

18. Ndërmarrjet ndërtimore të angazhuara në kuadër të parkut duhet të jenë të paisura me licenca përkatëse.

19. Ndërmarrjet e energjisë që do t'i kryejnë punët e distribuimit dhe të furnizimit të qytetarëve me energji elektrike duhet të jenë të pajisura me licencë nga ZRRE.

20. Punët në ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror duhet të kryhen në përputhshmëri të plotë me kodet teknik që i përpilojnë ndërmarrjet e energjisë dhe të cilët i miraton ZRRE.

21. Për ndërtimin e sistemeve publik të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, duhet të merret leja nga institucionet përkatëse në MMPHI.

22. Sipas nevojës lejohet ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe të kolektorëve përkatës, për të cilat duhet të merret leja nga institucionet përkatëse në MMPHI.

23. Ekipet profesionale që do t'i realizojnë studimet dhe hulumtimet të cilat janë paraparë me këtë plan tek kapitulli i strategjisë, pjesa për infrastrukturën fizike, duhet t'i plotësojnë kushtet:

- o Të kenë përgatitjet adekuate profesionale (shkollimi adekuat);
- o Të kenë përvojë nga e kaluara në studime të natyrës së njëjtë.

24. Në mënyrë që të mund të ushtrojë veprimtarinë e vet në park dhe në vendbanimet rreth tij, ofruesi i shërbimeve të telefonisë fikse, asaj mobile, Internetit dhe televizionit kabllor, kompania publike apo private duhet të jetë e pajisur me licencë nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

25. Përveç licencës që merret nga ARKEP, për vendosjen e antenave në terren, operatori i telefonisë mobile duhet të marrë edhe pëlqimin mjedisor nga MMPHI.

26. Është rreptësishtë e ndaluar vendosja e antenave dhe pajisjeve përcjellëse në zonën e parë (rezervatet strikt të natyrës).

27. Të drejtën për administrimin me mbeturinat në park dhe në vendbanimet rreth tij e kanë vetëm operatorët për administrimin e mbeturinave që janë të pajisur me licencë nga MMPHI.

28. Në pika të caktuara të infrastrukturës rrugore duhet të ndërtohen mbikalime (ura), të cilat do të mundësojnë dhe ruajnë qarkullimin e lirë të faunës. Përzgjedhja e lokacionit dhe ndërtimi i këtyre mbikalimeve duhet të bëhet sipas rregullave dhe normave të njohura ndërkombëtare.

10.20. TRASHËGIMIA NATYRORE

1. Të gjitha aktivitetet, projektet dhe masat e parapara në këtë plan hapësinor janë në harmoni me rregullat për mbrojtjen e natyrës, sipas të cilave, ndalohen të gjitha veprimet që shkaktojnë ndotjen e ajrit, tokës, ujërave nëntokësore dhe mbitokësore, duke e përfshirë edhe ndërrimin e shtretërve të lumenjve;

2. Në parkun kombëtar duhet të ndërmerren masat për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës sipas të cilave duhet të bëhet:
 - o Ndalimi i ndërtimit të kapaciteteve industriale që ndotin ajrin, ujin dhe tokën;
 - o Për ndërtimet e kategorisë së parë, të bëhet derdhja e detyrueshme e ujërave të zeza në gropat septike të padepërtueshme.
 - o Për ndërtimet e kategorisë së dytë dhe të tretë të aplikohet vendosja e impianteve për pastrimin e ujërave të zeza.
 - o Të vendoset sistemi i rregullt grumbullimit dhe i largimit të mbeturinave.
3. MMPHI është përgjegjëse për monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve hapësinore në parkun kombëtar dhe për shkeljet eventuale, përmes drejtorisë së parkut merr masat në përputhje me rregullat në fuqi.
4. Në park ndalohen çfarëdo ndryshimesh në kundërshtim me këtë plan, posaqërisht ndryshimet që ndikojnë në bashkësitë e pyjeve, majat e maleve dhe ujërrjedhat.
5. Pas çdo ndërtimi me leje, duhet të rregullohet rrethina, mbjellja dhe kultivimi i gjelbërimit bazuar në peizazhin autokton.
6. Nuk lejohet vendosja e antenave difuzive dhe të kontejnerëve për mbeturina në hapësira dhe lokalitete me vlera të peizazhit, larmisë biologjike dhe trashëgimisë natyrore e kulturore.
7. Ndalohen të gjitha veprimet që ndikojnë në ndryshimin e morfologjisë ekzistuese të terrenit duke përfshirë grykat malore, shpellat karstike, liqenet malorë dhe zonat tjera (Zonat e I-ra) të shpallura me rëndësi të veçantë natyrore.
8. Ndalohet prerja ilegale e pyjeve. Prerja e pyjeve lejohet vetëm sipas Planit Menaxhues të Parkut Kombëtar "Sharri" dhe Rregullores së MMPHI për Rendin e Brendshëm të PK "Sharri".
9. Ndalohet shfrytëzimi i llojeve bimore endemike, përveç shfrytëzimit të tyre për rastet e kërkimeve shkencore.
10. Me qëllim të ruajtjes së bilancit ekologjik në park, resurset natyrore duhet të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Ky shfrytëzim më hollësisht rregullohet me planin e menaxhimit të parkut dhe me Rregulloren e MMPHI për Rendin e Brendshëm të PK "Sharri".
11. Ndalohet nxjerrja e zhavorrit nga lumenjtë pa leje paraprake.
12. Ndalohet kaptimi i burimeve ujore pa leje paraprake.
13. Burimet ujore mbrohen me Ligjin për Ujërat dhe me masa për shfrytëzim të kufizuar të tyre, të cilat caktohen me planin menaxhues të parkut.
14. Ndalohen veprimtaritë që për bazë kanë shfrytëzimin e inerteve duke përfshirë edhe gurthyesit e paautorizuar.
15. Ndalohen të gjitha veprimtaritë (gërmimet, mihjet sipërfaqësore, shpyllëzimi etj.) që ndikojnë në rritjen e erozionit.
16. Lejohet ndërtimi i akumulacioneve ujore me sipërfaqe deri në 25m² në shtretërit e lumenjve, (lokacioni përcaktohet në bashkëpunim me drejtorinë e parkut) me qëllim të sigurimit të ujit që do të shfrytëzohet për blegtori dhe për rastet e zjarreve që mund të ndodhin në park.
17. Ndalohet ndërtimi i objekteve në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujë rrjedhave, me përjashtim të objekteve që shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet.
18. Nuk lejohet transportimi i derivateve dhe materieve të tjera të dëmshme në park.
19. Me përjashtim të zonës së parë të parkut, kositja e livadheve është e lejuar dhe duhet të realizohet sipas kritereve të përcaktuara nga drejtoria e parkut, të cilat janë në favor të mbrojtjes dhe ripërtëritjes së tyre.
20. Në park është e ndaluar gjuetia. Ajo lejohet nga drejtoria e parkut vetëm në rastet e jashtëzakonshme, kur ndonjë lloj i kafshëve paraqet rrezik për parkun apo për vendbanimet përreth.

21. Ndalohet peshkimi në të gjitha rrjedhat ujore brenda parkut.
22. Gjatë zhvillimit të çfarëdo aktiviteti në park duhet të zbatohen kriteret për minimizimin e zhurmës.
23. Për shkak të rrethanave të ndryshuara (shpallja e territorit park kombëtar), për operatorët ekonomik që merren me shfrytëzimin dhe eksplotimin e inerteve në brendi të territorit të parkut, pas miratimit të këtij plani duhet të iniciohet shqyrtimi i lejeve për vazhdimin e veprimtarisë në lokacionin përkatës. Rezultat i këtij shqyrtimi do të jetë ndërprerja ose vazhdimi i aktivitetit, duke respektuar kufizimet në kuadër të të cilave: do të përcaktohet afati kohor i ushtrimit të veprimtarisë; lokacioni (sipërfaqja e përcaktuar në hartën e zonimit) ku ushtrohet veprimtaria duhet të kufizohet me një tampon mbrojtës (dy rende drunj të mbjellë që përshtaten me mjedisin); pas përfundimit të veprimtarisë, lokacioni të rehabilitohet sipas rregullave të njohura mjedisore.
24. Sa i përket kërkesave për ndërtimin e impianteve hidroenergjetike, duke u bazuar në: Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës; Raportin e Shqyrtimit Publik; Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe në bazë të diskutimeve e rekomandimeve të grupit punues ndërministror, është marrë qëndrim që të ndalohet ndërtimi i tyre.

10.21. TRASHËGIMIA KULTURORE

1. Objektet e trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e mbrojtjes së përkohshme që ndodhen në vendbanimet rreth parkut duhet të trajtohen me Ligjin për Trashëgimi Kulturore nr.02/L-88, sipas të cilit monumentet arkitekturale kanë një zonë mbrojtëse prej 50m' nga perimetri i "monumentit", ndërsa për lokalitetet arkeologjike zona mbrojtëse është 100m' nga perimetri i "lokalitetit".
2. Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04L-174, objektet e lartpërmendur janë "Sipërfaqet e mbrojtura" për të cilat vlen:
 - o Ndalohet ndërtimi i rrugëve nacionale dhe regjionale, si dhe ndërtesave më të larta se "monumenti".
 - o Ndërtesat që ngriten afër duhet të jenë në harmoni me "monumentin".
 - o Ndalohet zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë, instalimi mbitokësor i furnizimit me rrymë elektrike, telekomunikacion dhe përçues digjital.
 - o Ndalohen veprimtaritë dhe ndërtimet që ndikojnë në shpyllëzim / ndotje të mjedisit dhe tjetërsim të zonës ku ndodhet objekti.
3. Rekonstruimi i objekteve me vlerë të trashëgimisë arkitekturore duhet të realizohet sipas standardeve dhe kriterëve të ndërtimit, duke përdorur forma dhe materiale vendore nga guri, druri dhe materiale tjera vendore, por gjithnjë duke e ruajtur trashëgiminë autoktone kulturore, tradicionale, fshatare si dhe duke ruajtur origjinalitetin e objektit dhe peizazhit që e rrethon.
4. Zona e veçantë e mbrojtur (ZVM), Manastiri i Treshit të Shenjtë mbrohet me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Ligji nr. 03/L-039) dhe duhet të trajtohet sipas këtij ligji. Në kuadër të ligjit janë të listuar aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara për zonat e veçanta të mbrojtura të cilat duhet të respektohen nga të gjithë.
5. Zhvillimet në kuadër të ZVM-ve, duhet të jenë në harmoni me kërkesat që dalin nga Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Ligji nr. 03/L-039), në të cilin janë të listuara aktivitetet që lejohen ose ndalohen brenda zonës.

10.22. TRAJTIMI I MBETURINAVE

1. Menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet në bazë të një sistemit të vendosur dhe të aprovuar nga drejtoria e parkut.
2. Mbeturinat duhet të jenë nën administrimin e operatorëve të licencuar (person fizik apo juridik) që paraprakisht përcaktohen nga drejtoria e parkut.

3. Operatorët përgjegjës për administrimin e mbeturinave duhet t'i përmbushin detyrimet që janë të rregulluara me Ligjin Nr.04/L-60 për Mbeturinat.
4. Aktivitetet që duhet t'i kryejnë operatorët përgjegjës për administrimin e mbeturinave janë të rregulluara me Ligjin Nr. Nr.04/L-60 për Mbeturinat.
5. Operatorët përgjegjës për administrimin e mbeturinave duhet të jenë të pajisur me licenca të cilat i lëshon MMPHI.
6. Ligji Nr. Nr.04/L-60 për Mbeturinat obligon mbikëqyrjen inspektuese të aktiviteteve për administrimin e mbeturinave.

10.23. NDIKIMET SOCIALE

1. Zbatimi i synimeve dhe objektivave të parapara në Planin Hapësinor të PK "Sharri" duhet të jenë në harmoni të plotë me ngritjen e mirëqenies sociale në përgjithësi. Aktivitetet, projektet dhe masat e parapara në strategjinë e zhvillimit hapësinor të parkut kanë për qëllim krijimin e kushteve, nga të cilat përfitimin e drejtpërdrejtë duhet ta kenë fillimisht banorët dhe vendbanimet brenda territorit të Parkut. Kjo nënkupton se përparësi në pjesëmarrje, në aktivitete, në ngritje të kapaciteteve, në përfitimin e donacioneve, në punësim dhe në aktivitete tjera duhet të kenë banorët vendas.
2. Për të gjitha aktivitetet, projektet dhe masat e parapara, duhet të aplikohen normat dhe standardet për personat me nevoja të veçanta sipas rregullave në fuqi.

10.24. ZBATIMI I PLANIT

1. Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri" është dokument që përcakton zhvillimin hapësinor të një zone me rëndësi për Qeverinë e Kosovës, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe si i tillë është obligues për të gjitha komunat pjesëmarrëse. Përpos zbatimit të drejtpërdrejtë, zbatimi i planit bëhet edhe përmes planeve tjera si: plani menaxhues i parkut kombëtar, planet zhvillimore komunale, planet rregullues të hollësishëm, si dhe Harta Zonale e Kosovës dhe harta zonale e komunës përkatëse.

10.25. HULUMTIMET E MËTUTJESHME

Duke qenë se parku kombëtar është një territor me biodiversitet të pasur, me pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, është e domosdoshme realizimi i hulumtimeve, të cilat do të ndihmojnë në pasqyrimin real dhe përmbajtësor të gjendjes ekzistuese të tij. Fushat me prioritet të hulumtimit janë: inventarizimi i përmbajtjeve duke përfshirë identifikimin e gjinive, individëve, popullatave, llojeve, habitateve, peisazheve dhe ekosistemeve, identifikimi i përhapjes së tyre gjeografike, renditja, katalogimi dhe paraqitja e tyre në hartë; hulumtimi i shpellave, inventarizimi, prezantimi dhe promovimi i tyre; hulumtimi i pasurive nëntokësore dhe fusha tjera të ngjashme. Të gjitha hulumtimet duhet të realizohen sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

